

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Specializues afatgjatë (SPA)
në Stomatologji, me profile “Ortodonti”; “Kirurgji orale”

Eksperti i Vlerësimit: Prof.As. Nazmi Koçi

Janar 2016

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për programin e studimit Specializues afatgjatë të ciklit të tretë në Stomatologji, me profile:

1. Kirurgji Orale
2. Ortodonti;

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Aldent
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Dentare
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Nr 299 dt 22.07.2013
4	Titulli i programit të studimit:	Programi i studimit specializues afatgjatë të ciklit të tretë në Stomatologji, me profile: 1. Kirurgji orale 2. Ortodonti;
5	Cikli i studimit:	Cikli i III
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
7	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Nga UAL,
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Ne Urdherin e Licencimit shkruhet: Ky program do te aplikohet në bashkëpunim me Qendrën spitalore Giovanni XIII Trevizo,Itali sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur ndërmjet tyre
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	8
15	Aktivizimi i programit të studimit	2013-2014
16	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	1016-2017
	Etj	

Shënim: Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

Institucioni mori në dijeni për përmbajtjen e Raportit të vlerësimit të Jashtëm dhe nuk paraqiti vërejtje. Sugjerimi i IAL, për renditjen e institucioneve bashkëpunuese është reflektuar që në Draft Raport.

HYRJE

Programi i studimit Specializues afatgjatë (SPA) në Stomatologji në profilet Kirurgji orale dhe Ortodonti është hapur me urdhër te Ministrit te Arsimit dhe Shkencës Nr. 299,

datë 22.07. 2013, i cili ka licensuar në Universitetin “Aldent” programin e studimit te ciklit te tretë Specializues afatgjate në “Stomatologji”, me profile:

1. Ortodonti dhe 2. Kirurgji oral, me kohëzgjatje 3 vjeçare

Institucioni arsimor ‘Aldent” është person juridik dhe është njohur me vendim të Gjykatës së Rrethit Tirane Nr.29008 datë 06.02. 2003. Me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës ai ka hapur shkollën 2 vjecare për Laborant Dentar në vitin 2003.

Pasi ka funksionuar për tre vjet me këtë sistem, me vendim të Këshillit te Ministrave Nr. 673, datë 27.09.2006, i është dhënë leja për hapjen e shkollës së lartë Universitare Jo publike “Aldent” për ciklin e parë të studimeve me kohëzgjatje 3 vite akademike, për sistemin e studimeve me kohë të plotë, e cila ka përgatitur specialistë të Lartë në profilin “Laborant dentar”.

Me vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 27.02.2008 është licensuar program i integruar i studimeve për ciklin e dytë të studimit “ Stomatologji “ në 5 vite akademike dhe me kohë të plotë.

Me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr.539, datë 13.06.2013 është bërë ndryshimi i statusit të Shkollës së Lartë Universitare në Universiteti “Aldent” dhe jane krijuar dy Fakultete: Fakulteti i Shkencave Dentare dhe Fakulteti i Shkencave Mjekësore.

Me pas i është hapur rruga studimeve në ciklin e tretë dhe me Urdhërin 209, datë 22.07. 2013 që u citua në fillim dhe është licensuar ky program specializimi afatgjatë në Stomatologji me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti.

Programi i ciklit të tretë i studimeve për specializimin afatgjatë në Stomatologji ne profilet Kirugji Orale dhe në Ortodonti zhvillohen nga Fakulteti i Mjekësisë Dentare nën mbikqyrjen e vëmëndshme të Universitetit “Aldent”.

POLITIKAT E DREJTIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË STUDIMEVE TË SPA

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Misioni i programit te studimit te Universitetit “Aldent” është të pregatisë specialistë të fushës së Stomatologjisë në profilet Kirurgji orale dhe Ortodonti, me formim të plotë teoriko-praktik, të aftë për të përballuar kërkesat gjithnjë në rritje të shërbimit tonë dentar, për të plotësuar kërkesat e tregut të punës në vendin tonë, por dhe më gjërë.

Qëllimi i këtij programi studimi është përgatitja e një gjenerate të re specialistësh në profilet e mësipërme të aftë që ti përgjigjen kërkesave të larta profesionale të kohës dhe nevojave tona. Ky program studimi afatgjatë plotëson një boshllëk që ka ekzistuar për një kohë të gjatë në shërbimin tonë dentar, pasi strukturat tona shtetërore nuk kanë bërë më parë specializime në fushën e Ortodontisë, një profesion i domosdoshëm ky për mjekimin e anomalive të dhëmbëve e nofullave tek fëmijët tanë që është një fenomen me frekuencë gjithnjë në rritje, por jo i konfrontuar në nivelin e duhur dhe me mundësitë që ofron shkenca e sotme. Po ashtu specialiteti i Kirurgjisë orale i domosdoshëm në praktikën stomatologjike thuhet se ka munguar po të mos marrim në konsideratë vetëm disa specialistë shumë të pakët në numër, të përgatitur në raste sporadike dhe në nivelin e kirurgjisë oro-maksilo-faciale (omf), cka kërkon afate më të gjata studimi dhe kryen

ndërhyrje shumë të ndërlikuara e në kushte spitalore, ndërkohe që mbi 80% e nevojave të shërbimit tonë në profilin e kirurgjisë janë për ndërhyrje në nivelin e gojës e të dhëmbëve e këtë e mbulon specialiteti i Kirurgjisë Orale i cili te ne hapet për herë të parë.

- Sigurisht që ky program studimi do të pregatisë specialistë të këtyre fushave duke u mbështetur edhe mbi bazën e përvojës së arsimit mjekësor shqiptar dhe të përvojës së disa universiteteve të njohura në Europë, kryesisht atyre italiane.
- Specialistët e përgatitur me këtë program studimi, pas diplomimit do të kenë njohuritë e nevojshme mbi bazat e anatomisë e fiziologjisë së organizmit të njeriut, sidomos të gojës e organeve të saj e për rreth nofullave e të kafkës. Ata do të fitojnë njohuritë e duhura edhe mbi sëmundjet kryesore të kavitetit të gojës, ndryshimet anatomo-patologjike që ndodhin gjatë devijimeve nga norma, profilaksinë dhe diagnozën e hershme të sëmundjeve që mund të zhvillohen në gojë dhe jo rrallë rrezikojnë jetën e njerezve sidomos gjendjet prekanceroze e tumorale, mjekimin adekuat e në kohën e duhur të tyre e kur është e nevojshme rekomandimin tek specialistë të tjerë të fushave përkatesë. Ata do të njohin në nivelin e duhur preparatet e nevojshme që përdoren për mjekimin e patologjive të gojës, dozat korrekte, mekanizmin e veprimit të tyre si dhe efektet anësore që ata japin në organizmin e njeriut. Këta specialistë do të jenë të aftë për të ju përgjigjur kërkesave të larta estetike e funksionale që kanë sot pacientët tanë sidomos në fushën e anomalive të dhëmbëve e të nofullave, në përgatitjen e aparateve të lëvizshme e sidomos atyre fikse të cilat kanë filluar të përgatiten kohët e fundit edhe te ne dhe për të cilat nuk kemi patur eksperiencën e duhur në të shkuarën.
- Specialistët e ardhshëm marrin në këtë program edhe njohuri speciale në metoda teknologji të reja të mjekimit si implantologjia dhe kirurgjia ortognatike dhe teknikat me aparatura moderne të nivelit të shkencës së sotme europiane e botërore. Këta specialistë marrin këtu edhe njohuritë e nevojshme menaxheriale për të organizuar e drejtuar punën në njësitë e tyre ku ushtrojnë profesionin, por edhe në kolektiva më të mëdha duke kombinuar njohuritë profesionale më ato të marketingut profesional.
- Specialistët e këtij programi studimi marrin edhe informacionin e duhur për të mos qenë vetëm mjekues të rutinës, por edhe vëzhgues të vëmendshëm të rasteve, njohës të patologjive të reja, përgjithësues të fenomeneve dhe ekspertë të kërkimit shkencor, një drejtim ky i domosdoshëm për specialistët tanë për të bërë të mundur evidentimin e dukurive e fenomeneve shëndetësore te ne, vecoritë që ata kanë, frekuencën dhe prognozën e tyre, dekursin dhe mjekimin e suksesshëm të tyre.
- Ky program specializimi afatgjatë është hartuar jo vetëm sipas kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, të udhëzimeve të MAS për arsimin mjekësor shqiptar, por i harmonizuar edhe me kërkesat e legjislacionit europian për shëndetësinë. Ky program është hartuar edhe konform direktives 2005/36/EC të keshillit të Parlamentit Europian, cka përben një risi për specializantët që kryejnë atë dhe për të ardhmen europiane të specialisteve tane.
- Programi i specializimit afatgjatë në Kirurgji Orale dhe Ortodonti që ofron Universiteti "Aldent" shkon në harmoni edhe me rritjen numerike të specialiteteve të ne si dhe me menyrën e organizimit të shërbimit stomatologjik në Shqipëri. Kjo për fakti se ky shërbim në vendin tonë kryhet në masën mbi 90% nga shërbimi dentar privat dhe problemet e Kirurgjisë orale dhe ata të Ortodontisë zënë pjesën më të madhe të tij.

- Per realizimin e misionit te tij ne fushen e specializimeve afatgjate, Universiteti "Aldent" ka percaktuar strategji te qarte afat shkurter dhe afatmesem e afat gjate.
- Strategjia afatshkurter lidhet me konsolidimin e metejshem te ketij programi studimi qe eshte i aktivizuar qe ne vitin 2014. Verifikimin e sakte te nevojave te specializanteve, kerkesat e tyre specifike sipas specialitetit dhe ato preferenciale per aparatura e disiplina ku kane ineres te veante dhe jane mundesit qe te ju plotesohen ne afate te shkurtera.
- Ne strategjine afatgjate Universiteti ka parashikuar kordinimin efikas midis ketyre programeve te studimit qe i ofrojne tregut specialiste te mirfillte te fushave te vecanta si dhe studimin e tregut te punes per specialitete ne fusha te tjera ,krijimin gradual te kushteve e te mundesive per ta edhe ne programe te tjera si paradontologjia, patologjite e mukozave te gojes etj. Nje gje e tille ka filluar te realizohet qe tani duke shfrytezuar aktivitete e mjedise te perbashketa, praktika klinike e laboratorike te berbashketa per te pervesuar reciprokisht probleme specifike te specialitetit te njeri tjetrit dhe per te mos patur ndarje fikse midis specialisteve, pasi edhe praktika mjeksore nuk eshte e ndare ne nje forme te tille, por shpesh problemet lidhen e nderthuren me njeri tjetrin dhe qendrimi ndaj tyre duhet te jete kompleks e i plote.
- Programi ne fjale i specializimit afatgjate ka nje harmonizim te mire midis leksioneve e praktikave ne salla e labore, me diskutime te rasteve e zgjidhje te tyre me protokolle te qarta cka u konsiderua mjaft efektive edhe nga vete studentet.
- Programi ka parashikuar edhe kreditet e nevojshme qe studentet fitojne ne praktikat profesionale te cilat zhvillohen ne te tre vitet e studimit dhe i aftesojne ata per punet qe do te kyrejne ne te ardhmen.
- Gjate hartimit ky program eshte konsultuar edhe me ate te disa universiteteve te huaja qe pergatisin specialiste te ketyre fushave sidomos me ata ne Itali, Spanje etj. prej nga vijne cdo jave edhe pedagoge qe japin mesim e sjellin pervojen e tyre mesimdhense e shkencore.

Disa avantazhe te programit te SPA ne Universitetin "Aldent" mendoj se jane:

- Ploteson nje nevoje te madhe te sherbimit stomatologjik te vendit per specialiste te fushave te rendesishme te tij si Kirurgjia Orale dhe Ortodontia te cilet ose kane munguar me pare ose kane qene ne numer fare te vogel e te pergatitur jashte vendit, por qe nuk mund te perballonin nevojat e sherbimit.
- Infrastruktura e plote per pergatitjen e ketij kontigjenti qe eshte aktualisht duke u pergatitur ne te, e cila eshte ne gjendje te perballoje edhe prurje te tjera ne rast se do te gjykohet nga autoritete e Universitetit.
- Ka bashkpunim me firma te njohura te Europes dhe me gjere te tregut te materialeve dhe aparaturave mjekesore bashkekohore me te cilat ka bere te mundur furnizimin ritmik e te mjaftueshem me te gjithë preparatet dhe paisjet e tjera te sherbimit stomatologjik ne sasine e kualitetin e nevojshem, shoqeruar keto me certifikaten e cilesise dhe te origjines se mallit dhe instruksionet e perdorimit te tyre.
- Koha e studimit ne tre vite mendoj se eshte e mjaftueshme dhe e pershtateshme per te na dhene edhe specialiste te pergatitur, por brenda nje afati optimal qe i vijne ne sherbim tregut relativisht shpejt duke plotesuar nevojat e tij. Nje kohe e tille studimi ne SPA perdoret edhe ne disa vende te Europes sic eshte Italia e me tej. Ndersa afati i

studimeve prej kater vjetesh perdoret ne profile te tjera si ai i Kirurgjise OMF ku ka game me te gjere nderhyrjesh te nje shkalle veshtiresie me te larte e qe kryhen ne institucione me shtreter.

- Ka staf mjekesor mjaft te kualifikuar ku gershetohen specialistet tane me pervoje te gjate e kualifikimet e nevojshme me disa specialiste te huaj te nje niveli mjaft te larte shkencor e mesimdhene, qe vijne periodikisht, japin leksione e drejtojne praktika, organizojne e udheheqin tema studimore dhe jane pjese e stafit mesimor.

Stafi qe ka hartuar programin ka patur synimin qe punesimi i ketyre specialisteve te jete i mundshem ne disa menyra ne dobi te sherbimit stomatologjik:

- Ne te gjitha klinikat e tyre private ne te gjithë qytetet e fshatrat e Shqiperise ata do te sjellin nje nivel te ri e me cilesor te sherbimit pasi deri me sot keta specialitete kane munguar.
- Ne spitalet e sherbimit privat qe jane hapur jo pak ne vendin tone kohet e fundit dhe qe kane nevojë edhe per sherbim stomatologjik, krahas atij mjekesor per te cili jane shtruar.
- Permes rekrutimit si pjese e stafit pedagogjik ne kete Universitet ose ne shkolla te tjera te larta qe kane nevojë per specialiste te tille te nje kontigjenti te caktuar te specialisteve qe arrijne rezultatet me te larta.
- Permes punesimit edhe jashte vendit sidomos ne diaspore, vendet fqinj dhe me tej, duke konsideruar kurikulen qe krehne ne kete universitet si dhe nivelin e pergatitjes qe arrijne ne kete institucion.

Pergatitja me nivel te mire e specialisteve ne kete institucion behet e mundur edhe per faktin se krahas kushteve te krijuara, eshte grumbulluar edhe nje pervoje e mire mesimdheneje pasi ai funksionon si shkolle e larte qe nga viti 2006 dhe kjo pervoje pozitive po pasurohet me ritme te shpejta.

Emertimi i programit te studimit eshte ne perputhje me Kornizen Shqiptare te kualifikimit. Programi perfshihet ne ciklin e trete te studimeve, ne specializime afatgjata ne Stomatologji, 1. Profili Kirurgji Orale dhe 2. Profili ne Ortodonti

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI I - SYNIMET DHE QËLLIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT, KUADRI I PËRGJITHSHËM	
Standardi I. 1- Programet e studimeve specializuese afatgjata në mjekësi ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi: misioni dhe qëllimi i tyre është shprehur qartë.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja e programeve të specializimeve afatgjata është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka një mision të qartë për programet e studimit që ofron.</p> <p>Kriteri 3 Qëllimi i programit të studimit dhe rezultatet që priten janë të qarta.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimit mbështeten mbi objektiva të qartë profesionale dhe janë të integruar me veprimtaritë klinike.</p> <p>Kriteri 5 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve.</p>	<p>-Programi i studimeve specializim afatgjate ne stomatologji eshte hartuar ne perputhje me kuadrin ligjor dhe aktet nen ligjore per arsimit e larte ne vendin tone. Ky program eshte licensuar me Urdher te Ministrit te Arsimit dhe Shkences Nr. 299, date 22.07.2013 dhe ka filluar te funksionojë ne vitin shkollor 2014-2015.</p> <p>-Institucioni ka nje mision te qarte per programin e studimeve afatgjate qe ofron ne stomatologji.</p> <p>-Qellimi i ketij program studimi te nivelit te trete lidhet</p>

	<p>me formimin e metejshem profesional te mjekeve stomatologe, specializimin dhe thellimin e metejshem te tyre ne fusha te vecanta te mjekesise se gojes sic eshte Kirurgjia Orale dhe Ortodontia dhe ploteson nje boshllek te sherbimit shendetesor ne drejtim te plotesimit te metejshem te tij me specialist te afte e te thelluar ne fusha te vecanta te tij.</p> <p>-Ky program studimi ka objektiva te qarta profesionale e shkencore dhe mbeshtetet ne studimin e thelluar teorik dhe veprimtarine e perditeshme klinike e mjekesore te pavarur por dhe te supervizuar nga speciliste te nivelit te larte te fushes perkatese. Keta objektiva jane te percaktuar qarte ne programin e studimeve dhe jane mire te harmonizuara midis tyre pjesa teorike me veprimtarine praktike klinike.</p> <p>-Emertimi i ketij programi eshte ne perputhje me nivelin e percaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimeve dhe eshte emertuar: Specializim Afatgjate ne Stomatologji, jepet diplome e titulluar "SPECIALIZIM AFATGJATE NE STOMATOLOGJI", Profili "KIRURGJI ORALE" dhe Profili "ORTODONTI".</p>
Standardi I. 2- Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Programi i specializimit afatgjatë përfshin formim teorik e praktik në fushën e specialitetit, i cili realizohet njëkohësisht në një universitet të akredituar, dhe në një institucion spitalor ose në një institucion shëndetësor të aprovuar dhe akredituar për këtë qëllim nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) dhe Ministria e Shëndetësisë (MSH) pasi është marrë mendimi i Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.</p> <p>Kriteri 2 Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plotë dhe përfshin pjesëmarrjen në veprimtaritë mjekësore të departamenteve ose shërbimeve ku ofrohet formimi, në përputhje me procedurat e përcaktuara dhe nën mbikqyrjen e autoritetit apo entit përgjegjës.</p>	<p>-Programi mesimor i SPA përfshin përgatitjen teorike dhe praktike të specialisteve në fushën e Kirurgjisë Orale dhe të Ortodontisë i cili realizohet pranë Universitetit "Aldent". Për realizimin e suksesshem të ketij programi Universiteti bashkepunon edhe me institucione të tjera me shtreter dhe që ofrojnë shërbime të tilla si Universiteti i Mjeksisë Tirane, Qendra spitalore Nene Tereza Tirane, Spitalin e Traumes.</p> <p>-Universiteti "Aldent" ka marreveshtje bashkepunimi të nenshkruara me institucionet e mesiperme.</p> <p>-Programi i specializimit afatgjatë kryhet me kohë të plote dhe studentet ndjekin rregullisht leksionet e po ashtu marrin pjesë në veprimtarine e perditeshme kliniko mjekuese që zhvillohet në poliklinikën stomatologjike të Universitetit "Aldent", pranë se ciles është e atashuar dhe një qender e formimit dhe shërbimit klinik.</p>
Standardi I. 3- Programet e studimeve janë eficente, në përputhje me misionin institucional.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën një planifikim institucional efikas dhe kryen përmirësime të ndjeshme për realizimin e qëllimeve dhe rezulton se programi ka arritje të mira.</p>	<p>-Programi i studimit për specializimin afatgjatë që ofron Universiteti "Aldent" është hartuar e implementohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e ketij institucioni që perkon me thellimin dhe perfeksionimin e njohurive të mjekeve stomatologe të diplomuar në nivelin e dytë të studimeve universitare, në fusha të vecanta, perkatesisht në Kirurgji Orale dhe Ortodonti.</p> <p>-Ky program është implementuar për here të pare në</p>

	<p>vitin 2013 dhe gjenerata e pare e tij eshte ne proces te studimeve. Kjo ka bere qe stafi pedagogjik e mjekesor i Universitetit te ndjeke me vemendje realizimin e tij dhe po ashtu te beje permiresimet e nevojshme qe do ta rrisin cilesisht ate.</p> <p>-Standartet asistenciale A dhe B, perkatesisht Nderhyrje kirurgjikale vjetore dhe shtrime spitalore vjetore (Aneksi 1) mendoj se kane nevojte te permiresohen ne lidhje me sasine e punimeve qe duhet te kryejne specializantet. Eshte nje praktike e huazuar nga programet italiane te vitit 2005, te cilat vete italianet i kane konsideruar te teperta dhe i kane ripunuar ne vitin 2015.</p> <p>-Me gjithte masat qe ka marre universiteti, realizimi i tyre eshte i pa mundur per faktin se ne nje popullsi prej rreth 2.8 milion banore eshte praktikisht e pamundur te hasen aq raste klinike sa kerkohen pasi semundjet dhe fenomenet kane nje frekuence te caktuar dhe varen nga numri i popullsisë. Edhe shtrime spitalore vjetore mendoj se jane jane nje standart qe kerkohet ne Kirurgji Oromaksilofaciale dhe jo kirurgjise orale e cila te ne dhe ne gjithte boten kryhet ne kushte ambulatorore.</p> <p><i>Do te ishte mire keto standarte te rishikohen ne perputhje me realitetin shqiptar. Ne konsideraten time si specialist eshte me e drejte qe t'ju kushtohet vemendje se pari protokolleve dhe teknikave te mjekimit qe ato te behen shprehi e punes se specializanteve dhe pastaj anes sasiore te interventeve.</i></p>
<p>Standardi I. 4- Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare dhe integrojnë kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë përshtaten në strukturë me programet homologe të zhvilluara në vendet europiane.</p>	<p>-Programi i studimeve per specializimin afatgjate stomatologji me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti eshte hartuar duke e konsultuar realisht me programet homologe perendimore sidomos me ato te vendeve te BE dhe merr ne konsiderate direktiven 2005/36/EC te Keshillit dhe parlamentit European. Ai ka pershtatur si model ate italian qe ka pervoje te mire ne kete drejtim dhe per implementimin e plote te ketij modeli ka ndertuar marrdhenie dhe ka lidhur marreveshje bashepunimi me universitete e spitale italiane. Konkretisht ka marreveshje te nenshkruar dhe ka kryer aktivitete bashkepunuese me Universitetin e Chieti-Pescara dhe spitalin S. G. Monastier, Treviso te Italise.</p>
<p>Standardi I. 5- Programet e studimeve ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë synojnë të plotësojnë kërkesat e tregut të punës në përputhje me nevojat për specialistë në fushën e mjekësisë.</p> <p>Kriteri 2 Numri i përgjithshëm i specializantëve dhe numri i atyre që e ndjekin këtë program studimi çdo</p>	<p>-Ky program studimi per specializim afatgjate ne Stomatologji eshte hapur bazuar ne kerkesat e tregut te punes per specialiste te ketij niveli ne keto profile. Do te ishte e arsyeshme te thonim jo nevoja te tregut, por uri e tij, pasi keto specialitete kane munguar ne</p>

<p>vit përcaktohet në përputhje me politikat shtetërore të zhvillimit të fushës së shëndetësisë dhe kapacitetet pritëse të strukturave të përfshira në rrjetin formues (në varësi të numrit të personelit, kapaciteteve pritëse, etj).</p>	<p>Ortodonti dhe po ashtu kane qene te shkrire me kirurgjine OMF per rastin e Kirugjise Orale.</p> <p>-Kete program studimi afatgjate nuk e ofron Universiteti yne publik dhe mundesia e vetme e atyre pak specialisteve qe kemi ka qene vetem studimi jashte vendit i tyre. Do ta konsideroja hapjen e ketij programi studimi nje kontribut te madh publik qe ofron nje institucion i arsimit privat.</p> <p>Edhe deshira e vete mjekeve stomatologe te diplomuar ne nivelin e dyte te studimeve ka qene nje shtyqe e nevojshme per hapjen dhe mirefunksionimin e tij.</p> <p>-Aktualisht ne kete program studimi jane te regjistruar e frekuentojne 48 specializante, 27 ne Kirurgji Orale dhe 21 ne Ortodonti te cilet do te kalojne ne sherbim me cilesine e specialistit ne vitin 2017. Eshte planifikuar qe te behen regjistrime ne keto programe cdo 2-3 vjet, cka shkon ne harmoni me nevojat e tregut te punes per specialiste.</p> <p>-Infrastruktura e nevojshme dhe stafi pedagogjik jane te afte per te pritur kontigjente edhe me te medha ne te ardhmen, por hapat e drejtuesve te Universiteti per kete problem jane te matura ashtu sic jane edhe per problemet e menxhimit te Universitetit ne pergjithesi.</p>
<p>Standardi I. 14- Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine, materiale mësimore të hartuara dhe të botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj.</p>	<p>-Institucioni publikon informacion te vazhduar, objektiv e me te dhena konkrete. Universiteti ka pergatitur nje katalog cilesor qe eshte ne qarkullim dhe pasqyron te dhena kryesore e te detajuara mbi gjendjen e aktivitetin e tij si dhe ecurine nder vite.</p> <p>-Faqja Web e Universitetit luan nje rol te dores se pare per shperndarjen e informacionit te nevojshem per studentet dhe gjithë te interesuarit e tjere qe lidhet me kushtet, kriteret e pranimit e te regjistrimit, mirefunksionimin e procesit mesimor, te dhena per stafin, mjediset, infrastrukturen etj. Sekretarite mesimore ne Universitet e ne dekanat jane ne dispozicion te studenteve e te te interesuarve per te dhene informacion sa here ju kerkohet dhe ne menyre te vazhduar. Edhe drejtuesit kryesor si Presidenti, Rektori dhe dekani japin informacion direkt te interesuarve sa here nje gje e tille eshte e nevojshme.</p> <p>-Permes nje sistemi dixhital qe funksionon mire cdo student ka mundesine qe permes nje fjalekalimi personal ta beje ate te aksesueshem dhe te informohet per cdo gje si oraret, datat e provimeve, notat, provimet e mbetura, eventet e ndryshme , ceremonite, aktivitete shkencore dhe cdo gje qe ai ka ineres. Te dhenat qe lidhen me aktivitetin e cdo studenti te vecante kane karakter konfidencial.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i specializimit afatgjate ne Stomatologji me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti ne Universitetin "Aldent" eshte hartuar ne perputhje me misionin dhe strategjite e tij per pergatitjen e plote te specialisteve te stomatologjise ne te tre nivelet.

Ky program studimi eshte i harmonizuar edhe me programet homologe te vendeve te BE dhe me gjere dhe zhvillohet per nevojat e sherbimit shendetesor te ne dhe kerkesat qe ka tregu yne i punes. Ai permbush pritshmerite e mjekeve te rinj stomatologe per tu thelluar me tej fushen e studimeve mjekesore dhe specializimin ne profile te vecanta te stomatologjise.

Ky program aktivizohet cdo 3 vjet, ato monitorohen e persosen vazhdimisht per tu pershtatur sa me mire me kerkesat e kohes e te zhvillimit shkencor ne stomatologji.

2. Struktura akademike e Fakultetit që ofron SPA

Fakulteti i Shkencave Dentare qe ofron programin e specializimit afatgjate ne stomatologji eshte pjese perberese e Universitetit "Aldent". Ai funksionon ne baze te rregullores se vet te brendeshme e cila buron nga Statuti dhe Rregullorja e Universitetit.

Fakulteti i Shkencave Dentare ka ne perberjen e tij 3 departamente:

1. Departamenti i Stomatologjise,
2. Departamenti i laboranteve dentare,
3. Qendra e formimit dhe sherbimit Klinik.

Lidhur me vendin qe Fakulteti i Shkencave Dentare ze ne strukturen e e Universitetit "Aldent" si dhe raportet e tij me strukturat e tjera te Universitetit duhet te shqyrtohet nen driten e Organigrames se tij .

Pedagoget e aktivizuar ne SPA ne "Stomatologji" me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti plotesojne tregues te larte shkencor e mesimdhenes. Nje informacion me te detajuar lidhur me gjeneralitetet e tyre dhe kriteret qe ata plotesojne jepet ne tabelen e meposhteme.

Ne procesin mesimor per SPA jane te regjistruar 48 specializante nga te cilet 27 ne Kirurgji Orale dhe 21 ne Ortodonti. Gjithashtu stafi mesimdhenes perbehet nga 28 profesore e specialiste nga te cilet 13 jane efektive te Universitetit "Aldent" dhe 15 jane te jashtem. Te gjithe pedagoget qe jane aktivizuar ne procesin e zhvillimit te procesit mesimor ne SPA jane me tituj e grada shkencore: Prof., Prof. As., PhD dhe vetem dy pedagoge efektive jane me Spa, ndersa nga pedagoget e jashtem jane 4 te tille. Te dhena mbi perberjen e profesoratit dhe shkallen e kualifikimit te tij jepen ne Tab.nr.1 (tab. 3, f.19).

Per realizimin me sukses te programit afatgjate ne SPA Universiteti ka ngritur strukturat e nevojshme, infrastrukturen e duhur dhe bazen materiale specifike sipas specialiteteve qe ofron. Per kete qellim eshte ngritur nje Keshill Drejtues i perbere nga profesoret me ne ze te Stomatologjise sone.




Tabela N.1

IAL	FAKULTETI SHKENCAVE DENTARE						
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Total
	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	Gjithsej	Tituj/ Grada	
Departamenti i Stomatologjisë	10	1 Prof 3 As Prof 2 Dr 2 Ma 2 Spa	10	2 Prof 1 As Prof 3 Dr 2 Ma 2 Spa	1	1 Ba	21
Departamenti i Laborant Dentar	12	1 As Prof 2 Dr 4 Ma 5 Ba	0		2	2 Ba	14
Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik	8	2 Prof 1 Dr 3 Ma 1 Spa 1 Ba	0		0		8
Në total	30	3 Prof 4 As Prof 5 Dr 9 Ma 3 Spa 6 Ba	10	2 Prof 1 As Prof 3 Dr 2 Ma 2 Spa	3	3 Ba	43

Tabela permbledhëse

Fakulteti Shkencave Dentare	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada	Gj	Tituj/ Grada
	30	12	10	6	3	0	43	16

Stafi Administrativ dhe Ndhmës	
Emër Mbiemër	Pozicioni
Enida Dobi	Sekretare
Luljeta Tafa	Sanitare
Edmond Mema	Koordinator i marrëdhënieve me jashtë
Orjeta Llopaj	Ekonomiste
Skerdi Hasnjoku	Mirëmbajtës

Tabela N. 2

Këshilli Drejtues i Specializmit

Emër Mbiemër	Titulli	Pozicioni (anëtar/Kryetar)
Merita Bardhoshi	Prof.Asc.	Kryetare
Agron Meto	Prof.Asc.	Anëtar
Adem Alushi	Prof.	Anëtar
Diana Brovina	Prof.	Anëtar
Ruzhdie Qafmolla	Prof.	Anëtar

Stafi pedagogjik, perberja dhe kriteret qe ai ploteson u verifikuan ne vend dhe jane paraqitur me detaje te Aneksi I qe ndodhet ne fund te raportit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI II- ORGANIZIMI AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV I INSTITUCIONIT ORIENTOHE T NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMIT	
Standardi II. 1- Personeli akademik dhe administrativ organizohet për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit.	
Kriteri 1 Struktura akademike dhe administrative e institucionit përmbush objektivat e programeve të studimit dhe objektivat strategjikë për zhvillimin e institucionit.	Nga te dhenat qe u moren pas verifikimit ne vend dhe takimeve me te gjitha strukturat e organizuara per zhvillimin dhe mbarevajtjen e programit te studimit ne SPA ne Universitetin "Aldent", po ashtu pas takimit e konsultimit qe u zhvillua me specializantet ku pati pjesmarrje te plote fizike dhe ne diskutime, rezulton se permbushen objektivat strategjike per zhvillimin institucional te tij. Mendoj se jane permbushur kerkesat lidhur ma stukturen akademike ashtu dhe ate administrative e te infrastruktures.
Standardi II. 2- Organizimi i institucionit është në përputhje me përcaktimet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, në përmbushje të misionit të tij.	
Kriteri 1 Organizimi i institucionit bëhet në përmbushje të misionit dhe qëllimit të tij.	-Universiteti "Aldent", ofruet i programit te studimit ne SPA, eshte i organizuar dhe funksionon mbi bazen e

<p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete një nga të cilët ofron studime në fushën e mjekësisë së paku për programet e integruara të studimeve në fushën e Mjekësisë, Farmacisë dhe Stomatologjisë.</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti ose Qendra Kërkimore Shkencore janë të përbëra, së paku, nga 3 shërbime/departamente me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar.</p>	<p>Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij dhe të udhëzimeve të MASH për problemet e specializimit pasuniversitar.</p> <p>Kerkesat e ligjit për autonomine dhe lirinë akademike të institucionit janë të sanksionuara dhe në Statutin e Universitetit, dhe rregulloret përkatëse duke mbështetur teresisht përmbushjen e misionit dhe qëllimit të institucionit.</p> <p>- Liria akademike e përcaktuar qartë në Statut siguron zhvillimin e lirë e krijues të mesimdhënjes e të kerkimit shkencor dhe është garanci për respektimin dhe realizimin e programeve e planeve mesimore të përcaktuara sipas misionit dhe qëllimit që ai ka Universiteti “Aldent” është i organizuar në 2 njësi kryesore si dhe në njësitë baze dhe ndihmëse të përcaktuara në statut për ushtrimin e autonomisë dhe lirisë akademike që i njeh ligji. Te dy fakultetet që janë në këtë Universitet përbehen nga tre njësi baze dhe konkretisht:</p> <p>-Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në përberjen e tij:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Farmacisë 2. Departamenti Infermjeri- Fizioterapi 3. Qendra e Kerkimeve Farmakoterapeutike. <p>-Fakulteti i Shkencave Dentare përbehet nga:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Departamenti i Stomatologjisë, 2. Departamenti Laborant Dentar 3. Qendra e Formimit dhe Shërbimit Klinik. <p>Departamentet si njësi baze kanë minimumi 7 pedagoge me kohe të plote si personel akademik ku minimumi 3 prej tyre kanë tituj dhe grada shkencore. Analizuar në vecanti çdo njësi baze është e kompletuar sipas kërkesave të ligjit.</p> <p>Universiteti “Aldent” ka faqen e tij zyrtare në internet emërtuar ual.edu.al</p>
<p>STANDARDI VII - INSTITUCIONI DISPONON NJË RREGULLORE TË DETAJUAR TË PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË</p>	
<p>Standardi VII. 1- Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe përditësohet çdo vit akademik</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja është hartuar në përputhje me standardet e specializimeve në mjekësi dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja hyn në fuqi në fillim të çdo viti akademik dhe përditësohet çdo vit të ri akademik.</p> <p>Kriteri 3 Kriteret e përcaktuara për një cikël specializimi në fillim të tij nuk mund të ndryshojnë gjatë përditësimeve vjetore të rregullores deri në</p>	<p>-Universiteti “Aldent” ka hartuar Rregulloren e programit të studimeve të nivelit të tretë në SPA sipas kërkesave të Ligjit për Arsimin e Lartë nr.9741, datë 21.07.2007 i ndryshuar si dhe të udhëzimeve përkatëse të MASH dhënë deri në kohën kur është aplikuar për licensimin e këtij programi studimi.</p> <p>-Aplikimi për lejen e nevojshme është bërë me datë 13.06.2013. Rregullorja e programit të studimit në</p>

<p>përfundim të atij cikli. Nëse janë të nevojshme, ndryshimet në rregullorët pasardhëse duhet të përjashtojnë shprehimisht ciklin e nisur të specializimit.</p>	<p>SPA ka hyre ne fuqi ne fillim te implementimit te programit per specializimin pasuniversitar ne Stomatologji, me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti ne vitin shkollor 2013-2014. Me pas Universiteti nuk ka pranuar kontigjente te reja te specializanteve ne keto fusha, keshtu nuk ka qene e nevojshme qe te behen ndryshime ne rregullore.</p> <p>Ky ndryshim parashikohet te behet kur te filloje nje kontigjent i ri ne SPA, gje te cilen autoritete e kane parashikuar ta bejne menjehere pasi te perfundoje ky brez specializantesh. Per momentin ata po ndjekin e monitorojne pergatitjen dhe mbaravajtjen e aty qe kane tashme ne proces. Nga ky preces ata presin te nxjerrin konkluzione dhe perfundime te sakta qe ti sherbeje pergatitjes se suksesshme te brezave te rinj te specializanteve. Keshtu kriteret e percaktuara per kete cikel studimesh mbeten te pa ndryshuara.</p>
<p>Standardi VII. 2- Hartimi dhe miratimi i rregullores ndjek procedurat dhe merr mendimin e institucioneve të ndryshme të parashikuara për këtë qëllim.</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja propozohet nga Këshilli i Profesorëve dhe aprovohet nga senati i institucionit që i ofron ato.</p> <p>Kriteri 2 Rregullorja e aprovuar nga senati merr aprovimin nga MSH dhe MASH para hyrjes në fuqi.</p>	<p>-Rregullorja e studimeve ne SPA ne Universitetin “Aldent” eshte propozuar nga Keshilli i Fakultetit te Shkencave Dentare dhe eshte aprovuar nga Senati i Universitetit. Nje kopje e kesaj Rregulloreje eshte paraqitur dhe ndodhet ne dosjen perkatese se bashku me kerkesen per akreditimin e programit te studimeve.</p> <p>-Kjo rregullore nuk ka kaluar per aprovim ne MASH apo MSH pasi ne kohen qe eshte bere kerkesa nuk ka patur ndonje dispozite ligjore apo akt nen ligjor qe ta kerkonte nje gje te tille.</p> <p>Drejtuesit e UAL jane te gatshem qe ta paraqesin ate per aprovim ne te gjitha instancat e nevojshme.</p>
<p>Standardi VII. 3- Rregullorja përcakton kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organeve drejtuese të programeve specializuese dhe tutorëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar qartë kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së përgjegjës të programit të specializimit dhe të këshillit drejtues.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së mjekut përgjegjës/tutor për çdo specializant si dhe detyrat e tij.</p>	<p>-Ne rregullore jane percaktuar qarte kriteret dhe menyra e perzgjedhjes se Pergjegjesit te Specializimit dhe te Keshillit Drejtues. Ne perzgjedhjen e tyre jane patur parasysh jo vetem kerkesat e rregullores, por dhe specializimet dhe pervoja e tutoreve ne universitetet e huaja dhe eksperiencat e meparshme shkencore e pedagogjike te tyre.</p> <p>-Pedagoget pergjegjes ne programin SPA ne Stomatologji me profil: Kirurgji Orale eshte Prof. As. Merita Bardhoshi dhe ne ate me profilin Ortodonti eshte PhD.Edlira Zere.</p>
<p>Standardi VII. 4- Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e pranimit të studentëve në programin e specializimit</p>	
<p>Kriteri 1 Në rregullore janë përcaktuar kriteret për aplikim (niveli i studimeve të kryera, kohëzgjatja dhe titulli i diplomës që kërkohet, nota mesatare, moshë, publikimet e kryera, etj) si dhe kriteret përjashtuese.</p>	<p>-Ne rregullore eshte percaktuar qarte cilet jane kandidatet qe mund te aplikojne per ndjekjen e studimeve ne SPA, dokumentacioni i nevojshem si dhe</p>

<p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet qartë dokumentacioni që duhet të dorëzohet kandidati për aplikim, mënyra e dorëzimit të dokumentacionit dhe afati përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore janë përcaktuar qartë pikët maksimale që mund të grumbullojë kandidati dhe pikët që i jepen kandidatit për çdo kriter të plotësuar (notë mesatare, publikime, etj) si dhe pikët maksimale dhe minimale që mund ti jepen kandidatit gjatë çdo testimi (me shkrim, me gojë, praktik, etj).</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e konkurimit dhe si duhet të aplikojë kandidati për specializim; përcaktohet sa kohë para datës së shpallur për testimet mbyllet pranimi i dokumentave.</p> <p>Kriteri 5 Aplikanti dorëzon një kërkesë me shkrim sipas formatit të përcaktuar në rregullore dhe që i bashkangjitet asaj. Aplikantit, në momentin e pranimit të dokumentacionit i jepet një vërtetim për aplikimin me numrin e tij identifikues gjatë procesit.</p> <p>Kriteri 6 Në rregullore është përcatuar qartë mënyra e zhvillimit të testeve, rradha e zhvillimit të tyre, sa ditë diferencë mund të ketë nga një testim tek tjetri për të njëjtin program dhe për programe të ndryshme specializimi.</p> <p>Kriteri 7 Në rregullore përcaktohet mënyra e përzgjedhjes së komisionit të provimit dhe kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e komisionit.</p> <p>Kriteri 8 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e vlerësimit të kandidatëve për çdo testim dhe dokumentacioni i përdorur i cili ruhet sipas procedurave të parashikuara në rregullore.</p> <p>Kriteri 9 Emërtimet e programeve të specializimeve të miratuara për vitin akademik, numri i specializantëve që do të pranohen për çdo program specializimi dhe taksat që duhet të paguajë specializanti për çdo specializim publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 10 Mënyra e vlerësimit dhe argumentet mbi të cilat kryhet testimi duhet të përcaktohen në rregullore dhe të publikohen të paktën 2 javë përpara datës së fillimit të aplikimeve.</p> <p>Kriteri 11 Në rregullore është përcatuar qartë mënyra dhe afatet e shpalljes së rezultateve të testeve dhe të listës përfundimtare me fituesit si dhe është përcaktuar vendi dhe data e shpalljes së rezultateve.</p> <p>Kriteri 12 Në rregullore përcaktohet qartë mënyra e lidhjes së kontratës me specializantët fitues.</p>	<p>procedurat perkatese per regjistrimin ne kete program.</p> <p>-Niveli i domosdoshem i studimeve qe duhet te kete kryer kandidati per te ndjekur ciklin e trete te studimeve ne SPA eshte se paku 5 vite akademike me kohe te plote per stomatologji dhe te kete grumbulluar jo me pak se 300 kredite (ECTS). Duke synuar pranimin e kandidateve cilesore, rregullorja ka përcaktuar qe nota mesatare e kandidateve duhet te jete jo me pak se 7.5 si dhe te plotesojne disa kriteret te tjera si te kete pervoje klinike jo me pak se nje vit, te kete kualifikime dhe pjesmarrje ne trajnime dhe aktivitetet te ndryshme profesionale e shkencore. Te gjitha keto kriteret vleresohen me pike dhe te gjitha bashke bejne nje shumatore sipas menyres qe eshte përcaktuar qarte ne rregullore. Ne rregullore eshte përcaktuar edhe menyra e aplikimit, e testimit, intervistes dhe piket qe grumbullon kandidati ne te gjitha keto faza, si dhe dokumentacioni i nevojshem, menyra e pranimit dhe e regjistrimit. Kerkesa specifike ka ne rregullore dhe per antaret e komisionit te perzgjedhjes se kandidateve per ne SPA, menyra si caktohen ata dhe kriteret qe duhet te kene.</p> <p>-Nga verifikimi i dosjeve te specializanteve ne sekretarine e Dekanatit te Shkencave Dentare rezulton se dosjet jane te plota, procedurat e perzgjedhjes se kandidateve jane respektuar konform rregullores dhe dokumentacioni ruhet e mirembahet mire.</p> <p>Kandidatet fitues pas regjistrimit kane lidhur kontratat perkatese nje kopje e te cilave ruhet se bashku me dosjen e tyre.</p>
---	--

Standardi VII. 5- Në rregullore parashikohen plani i çdo programi specializues, frekuentimi i tyre, transferimet e studenteve.

<p>Kriteri 1 Plani i detajuar i çdo programi specializues, lëndët dhe praktikat që duhet të frekuentohen, mënyra e frekuentimit, maksimumi i mungesave të lejuara dhe arsyet, leja e lindjes, dhe mënyra e rekuperimit të mungesave duhet të jenë të parashikuara në rregullore e specializimeve.</p> <p>Kriteri 2 Parashikohen procedurat për transferimet për apo nga programe të tjera specializuese, ose për apo nga institucione të tjera që ofrojnë programe specializuese në mjekësi.</p> <p>Kriteri 3 Parashikohen kriteret dhe mënyra e pezullimit, zgjatjes ose përjashtimit të specializantit nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Rregullorja parashikon rastet kur specializimi mund të kryhet në një institucion tjetër që nuk është pjesë e rrjetit formues (për shembull institucionet jashtë vendit), kohëzgjatjen e kësaj</p>	<p>-Ne rregullore e studimeve ne SPA eshte parashikuar menyra e frekuentimit te studimeve ne kete cikel dhe arsyet e mundeshme te mungesave si dhe menyra e rikuperimit te tyre. Specializantet jane te detyruar nga rregullorja perkatese te frekuentojne jo me pak se 70% te leksioneve e te seminareve dhe 100% te laboratoreve e te praktikave.</p> <p>-Rregullorja ka parashikuar edhe shkaqet e nderprerjes se studimeve, apo te transferimit te tyre deri ne 1 vit ne nje institucion tjetër jashte vendit, te njohur ne vendin tone.</p>
---	--

<p>periudhe dhe organin aprovues të kësaj procedure. Këto institucione duhet të jenë të akredituara për kryerjen e programit specializues në vendin përkatës.</p>	
<p>Standardi VII. 6- Në rregullore parashikohet librezja e studentit, tipologia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të provimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja parashikon formatin e librezës së studentit, mënyrën e plotësimit të saj dhe mënyrën e zëvendësimit të saj në rast humbje. Libreza e studentit e shoqëron atë deri në përfundim të ciklit specializues dhe diplomimit të tij.</p> <p>Kriteri 2 Përcaktohen tipologjia dhe mënyra e verbalizimit të rezultateve të testimeve të kryera për pranimin e kandidateve, testimeve vjetore dhe testimit përfundimtar.</p>	<p>-Ne SPA rregullorja ka parashikuar nje sistem te vecante per ruajtjen dhe verbalizimin e rezultateve nga pranimi ne kete cikël studimi deri ne testimin përfundimtar.</p> <p>Ne fillim te programit te studimit, specializanti pajiset me adrese dhe nje kod personal ku ai ka te drejte e mundesi te futetet online dhe te shohe te gjitha rezultate dhe vleresimet vjetore te tij. Ne sistemin e informatizuar te Universitetit ai mund te gjeje dhe te gjitha njoftimet qe jepen, leksionet, eventet e ndryshme qe zhvillohen aty apo qe UAL rekomandon. Nga verifikimet ne Sekretari perkatese, por dhe ne takim me specializantet rezultoi se kjo menyre eshte efektive dhe sherben per nje kontroll e monitorim reciprok, te dyanshem. Ne rast te nje gabimi te mundshem eshte vete specializanti qe kerkon verifikimin e me pas ndreqjen e gabimit. Duke pare online faqen e tij kandidati gjen edhe detyrimet e prapambetura dhe mundesine e shlyerjes se tyre.</p> <p>-Regjistrat e plotesuara ne menyre manuale, amza si dhe fletet e provimeve te specializanteve konsiderohen dokumente te rendesise se dores se pare dhe ruhen pa afat.</p>
<p>Standardi VII. 7- Në rregullore parashikohen procedurat për testimet vjetore dhe testimin përfundimtar si dhe formati i diplomës.</p>	
<p>Kriteri 1 Në rregullore përcaktohet mënyra e testimit vjetor dhe përfundimtar të specializantëve, pikët minimale dhe maksimale, lloji i testit dhe argumentet që testohen.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohen kriteret për përzgjedhjen e komisionit të testimit vjetor dhe të atij përfundimtar.</p> <p>Kriteri 3 Në rregullore përcaktohen rastet e mungesave të justifikuara në testime dhe mënyra e rekuperimit të testimit në këto raste.</p> <p>Kriteri 4 Në rregullore përcaktohet formati i diplomës. Diploma duhet të firmoset nga rektori, kryetari i komisionit të provimit përfundimtar/final dhe dekani i fakultetit përkatës.</p>	<p>-Sipas kerkesave te rregullores ne përfundim te cdo viti akademik organizohet provimi teorik dhe praktik per vleresimin e dijeve te fituara gjate atij viti dhe vleresimi behet me note.</p> <p>Ne përfundim te studimeve specializanti i nenshtrohet nje provimi përfundimtar i cili konsiston ne nje testim praktik paraprak dhe vijon me paraqitjen e temes studimore te pergatitur per mbrojtjen e diplomes. Per kete rregullorja ka parashikuar ngritjen e nje komisioni prej 5 antaresh, specialiste te fushes perkatese e me tituj shkencore dhe me eksperience ne fushen perkatese te stomatologjise e ne ate studimore shkencore. Pas kesaj plotesohet diploma e specializimit e cila firmoset nga Dekani dhe Rektori . Nje kopje e formatit te Diplomes se specializimit ndodhet ne dosjen perkatese.</p>
<p>Standardi VII. 8- Në rregullore parashikohen të drejtat dhe detyrat e specializantit.</p>	
<p>Kriteri 1 Rregullorja duhet të përmbajë detyrat dhe të drejtat që ka specializanti.</p> <p>Kriteri 2 Në rregullore përcaktohet tipologjia dhe</p>	<p>Rregullorja e studimeve ne SPA ka parashikuar te drejtat dhe detyrat especializantit.</p> <p>Ne fillim te studimeve ne SPA specializantet jane</p>

mënyra e sigurimit të specialistëve gjatë kryerjes së specializimit. Parashikohet tipi i policës së sigurimit dhe masa e mbulimit.

Kriteri 3 Në planin e programeve të specializimeve parashikohet se kur mund të kryhen veprimtari të caktuara të parashikuara nga këto programe, në ç'gradë autonomie mund të kryhen dhe çfarë aktiviteteve duhet të ketë kaluar me sukses specialisti për të zhvilluar disa aktivitete të tjera të parashikuara nga programi specializues, nën mbikqyrje ose në autonomi të plotë. Është përcaktuar një sistem vartësish të aktiviteteve të parashikuara.

Kriteri 4 Parashikohen rastet kur mund të pezullohet specializimi nga ana e specialistit dhe periudha maksimale e lejuar për pezullim, si dhe procedurat për të hequr dorë nga specializimi.

njohur me te drejtat dhe detyrat qe ata kane gjate studimeve e qe jane te specifikuara ne rregulloren e tij. Ai e ka mundesine qe te konsultohet periodikisht me keto kerkesa dhe te drejtat e tij.

Studentet jane te siguruar per te gjithë periudhen e studimeve dhe Fakulteti disponon dokumentacionin perkates qe lidhe me sigurimin e specializanteve.

-Gjate realizimit te ketij programi, specialisti merr njohurite e duhura teorike e praktike dhe te etikes profesionale si dhe nocionet e punes studimore shkencore qe e bejne te afte per te ushtruar detyren e specialistit ne fushen qe pergatitet.

Specializanteve u eshte bere e qarte qe ne fillim te studimeve permbajtjan e programit dhe jane te detyruar te marrin pjese aktivisht ne realizimin teorik e praktik te tij.

Objektiv kryesor ne programin e SPA eshte percaktuar te jete angazhimi i vazhdueshem i specializanteve ne punen klinike dhe ate studimore shkencore dhe nxitja e punes se tyre ne ekip. Kandidati eshte i detyruar te marre pjese ne aktivitetet e ndryshme klinike qe lidhen ngushte me fushen specifike ne te cilen ai specializohet. Permes ketyre aktiviteteve specialisti synohet te aftesohet ne:

-Pervetesimin e metodologjive dhe te njohurive te nevojshme klinike e kerkimore shkencore per te qene i afte ne zgjidhjen e situatave te nderlikuara klinike dhe per pune te pavarur studimore shkencore, prezantime e botime.

-Punen e pavarur ne klinike, laborator apo ne sellen e operacionit.

-Perdorimin e burimeve bashkekohore te informacionit, grumbullimin e rasteve e pergjithesimin e tyre, administrimin e informacionit.

-Perdorimin e teknologjive bashkekohore ne veprimtarine e tij klinike, por dhe per prezantime shkencore

-Pervetesimin e metodave te avancuara te grumbullimit, analizes dhe perpunimit te te dhenave.

Specializantet ne SPA ndjekin programin e studimeve te ciklit te trete jashte koehs se punes ne klinikat e tyre.

UAL u ka krijuar atyre kushtet e nevojshme per te realizuar programin e studimit afatgjate me karakter akademik e klinik. Atyre u eshte siguruar ne vazhdimesi mbeshtetja teknike per zhvillimin e aktivitetit klinik shkencor qe parashikon programi.

-Dekanati i Shkencave Dentare ka ne forme te shkruar dhe te informatizuar nje pasqyre te

	<p>pervitshme te kandidateve te regjistruar ne SPA dhe levizjet e mundshme te tyre. Jane te regjistruar edhe ata qe jane larguar para afatit dhe kane nderprere studimet. Nga kontigjenti prej 58 specializantesh qe jane regjistruar ne fillim te studimeve te ketij cikli jane larguar 10 persona ose 17.2% e totalit te regjistruar. Nga verifikimi rezultoi se kjo ka ndodhur pikerisht per shkak te kerkesave te larta dhe zbatimit rigoroz te rregullores. UAL e ka shperfillur impaktin ekonomik te ketij fenomeni duke e konsideruar kete nje fakt pozitiv qe i kontribuon rritjes se cilesise se studimeve ne SPA.</p> <p>-Specializantet ne SPA gezojne te drejten e pushimit vjetor 4 jave qe eshte e parashikuar ne ne stukturen mesimore te ketij programi.</p> <p>-Per mungesat per arsye shendetesore kerkohet te paraqitet raport mjekesor dhe keshtu eshte vepruar. Kur mungesat zene mbi 30% te ciklit apo modulit ky i fundit duhet te perseritet.</p> <p>-Ne rast leje lindjeje afati i specializimit eshte parashikuar te shtyhet per aq kohe sa zgjat leja e lindjes.</p> <p>-Kur ndodhin ngjarje te jashtezakonshme apo fatkeqesi familjare, specializanti mund te mungoje deri ne 30 dite me kushtin qe te shlyeje te gjitha detyrimet ne nje periudhe te me vonshme.</p> <p>-Aktualisht ne UAL jane te regjistruar dhe frekuentojne rregullisht studimet ne SPA 48 kandidate, prej te cileve 27 ne Kirurgji Orale dhe 21 ne Ortodonti.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Rregullorja e studimit ne SPA dhe programi i studimeve jane hartuar ne perputhje me kerkesat e Ligjit nr. 9741, date 21.05 2007 “Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar dhe akteve nenligjore e udhezimeve te MASH deri ne kohen kur eshte bere aplikimi per kete program studimi. Rregullorja eshte propozuar nga Keshilli i Fakultetit te Shkencave Dentare dhe eshte aprovuar nga Senati i Universitetit “Aldent”</p> <p>Rregullorja parashikon kushtet dhe procedurat e pranimit ne kete cikel studimi, informacionit, menytrat e vleresimit, te drejtat dhe detyrat e kandidateve qe vijojne studimet ne SPA si dhe menyren e pezullimit te studimeve dhe arsyet per te.</p>	

3. Personeli akademik dhe mbështetës

UAL ka bere nje pune te programuar per rekrutimin dhe specializimin e stafit akademik qe angazhohet ne implementimin e programit te studimit ne SPA dhe me mbarevajtjen e procesit mesimor, klinik e shkencor ne te.

Ne perzgjedhjen e personelit qe do te merret procesin mesimor e jo vetem, ne SPA eshte patur parasysh te kooptohen personalitete te fushes perkatese, qe kane tituj e grada shkencore dhe eksperience te gjate klinike e mesimdhene.

Ne tabelen me poshte jepen te dhena per personelin akademik qe UAL ka rekrutuar dhe qe po angazhohet ne realizimin e programit te SPA ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti

Tabela N. 3

Personeli Akademik Efektiv (Emër Mbiemër)		Titulli	Personeli Akademik me Kontratë		Titulli	Institucioni ku punon full time
1	Zana Cikuli	Porf.Asc.	1	Mehdi Alimehmeti	Prof	Fakulteti I Mjekesise Tirane
2	Arben Ndreu	Dr.Sh.	2	Sokrta Meksi	Prof	Dalje ne pension
3	Klodiola Dhamo	Dr.Sh.	3	Xhelil Koleci	Prof. Asc.	UBT
4	Ermal Tako	Dr.Sh.	4	Renzo Sorato	SPA	Privat
5	Dafina Xhako	Dr.Sh.	5	Diego Salvi	SPA	Privat
6	Edlira Zere	PhD	6	Irida Pano	Dr.Sh.	Fakulteti Shk.Mjekesore Teknike Tirane
7	Olja Tanellari	SPA	7	Nedime Ceka	Dr.Sh.	Ministria e Shendetesise
8	Merita Bardhoshi	Prof.Asc	8	Xheladin Ceka	Prof	Fakulteti I Mjekesise Tirane
9	Nineta Fino	SPA	9	Adem Alushi	Prof	Fakulteti I Mjekesise Dentare Tirane
10	Diana Brovina	Prof.	10	Ramazan Isufi	Prof	Fakulteti I Mjekesise Dentare Tirane
11	Jorida Shahinas	PhD	11	Mirela Tabaku	Dr.Sh	QSUT
12	Agron Meto	Prof.Asc	12	Manjola Lushi	SPA	Spitali Hygea
13	Ruzhdie Qafmolla	Prof.	13	Blerta Kika	SPA	ISHP
			14	Pranvera Cabeli	Prof.	UMB
			15	Albana Cela	Dr.Sh.	QSUT

Nga tabela e mesiperme vihet re se ne kete proces te rendesishem jane aktivizuar 28 profesore nga te cilet 13 ose 47% jane efektive dhe te tjeret me kontrate. Terheq vemendjen shkalla e larte e kualifikimit te tyre, eksperienca e gjate akademike e profesionale, ne raste te vecanta ata jane titullare te sherbimeve perkatese ne shkalle vendi.

Ne tabelen nr.4 jepen te dhena lidhur me shkallen e kualifikimit dhe raportet e personelit efektiv me ate me kontrate.

Tabela N.4

Titulli	PAE	PAK		Raporti PAE/PAK
		Vendas	Te huaj	
Profesorë	2	6		2/6
Profesorë të As.	3	1		3/1

Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet Europiane)	6	4		6/4
SPA (mbaruar në Universitetet Europiane)	2	1	3	2/4
Personeli Administrativ	5			5/0

Ajo që mund të theksohet nga të dhënat në tabele dhe verifikimi i situatës në vend, është se jo vetëm shkalla e kualifikimit të personelit është e lartë, por kontingjenti i konsiderueshëm janë të shkolluar e të kualifikuar në perëndim. Në përberje të personelit janë 10 pedagogë me PHD të mbrojtura në universitete europiane nga të cilët 6 janë efektive të UAL, 8 janë me titullin Profesor dhe 3 Prof.As.

Risi duhet konsideruar dhe aktivizimi i 3 profesoreve italiane, eksperte të fushave të këtij programi studimi të SPA në profilet perkatese. Ata zhvillojnë çdo javë leksione e praktika me specialistët duke sjelle përvojën e universiteteve të tyre në Shqipëri, në UAL.

Ka gjithashtu dhe një personel administrativ efektiv prej 5 vetash që është me kohë të plote në funksion të realizimit çësor të specializimit afatgjatë.

Duhet theksuar fakti se nga shqyrtimi i ngarkesës mesimore për çdo pedagog, rezultojnë se 85% të ngarkesës mesimore të këtij programi specializimi e përballon stafi akademik efektiv. Informacionin lidhur me raportin e personelit efektiv lidhur me atë me kontratë dhe personelit akademik me atë administrativ e jep tabela që sapo cituam.

Stafi pedagogjik dhe ai administrativ ka një eksperiencë të gjatë në punë dhe është i gërshtuar midis moshave ku ka harmonizim midis atyre në mosha e me përvojë të gjatë klinike e pedagogjike me një kontingjent të rinjesh të shkolluar në të gjitha nivelet me rezultate të larta, një pjesë e konsiderueshme e tyre në perëndim si në Itali, Gjermani, Japoni, Izrael etj. Të dhënat lidhur me moshën dhe eksperiencën në punë jepen në këto tabele:

Tabela 5

Personeli sipas titujve /gradave	Numri sipas moshës					
	(36-45)		(46-55)		(56-65)	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Profesorë					2	6
As. Prof			1	1	2	
Doktorë (PHD mbaruar në Universitetet Europiane)	4	2	2	1		1
SPA	2	2				2
Personeli Administrativ	2		3			

Personeli akademik efektiv dhe ai me kontratë kanë të lidhura kontratat e punës me institucionin ku përshkruhen qartë qellimi i lidhjes së saj, detyra që kryen, afatet e kontratës, paga dhe mënyra e dhenjes së saj si dhe të drejtat dhe detyrat e paleve, po ashtu rastet dhe mënyra e zgjidhjes së saj.

Ndryshime lidhur me përberjen e stafit akademik janë bërë në drejtim të shtimit dhe plotësimit sasior të tij, efektiviteti i rekrutuar për implementimin e programit të SPA në profilet Kirurgji Orale e Ortodonti që ka filluar në vitin 2014 dhe është në proces gjatë kësaj kohe nuk ka pësuar ndryshime.

Rekrutimi i personelit behet sipas kerkesave ligjore dhe rregullorese se institucionit duke perdorur nje sistem pikezimi qe paraqitet ne table e meposhtme:

Tabelë Vlerësimi për Stafin Akademik në procesin e Rekrutimit (total 100 pikë)				
Titulli / Grada	Botimet Brenda/ jashtë vendit	Eksperiencia e Punës	Rekomandime	Intervista
(30 pike)	(20 pike)	(30 pike)	(10 pike)	(10 pike)
<p><u>Pikezimi:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Master Shkencor - 10 pike • Doktor proc – 15 pike • Doktor – 20 pike • Prof.As.Dr – 25 pike • Prof.Dr.- 30 pike 	<p><u>Pikezimi:</u> Brenda/(jashtë)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Poster b.- 0.5 (0.8) x nr • Referim Oral – 1.0 (1.5) x nr • Botim /Paper – 2.0 (3.0) x nr • Libër – 5.0 x nr • Monografe – 2.5 x nr 	<p><u>Pikezimi:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Në fushën akademike - total 10 pikë • Në fushën profesionale – total 10 pikë • Në fushën e mësimdhënies -total 10 pikë 	<p><u>Pikezimi:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga akademikë të fushës –total 10 pikë • Nga akademikë jashtë fushe –total 5 pikë 	

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara	
<p>Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundur akreditimin jo më vonë se 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminon kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.</p>	<p>Programi i studimeve ne SPA ne Universitetin “Aldent” eshte hapur ne vitin 2014 dhe nuk ka patur ndryshime te kriterëve dhe standarteve qe nga hapja e tij.</p> <p>UAL ka kapacitetet e duhura ne personel shendetesor, akademik dhe administrativ per mirefunksionimin dhe realizimin e ketij programi.</p> <p>Universiteti eshte i organizuar sipas kerkesave te ligjit, ka organigramen e tij, e aprovuar ne instancat e brendeshme , por dhe nga Keshilli i akreditimit e Ministri i Arsimit dhe Shkences.</p> <p>Shih shtojca 6</p>
Standardi III. 3 - Rrjeti formues¹ plotëson kriteret minimale të parashikuara dhe është i përshtatshëm për të ofruar programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni plotëson kërkesat minimale të përgjithshme të parashikuara në këtë dokument përsa i përket rrjetit formues.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni duhet të plotësojë kërkesat minimale specifike për çdo specialitet të parashikuara në shtojcën 2 të këtij dokumenti përsa i përket rrjetit formues.</p>	<p>-Rrjeti formues i Universitetit i ka plotësuar kriteret e parashikuara dhe eshte i pershtatshem e i mjaftueshem per specializime afatgjate ne fushen e stomatologjise ne profile qe eshte lejuar.</p> <p>Universiteti “Aldent” nuk ka bere ndryshime te kriterëve dhe te standarteve qe pas hapjes se ketij programi ne vitin 2014. Strukturat dhe paisjet e</p>

¹ Me rrjet formues nënkuptohet bashkësia e të gjitha strukturave të përfshira në aktivitetet e parashikuara për secilin program specializues: strukturat qendrore/bazë, dytësore dhe komplementare.

Kriteri 3 Kërkesat e përgjithshme dhe specifike janë të organizuara sipas kriterëve të mëposhtme:

- a. Përshtatshmëria e strukturave dhe pajisjeve, me shërbimet përkatëse të përgjithshme dhe diagnostikuese dhe ekzistencën në to të specialiteteve të ngjashme
- b. Ekzistenca e numrit dhe procedurave praktike të mjaftueshme për një formim të plotë profesional
- c. Burime financiare të mjaftueshme
- d. Tutorë dhe pedagogë të përshtatshëm dhe ekspertë
- e. Strukturë organizative e përshtatshme, me kapacitetet e nevojshme profesionale
- f. Programim i aktiviteteve orientuese, analizuese sipas kërkesave të tregut dhe përcaktimi i një programi formues
- g. Seleksionimi dhe vlerësimi i studentëve
- h. Efikasiteti dhe efënca në aktivitetet e ndryshme të parashikuara.

Kriteri 4 Institucioni disponon dokumentacion që provon përbërjen e rrjetit formues dhe të gjitha strukturave të përfshira në formimin specializues (qendrore/bazë, dytësore, etj) dhe konvencionet eventuale me këto struktura dhe me ato komplementare.

Kriteri 5 Strukturat qendrore dhe dytësore të përfshira në formimin specializues duhet të jenë të akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore.

Kriteri 6 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron ekzistencën e shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve. Shërbimet e përgjithshme dhe diagnostikuese të pranishme në strukturat shëndetësore pjesë e rrjetit formues nuk mund të jenë të ndryshme apo inferiore nga ato të parashikuara në shtojcën 2 për akreditimin e strukturave.

Kriteri 7 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron ekzistencën e specialiteteve të ngjashme në strukturat shëndetësore pjesë të rrjetit formues, shërbimeve të përgjithshme dhe diagnostikuese të përfshira në formimin e specializantëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 8 Institucioni disponon dokumentacion që sqaron numrin e shërbimeve mjekësore që ofron për ushtrimin profesional të specializantëve (sipas shtojcës 2).

Kriteri 9 Institucioni duhet të disponojë dokumentacion që sqaron aktivitetin asistencial kompleksiv vjetor të strukturave të përfshira në rrjetin formues. Aktiviteti asistencial vjetor që kryhet nga specializantët në kuadër të formimit të tyre nuk mund të jetë më i madh se 30% e aktivitetit asistencial total që kryejnë strukturat e përfshira në rrjetin formues (sipas shtojcës 2).

nevojshme në këto universitete - janë të pershtatshme e sipas kekesave që ka programi i studimeve afatgjata për realizimin e plote e në kushte normale të tij.

-Në Universitetin "Aldent" që nga viti 2003 është hapur e funksionon Poliklinika Dentare e konvertuar pas hapjes së Universitetit në Qendra e formimit dhe e shërbimit klinik. Ajo është e pajisur me 28 unite dentare dhe mjekon 800-1000 paciente cdo vit. Institucioni ka një politikë ekonomike shumë favorizuese për pacientet që mjekohen këtu, ku shumica e pacientëve mjekohen falas ose me cmime minimale dhe kjo ka bërë që numri i pacientëve të shtohet cdo vit, cka është në dobi të procesit mesimor dhe specializimit afatgjatë në këto institucion.

-Në këto klinike janë krijuar kushtet dhe kryhen e gjithë gama e punimeve të thjeshta e të nderlikuara të kohës dhe mund të realizohen në vendin tone, përfshirë dhe aparatet ortodontike fikse dhe realizimin e interventeve operatore të veshitura e aplikimit e implanteve, që janë pjesë e programit të ketij specializimi.

-Institucioni UAL ka ndertuar të gjithë infrastrukturen e nevojshme për realizimin e tyre, i ka resurset mjekësore dhe materiale për të dhe ka ndertuar një politikë ekonomike shumë sociale për tërheqjen e pacientëve. Disa nga normativat e percaktuara janë objektivisht të pamundura për tu realizuar për faktin se frekuenca e tyre edhe pse në % mund të jete jete e perafert me popujt e tjere, nuk mund të hasen realisht aq raste në një popullsi prej 2.8 milion banorë. Marrja dhe implementimi mekanik i këtyre normativave nga vende me popullsi 50 apo 60 here më të mëdha se vendi ynë nuk me duket e drejtë dhe e konsideroj praktikisht të pamundur, ndaj një grup ekspertësh duhet ta rigjykojë atë në kushtet tona konkrete.

Gjithesesi kushtet janë dhe respektimi i sakte i protokolleve dhe procedurave të mjekimit i pergatisin specialistet, i aftësojnë ata për të trajtuar cdo rast sa do i komplikuar të paraqitet ai në jete.

-Sipas dokumentacionit të shqyrtuar rezultojnë një faktor pozitiv që ndikon edhe në mbarevajtjen e programit të studimit në SPA është gjendja financiare e stabilizuar e institucionit. Ajo ka një tendencë rritjeje progresivisht cdo vit, cka i ka krijuar mundësinë që vazhdimisht të rrisë investimet dhe të përmirësojë në mënyrë graduale dhe me ritme të kënaqshme infrastrukturen,

bazen materiale rritje keto qe nuk jane vetem sasiore, por edhe cilesore. Numri laboratoreve, sallave, ambjenteve kolektive per studentet jane rritur progresivisht duke kapur shifren per cdo student 8m2, per specializantet kjo shifer eshte dukshem me e larte. Ato jane paisur me te gjitha aparaturat e nevojshme, cilesore e te markave prestigjioze.

-Pervec pergatitjes qe u behet specializanteve nga mjeke eksperte te fushes perkatese, ata kane mundesine te punojne ne grupe te vogla gjate praktikave, te jene te vezhguar e monitoruar nga specialiste te afte te vendit e te huaj si dhe te kene tutore qe i drejtojne e udhezojne ne cdo rast.

-Programi i studimit ne SPA eshte hartuar e funksionon sipas kerkesave te tregut te punes .

Seleksionimi i kandidateve eshte bere sipas nje procedure te percaktuar qarte ne rregulloren e specializimit qe eshte hartuar para aplikimit per te marre te drejten e ketij programi specializimi.

Rezulton se jane respektuar kerkesat e rregullores dhe jane siguruar pergjithesisht kontigjente cilesore e me note te mire mesatare. Nga 58 kandidatet e regjistruar, 10 jane nga trojet jashte Shqiperise, Kosova, Maqedonia e Mali i Zi.

Universiteti "Aldent" disponon dokumentacionin e duhur qe verteton perberjen dhe organigramen e tij.

-Ky institucion arsimor eshte i akredituar ne disa programe studimi dhe eshte ne proces akreditimi ne disa programe te tjera studimi perfshire edhe SPA ne proffilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti.

Ne politiken institucionale te Universitetit "Aldent" per rritjen e vazhdueshme te cilesise se pergatitjes se specialisteve dhe te mjekimit te pacienteve ben pjese plotesimi i vazhdueshem i standarteve dhe akreditimi jo vetem i programeve, por dhe i sherbimeve ndaj pacienteve nga Qendra Kombetare e Cilesise, Sigurise dhe Akreditimit te institucioneve Shendetesore. Kjo eshte nje praktikte qe ndiqetpak ose fare nga institucione te ngjashme , perfshire ketu edhe ata shteterore.

Njesite mjekuese te Universitetit "Aldent" disponojne dokumentacionin e nevojshem qe verteton sasine dhe llojshmerine sherbimeve mjekesore qe kryhen ne klinikat e tij. Ai ka gjithashtu te dokumentura edhe gjithe aktivitetin klinik qe kane kryer specializantet dhe gamen e interventeve e mjekimeve te realizuara. Ky dokumentacion i fundit eshte i ndare nga aktivitetit

	<p>i pergjithshem mjekesor qe kryen vete institucioni.</p> <p>-Ne Universitetin “Aldent” ndodhet dokumentacioni i nevojshem qe qe pershkruan dhe verteton strukturen organizative dhe figurat drejtuese dhe profesionale qe jane angazhuar me ecurine dhe realizimin e plote te programit te specializimit afatgjate.</p> <p>Eshte aprovuar nga Senati Keshilli Drejtues i programit te SPA i cili perbehet nga figura te spikatura te Stomatologjise shqiptare dhe permbush te gjitha kriteret qe kerkon pozicioni i antarit te kshillit.</p> <p>Persa i perket menaxhimit ekonomik dhe financiar ne UAL, ai kryhet ne rang institucioni dhe nuk eshte i ndare sipas programeve te vecanta dhe ka persona pergjegjes qe ndjekin mbarevajtjen e programit edhe ne aspektin ekonomike financiar. Nga inetrivistat dhe kontrolli i dokumentacionit rezulton se te ardhurat vjetore nga programi i SPA jane te krahasueshme me ato qe realizohen nga programet e tjera, pra jane ne nivelin e studenteve, ndersa shpenzimet per plotesimin e kushteve dhe realizimin e programit ne SPA jane shume me te larta. Kjo tregon se nuk ka llogjike ekonomike hapja e ketij programi studimi per specializime afatgjate, ajo thjesht ka te beje me deshiren e drejtuesve te UAL per te ofruar programe studimi ne te tre nivelet.</p> <p>Ne Universitetin “Aldent” eshte e ngritur dhe funksionon Njesia e Sigurimit te Brendshem te Cilesise e cila monitoron cilesine e procesit mesimor ne te gjitha programet e studimit ne kete Universitet, ne kete kuader edhe ate te specializimit afatgjate ne profilet Kirurgji Dentare dhe Ortodonti.</p>
--	---

Standardi III. 4- Institucioni është i mirëorganizuar dhe disponon burime njerëzore të mjaftueshme për mirëfunksionimin e programeve specializuese.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që provon dhe përshkruan strukturën organizative dhe figurat drejtuese, akademike dhe profesionale të angazhuara.</p> <p>Kriteri 2 Çdo program specializues përcakton:</p> <p>a. Një figurë drejtuese, përgjegjësi i programit të specializimit. Përgjegjësi i programit të specializimit të ketë të paktën titullin “Profesor i asociuar” dhe 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.</p> <p>b. Këshilli i profesorëve përveç përgjegjësit të programit të specializimit, përcakton një këshill drejtues të programit të studimit i cili, në bashkëpunim me përgjegjësin e programit të specializimit, punon për përgatitjen, organizimin dhe kontrollin e programit të specializimit në fjalë.</p> <p>c. Një përgjegjës për menaxhimin ekonomik-financiar dhe</p>	<p>Institucioni arsimor dhe mjekesor Aldent disponon dokumentacionin e nevojshem ku jane te pershkruara ngritja dhe funksionimi i strukturave didaktike dhe profesionale qe menaxhojne e realizojne programin e SPA.</p> <p>Programi i specializimit afatgjate disponon ne nivel departamenti figura te kompletuara e me tituj shkencor si Professore, Prof. As. Dhe PhD. te fituara ne universitete perendimore. Te pakten nje profesor i brendshem eshte i ngarkuar me problemet e specializimit.</p> <p>Pedagoget e ftuar qe jane aktivizuar ne programet e specializimit afatgjate kane eksperience te gjate didaktike e shkencore dhe jane titullare</p>
--	---

<p>përmbushjen e kërkesave administrative. d. Të paktën një përgjegjës për monitorimin dhe vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>sherbimesh ne fushat perkatese. Specialistet e ftuar nga jashte qe aktivizohen ne keto programe specializimi, vijne cdo jave dhe kryejne nderhyrje e procedura te veshtiresise se larte. Ata jane pjese stafeve te universiteteve perendimore dhe specialiste me emer, te njohur ne Europe e ne bote.</p> <p>- Pedagoget e jashtem qe jane me kontrate qe jane eksperte te fushave shume specifike perbejne rreth 10% te stafit qe merret me realizimin e programit te specializimit afatgjate. Pjesa tjeter e stafit pedagogjik ka se paku graden shkencore "Doktor"</p> <p>Ne kete institucion cdo student ka nje pedagog tutor(udheheqes klinik)qe e ndjek dhe ndihmon ate gjate gjithë periudhes se specializimit, nje pedagog mund te kete ne udheheqjen e tij 2-3 studente. Eshte bere kujdes qe fusha e specializimit te udheheqesit te jete e njejte me ate te programit ku specializohet studenti. Ne raste te rralla ai eshte ne nje specialitet te afert te kesaj fushe. Per kete qellim Universiteti "Aldent" ka dhe kontrata bashkpunimi me specialiste nga institucione te tjere klinke e mjekesore dhe ofron asistence nga specialiste te nivelit te larte me te cilet ka marredhenie bashkepunimi shumevjecare kundrejt te gjitha procedurave e kerkesave te kodit te punes dhe ligjeve per punesimin. Per kete qellim Universiteti "Aldent" disponon dokumentacionin perkates.</p>
--	---

STANDARDI IV - PERSONELI AKADEMIK, SHËNDETËSOR, NDIHMËS MËSIMOR-SHKENCOR, ADMINISTRATIV DHE TUTORËT JANË TË MJAFTUESHËM DHE PLOTËSOJNË STANDARDET E PËRGJITHSHME SI DHE ATO SPECIFIKE TË PARASHIKUARA PËR ÇDO SPECIALITET

Standardi IV. 1 - Personeli i angazhuar në programet specializuese plotëson standardet e parashikuara

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshëm që përshkruan strukturën didaktike dhe figurat profesionale të angazhuara në programin specializues.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon personel akademik, pedagogë dhe tutorë, sipas specifikimeve në shtojcën 2.</p> <p>a. Pedagogë universitarë: profesorë, profesorë të asociuar dhe docentë, për jo më pak se 50% të pedagogëve të përfshirë në programin specializues. Të paktën një profesor i brendshëm është nga sektori disiplinor i programit të specializimit që ofrohet nga institucioni.</p> <p>b. Pedagogë jo universitarë që ushtrojnë profesionin në strukturat e rrjetit formues: personel me eksperiencë didaktike-formuese të dokumentuar dhe me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare pranë strukturave të përfshira në rrjetin formues, për një maksimum prej 50% të pedagogëve dhe me të cilët është lidhur një kontratë me kohëzgjatje të paktën sa kohëzgjatja e secilit program specializues.</p> <p>c. Pedagogë të jashtëm me kontratë: ekspertë të</p>	<p>Universiteti "Aldent" ka te percaktuara ne statutin dhe rregulloren e tij procedurat ligjore dhe menyren e rekrutimit te stafit akademik dhe ndihmes. Ky institucion ka bere kujdes ne sigurimin e stafit me te gjitha kriteret e duhura vecanrisht per SPA.</p> <p>Institucioni disponon dokumentacionin e nevojshem per stafin e rekrutuar sipas procedurave dhe rregullores se tij. E njejta procedure si ajo qe perdoret per stafin e studimeve universitare eshte ndjekur edhe per pranimin e stafit qe eshte ftuar te realizoje programin e specializimit afatgjate, por kriteret e vendosura per kete rast kane qene te nje niveli me te larte dhe qe i korespondon nivelit te studimeve te ofruara.</p> <p>Ne raste te vecanta kur ekspertet nuk mund te ofrohen me kohe te plote per shkak te angazhimeve te tjera te rendesishme, jane marre specialiste me kontrate.</p>
---	--

<p>sektorëve të ndryshëm disiplinorë, për një numër maksimal prej 10% të numrit total të pedagogëve, të cilët mund të angazhohen vetëm në mungesë të profesorëve universitarë.</p> <p>Kriteri 3 Numri dhe niveli i kërkuesve të angazhuar në këto programe përbën një garanci për realizimin e programeve (50% e tyre duhet të jenë personel akademik i brendshëm, të angazhuar në punën klinike dhe me tituj akademikë: “Profesor”, “Profesor i Asociuar” ose gradë shkencore “Doktor” apo “PHD” të fituar në universitete të mirënjohura në botë dhe të shquar për cilësi dhe veprimtari të pasur klinike/kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse.</p> <p>Kriteri 4 Numri i studentëve që mund të ndiqet nga një tutor është jo më i madh se 3 (tre).</p>	<p>Nga verifikimi i procedurës së ndjekur rezultoi se si rregull lajmerimi për një vend të lirë pune është dhënë në faqen e internetit të Universitetit “Aldent” dhe në rubrikën www.njoftime.com</p> <p>Bashkë me lajmerimin janë dhënë edhe kërkesat specifike për këto vende pune, kriteret që duhet të plotësojë kandidati, dokumentacioni që duhet të paraqesë dhe afati i zhvillimit të konkursit përkatës.</p> <p>Pas grumbullimit të dosjeve është ngritur një komision prej 5 anetaresh për shqyrtimin e dosjeve, i cili ka bërë pikezimin sipas tabelës së pikezimit të aprovuar nga senati. Pas kësaj është bërë dhe një intervistë dhe është përzgjedhur kandidati.</p> <p>Me një praktikë të tillë të qartë UAL ka mundur të rekrutojë kontigjente cilësore për mesimdhënës.</p> <p>Nga 28 pedagogë të rekrutuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 22 ose rreth 79 % janë me titull Prof. dhe Prof. As., dhe gradë Dr. i shkencave mjeksore ose PhD; - 6 ose 21% janë specialist të fushe së tyre dhe kanë krye SPA. Vetëm këta të fundit janë marrë nga struktura jashtë universitetit dhe janë specialiste me specializim të vecantë në fushën e vet si: reanimator, shëndet public, statisticien etj. <p>Pedagogë efektive në SPA janë 13 ose 47% dhe me kontratë 15 ose 53%.</p> <p>Ky institucion ka procedurë transparente të vlerësimit të stafit akademik dhe këto janë përcaktuar në vendimet e Senatit të Universitetit.</p> <p>Në kontratat e punës të stafit akademik dhe ndihmes përcaktohen detyrat për secilin punonjës në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet konkretë dhe sipas detyrave të ngarkuara.</p> <p>Zyra e personelit në këtë institucion disponon dosjet përkatëse të personelit dhe të dhënat e nevojshme për to.</p> <p>Numri i specializantëve që ndjek një pedagog tutor është deri në 3 të tillë</p>
<p>Standardi IV. 2 - Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit konform statutit dhe rregullores së përcaktuar nga vetë institucioni.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ndjek procedurë ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit dhe detyrave që u janë caktuar.</p>	<p>Institucioni i ka ndjekur procedurat ligjore të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit përgjithësisht me korrektesë.</p> <p>Nga verifikimi i procedurës së ndjekur rezultoi se si rregull lajmerimi për një vend të lirë pune është dhënë në faqen e internetit të Universitetit “Aldent”</p>

<p>Kriteri 3 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>dhe ne rubriken www.njoftime.com</p> <p>Bashke me lajmerimin jane dhene edhe kerkesat specifike per kete vend pune, kriteret qe duhet te plotesoje kandidati, dokumentacioni qe duhet te paraqese dhe afati i zhvillimit te konkursit perkates.</p> <p>Pas grumbullimit te dosjeve eshte ngritur nje komision prej 5 antaresh per shqyrtimin e dosjeve, i cili ka bere pikezimin sipas tabelës së pikezimit te aprovuar nga Senati. Pas kesaj eshte bere dhe nje interviste dhe eshte perzgjedhur kandidati.</p> <p>Ky institucion ka procedura transparente te vleresimit te stafit akademik dhe keto jane percaktuar ne vendimet e Senatit te Universitetit.</p> <p>Ne kontratat e punes te stafit akademik dhe ndihmes percaktohen detyrat per sejcilin punonjes ne menyre qe edhe vleresimi te te behet konkret e sipas detyrave te ngarkuara.</p> <p>Zyra e personelit ne kete institucion disponon dosjet perkatese te personelit dhe te dhenat e nevojshme per to. Ajo ka te dhenat per menyren si eshte bere njoftimi per pune per pozicionin e pedagogut, ka te dhena te plota per menyren si eshte rekrutuar personeli dhe per ecurine e tyre ne pune ne vazhdimesi, te cilat ruhen ne dosjen e sejcilit.</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni mund të ofrojë programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni, që ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj, plotëson të njëjtat standarde të përcaktuara për IAL-të që ofrojnë programet e studimeve specializuese të fushës së mjekësisë në gjuhën shqipe.</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer së paku pesë vjet studime në një institucion të huaj në të njëjtën gjuhë mësimdhënieje, ose disponon një certifikatë për njohje të avancuar të gjuhës së mësimdhënies të njohur ndërkombëtarisht në nivelin C1, dhe ka kryer së paku një vit studime në një institucion me të njëjtën gjuhë mësimdhënieje,.</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka mbajtur mbi 10 kumtesa shkencore në këtë gjuhë.</p>	<p>Universiteti “Aldent nuk ofron programe studimi ne gjuhe te huaj. Ai eshte i licensuar per mesimdhënie ne gjuhen shqipe.</p> <p>Ne rastet kur jane ftuar specialiste te huaj , ne SPA jane 3 te tille, institucioni ofron perkthim te tyre ne gjuhen shqipe.</p>
<p>Standardi IV. 4- Specializanti ka një tutor që e ndjek atë gjatë gjithë periudhës së specializimit.</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti ka një udhëheqës klinik (tutor) të diplomuar dhe specializuar në fushën e programit të studimit të aplikantit i cili ka një eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën klinike në fjalë dhe ka gradën “Doktor”.</p> <p>Kriteri 2 Studentit që ka një udhëheqës klinik që nuk është pjesë e personelit akademik të institucionit që ofron programin e specializimit, i caktohet dhe një udhëheqës</p>	<p>Ne Universitetin “Aldent” ku eshte ofruar dhe po realizohet programi i specializimit afatgjate ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti cdo specializant ka nje pedagog si tutor (udheheqes klinik). Ai e ndjek ate gjate gjithe periudhes se specializimit, veshtiresite, problemet dhe ndikon ne kapercimin e veshtiresive dhe plotesimin me sukses te programit deri ne mbrojtjen e temes dhe</p>

<p>akademik, anëtar i personelit akademik të institucionit me së paku gradën shkencore “Doktor” apo “PhD” (të fituar në universitete, të mirënjohura në botë) në fushën në të cilën vazhdon studimet specializanti.</p> <p>Kriteri 3 Këshilli i Profesorëve përzgjedh udhëheqësit klinikë, të aftë për të drejtuar punën klinike e kërkimore të specializantëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive klinike e kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.</p> <p>Kriteri 4 Tutori është i punësuar me kohë të plotë pranë njërës nga strukturat e rrjetit formues dhe ka një kontratë bashkëpunimi me institucionin që ofron programin specializues.</p> <p>Kriteri 5 Udhëheqësit klinikë punojnë për përditësimin e njohurive dhe aftësive të tyre, mbështetur në marrëveshjet institucionale, me qëllim mundësimin e shkëmbimeve të praktikave më të mira dhe dhënien e këshillave në mbështetjen efektive të studentëve.</p> <p>Kriteri 6 Udhëheqësi klinik i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit si edhe për zhvillimin dhe monitorimin e përparimit të punës klinike të studentit.</p> <p>Kriteri 7 Udhëheqësi klinik ka ekspertizën, formimin dhe udhëzimet e duhura për rolin e tij në udhëheqjen e specializantit në realizimin e studimeve specializuese dhe në veçanti të pjesës praktike/klinike.</p> <p>Kriteri 8 Udhëheqësi nuk mund të mbikëqyrë më shumë se 3 (tre) studentë njëkohësisht.</p> <p>Kriteri 9 Fusha e specializimit të udhëheqësit përputhet me atë të programit specializues që ndjek specializanti.</p> <p>Kriteri 10 Në të gjitha rastet, studenti ka vetëm një pikë të identifikuar kontakti, i cili duhet të jetë udhëheqësi klinik kryesor i tij. Nëse udhëheqësi kryesor nuk është në dispozicion, studentit i bëhet e ditur se cili do të jetë personi që do ta zëvendësojë.</p> <p>Kriteri 11 Institucioni siguron që udhëheqësi të ketë kohën e mjaftueshme për ta mbikëqyrur specializantin.</p>	<p>diplomimin e tij. Tutoret janë me eksperience profesionale shumevjecare, me pervojë në punën klinike dhe atë studimore shkencore, si rregull të fushës së specializimit ose të afert me të dhe që mbajnë të gjithë tituj dhe grada shkencore. Tutoret janë të punësuar me kohë të plote dhe kanë në udhëheqje 2 ose 3 specializante. Në tabelën (në fillim të raportit) janë paraqitur të dhëna të hollësishme të pedagogëve që kryejnë edhe tutorin në ciklin e studimeve në SPA. Ata janë me titull Prof. ose Pro.As., në disa raste janë Phd që e kanë marrë në universitete mjaftë të njohura kryesisht në Europë, por jo vetëm. Përzgjedhja e tyre është bërë ndërmjet specialistëve të fushës ku është ofruar ky program i SPA. Përfundimisht, në raste të vecanta tutorët janë përzgjedhur nga një fushë e përafert, por me tregues cilësorë dhe eksperience të spikatur në fushën klinike dhe atë studimore shkencore.</p> <p>-Ka rregulla të percaktuara edhe për rastet kur udhëheqësi është tërhequr apo larguar për arsye pune. Zëvendësimi i tyre është bërë duke marrë edhe mendimin e specializantit në të gjitha rastet kur një gjë e tillë ka qenë e mundur.</p> <p>Tutori i ka ndjekur specializantët gjatë gjithë procesit mesimor dhe veprimtarive klinike për realizimin e programit. Ata vë re tjerave ju kanë qartësuar specializantëve dhe problemet etike, sjelljen me koleget dhe personelin ndihmes, mënyrën e komunikimit me pacientet apo shqeruesit e mjaft probleme të hasura në praktiken e përditshme e jo domosdoshmerisht në libra.</p> <p>Universiteti “Aldent” ju ka siguruar tutorëve kohën e nevojshme për të mbikëqyrur mbarevajtjen e specializantëve si nga ana mesimore ashtu edhe ajo klinike duke bërë rregullimet e nevojshme në orarë dhe normuar kohën e punës.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti “Aldent” disponon një databasë të hollësishme me të gjitha të dhënat e duhura për personelin akademik dhe atë ndihmes që janë të përfshira në procesin e realizimit të programit të SPA. Po ashtu disponon të dhëna të hollësishme për personat përgjegjës që kryejnë edhe detyrën e tutorit.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhohet në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe të zhvillimit profesional të mëtejshëm të personelit akademik të angazhuar në program e të personelit mbështetës.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash të programeve të kualifikimit.</p>	<p>Ky institucion ka pervahe pozitive ne organizimin dhe realizimin e programeve per kualifikimin e vazhdueshem profesional te personelit te tij.</p> <p>Ai ka ambjentet dhe infrastrukturen e nevojshme per te kryer me sukses aktivitetet e tij per edukimin e vazhduar , madje dhe per ti vene ne dispozicion te te treteve per organizim konferencash, simpoziumesh, panaiere dentare dhe aktivitetet e ndryshme shkencore. Ne keto aktivitetet eshte i aktivizuar edhe personeli akademik i Universitetit “Aldent” qe ka referuar e ka marre pjese ne diskutime e polemika te karakterit shkencor.</p> <p>Per te gjitha keto ka programe te shkruara me afate perkatese e persona pergjegjes.</p> <p>Te gjitha te dhenat mbi aktivitetet e kryera brenda institucionit apo jashte tij jane te dokumentuara dhe ndodhen ne sekretarinerne perkatese duke filluar nga numri i pjesmaresve, tematika e trajtuar, diskutantet qe jane aktivizuar, pjesmarrja e specializanteve eshte e dokumentuar vecanerisht.</p> <p>Shume nga keto aktivitetet jane te akredituara dhe pjesmarresit jane vleresuar nga organizatoret me kredite.</p>
--	--

Standardi IV. 7- Institucioni mban një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore shkencore të personelit akademik të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të përfshirë në këtë veprimtari, në rast se ka, edhe të mbështetjes financiare të institucionit ndaj tyre.</p> <p>Kriteri 2 Baza e të dhënave përmban botime akademike (tekste, monografi, libra, artikuj) apo kumtesa në konferenca brenda a jashtë vendit.</p>	<p>Universiteti “Aldent” ka te dhena te sakta mbi aktivitetin shkencor dhe veprimtarine botuese te stafit te tij akademik. Ketu eshte krijuar nje arkiv i rregullt ku jane te dokumentuara aktivitetet e ndryshme shkencore e akademike qe jane kryer dhe ku ka patur pjesmarrje te pedagoqeve dhe personelit ndihmes te institucionit.</p> <p>Ne kete arkiv jane te perfshira dhe te gjitha botimet akademike e shkencore te realizura nga stafi e ketij universitetisi artikuj, libra, kumtesa etj. si per aktivitetet kombetare ashtu edhe ato ndrkombetare.</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- UAL i ka plotësuar ne menyre te kenaqeshme kapacitetet e nevojshme per realizimin e programit te ofruar nga ana e tij ne SPA ne Stomatologji me profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti. Ai ka te plotësuar infrastrukturen e nevojshme, sallat, klinikat dhe laboratoret e duhur , te cilat jane te pajisura me aparturat e nevojshme te kohes te cilat jane cilesore dhe ne gjendje te mire pune.
- Institucioni ka siguruar stafin e nevojshem qe ben te mundur realizimin me sukses te programit, te cilin e ka rekrutuar sipas te gjitha procedurave ligjore dhe rregullores se Universitetit. Ka mundur te siguroje nje staf cilesor ,me tituj e grada shkencore dhe me eksperience te pasur klinike e kerkimore shkencore.
- Punon me plane per kualifikimin dhe edukimin e vazhduar te stafit, ka kontrata te rregullta pune dhe mban marredhenie shume korrekte me stafin gje qe u evidentua nga vete ata. Ruan dhe dokumenton te gjitha aktivitetet akademike e shkencore qe jane kryer.

Ka te organizuar sistemin e tutoratit me specializantet i cili funksionon normalisht dhe i sherben realizimit cilesor te programit.

4. Infrastruktura dhe logjistika në funksion të programit të SPA

Universiteti “Aldent” ka pergatitur te gjithë infrastrukturen e nevojshme per realizimin programeve te licensuar te studimeve qe ai ofron ne te tre ciklet e tyre.

Universiteti “Aldent” ka organizuar infrastrukturen e nevojshme ne funksion te realizimit me sukses te programit te SPA. Ne dispozicion te specializanteve jane vene salla leksionesh e seminaresh me kapacitet 30-80 pjesmarres, 3 salla operatore, laboratore te pajisur me te gjitha paisjet e nevojshme, zyra, ambjente shlodhese, biblioteke, parkingje etj ne nje siperfaqe totale prej 3600m2 duke plotesuar keshtu te gjithë standartet e nevojshme per kete proces

- Ai ka ngritur dy kampuse kryesore: Kampusi Laboratorik qe ndodhet ne Rr.e Dibres nr. 235 dhe Kampusi Qendror qe ndodhet perball tij (Kampusi i trete qe ndodhet ne autostraden Tirane-Durres km -- perdoret per programet e infermierise).
- Per studentet e Shkencave Dentare jane vene ne dispozicion ambjente me siperfaqe rreth 3600 m2 ne te cilen perfshihen salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet nga 30-80 studente, ka laboratore te pajisur me aparaturat e nevojshme, zyrat e duhura per stafin dhe qeverine studentore, biblioteke, kafeteri, parking per studentet e stafin etj.
- Sallat e leksioneve dhe te seminareve jane te pajisura me video-projektore, tabela, karrike te rehatshme te paisura me tavoleta, kompjuter te lidhur me internet etj. Dritaret jane te pajisura me me grila nga brenda per te krijuar mundesine e projekSIONIT gjate zhvillimit te mesimit dhe ndricimi artificial dhe ai natyral jane ne parametra optimale.
- Gjthashtu personeli akademik dhe ai administrativ ka mjedise te vecanta e te mjaftueshme e komode per te kryer normalisht aktivitetin ee tij dhe per studim individual.
- Per biblioteke dhe informacion online jane vene ne dispozicion nje salle me kapacitet 45 vende leximi, 15 poste interneti dhe biblioteka me rreth 2500 tituj librash profesionale dhe qe pasurohet vazhdimisht.
- E konsideroj nje fakt pozitiv faktin qe Universiteti “Aldent” eshte i abonuar prej vitesh ne nje biblioteke online te Organizates Botrore te Shendetesise ku disponohen vetem libra me karakter mjekesor, e njohur ne bote dhe qe quhet “Hinari”. Studentet e Aldent, me nje fjalekalim personal kane akses ne kete biblioteke dhe mund te shfrytezojne informacion cilesor dhe aktual ne kohe reale.
- Te dy kampuset jane te pajisur me sistem qendror per ngrohje e ftohje te konceptuara nga ndertuesit qe ne projektim dhe qe kane kapacitet te plote per ambjentet e institucionit dhe qe funksionojne normalisht. Ka gjithashtu burime

alternative per furnizimin me uje dhe energji elektrike si dhe shkalle te dyfishta qe mund te perdoren ne rast emergjence.

- Eshte i pajisur me 25 nyje higjeno sanitare te paisura mire dhe me standarte higjeno sanitare mjaft te mira. Institucioni eshte i paisur me mjete e mbrojtjes kundra zjarrit, ruhet me roje private dhe eshte i pajisur e vezhgohet me kamera gjate 24 oreve.
- Klinika e Kirurugjise Orale eshte e vendosur ne katin e pare te Universitetit Aldent. Ajo eshte e pajisur me 2 unite dentare si dhe gjithë instrumentariumin e e duhur per realizimin e nderhyrjeve kirurgjikale ambulate dhe funksionon ne dispozicion te pacienteve dhe aty kruhen ndehyrje te tilla si heqje e dhembeve, heqje te dhembeve te pjekurise, te rrenjeve, incizione, kyretazhe etj. Te gjitha nderhyrjet kryhen nen mbikqyrjen e pedagogut dhe te asistentit perkates.
- Nderhyrjet me te komplikuara te Kirurugjise Orale si rezeksionet e apeksit , heqja e granulomave, kisteve, kirugjia preprotetike, paradontale, vendosja e implanteve etj. kryhen ne sallat e kirurgjise ku jane kompletuar e funksionojne tre ambjente operatore ne kushte optimale. Ketu ka aparatura specifike te specialitetit te Kirugjise si piezo-kirurgji, bisturi elektrike, motora implantesh, aparate per mjkimin me lazer etj.
- Te gjitha interventet kryhen nga specialistet ne menyre te planifikuar dhe jane te udhehequr nga tutori perkates dhe asistentet e tyre. Rastet diskutohen para dhe pas operacionit dhe ndiqet ne dinamike ecuria e tyre, keshtu krijohet mundesia nga nje rast i trajtuar te perfitojne te gjithë specialistet.
- Per aplikimin e implanteve per te cilat ka interes te vecante nga specialistet, pasi jepet i gjithë informacioni i nevojshem teorik dhe behen demostrime rastesh me ane te videosh, kalohen me aftesimin ne fantoma. UAL ka te ngritur nje salle te vecante ku ka 8 manekine ku specialistet ushtrohen dhe vetem pasi gjithcka si procedure tenike eshte e qarte, nen survejimin e vazhdueshem te tutorit perkates kalohen ne aplikimin e implanteve te pacientet.
- Aplikimi i implanteve shoqerohet edhe me ndjekjen e tyre me tej lidhur me protezimin mbi implante. Laboratori i protetikës fikse eshte i vendosur ne kompleksin laboratorik te Universitetit dhe disponon te gjitha hapsirat e duhura e sipas llojeve te punimeve qe kryhen. Eshte kompletuar me te gjitha paisjet e duhura laboratorit i pergatitjes se protezave mbi implante dhe specialistet marrin informacionin e duhur per te gjitha procedurat deri ne perfundim te mjekimit.

Klinika e Ortodontise ndodhet ne katin e pare te Universitetit "Aldent". Ajo eshte e kompletuar me te gjitha aparaturat e nevojshme dhe pergatitja e specializanteve behet duke punuar ne grupe te vogla dhe nen mbikqyrjen e pedagogut pergegjes e asistentit te tij. Gjthashtu po ne kete kompleks eshte vendosur dhe nje laborator ortodontic ku pergatiten te gjitha llojet e aparateve ortodontike dhe studentet e deges se laboratorit dentar bashkepunojne me specialistet e Ortodontise dhe bejne pergatitjen e aparateve nga marrja e mases e deri te aplikimi ne goje , gjithmone te monitoruar nga pedagogu tutor. Mjediset e laboreve jane me ndricim te mjaftueshem artificial e natyral, me dritare dopio xham dhe me ajer te kondicionuar.

Tabela N. 6

Mjediset për Fakultetin e Shkencave Dentare	Sasia	Sipërfaqja
---	-------	------------

Salla për leksione	6	440
Klasa për seminare	3	120
Salla për aktivitete promovuese	2	75
Laboratorë për lëndët dhe praktikat profesionale	10	500
Laboratore shkencor	3	90
Radiologji dhe diagnose me imazhe	4	30
Ambulatore	5	230
Laboratorë informatike	1	38
Salla internet (biblioteke online)	1	40
Salla për bibliotekë, rreth 3000 tituj	1	180
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	20
Zyrë informacioni për studentët	1	15
Korridore/holle	11	600
Mjedise sportive	1	150
Mjedise sherbimi per te trete	2	160
Mjedise per aktivitetet e qeverise studentore	1	40
Mjedise shlodhese si kafeteri/fast food,etj	1	200
Nyje hidrosanitare per studentet	25	185
m² per student	8m²/student	3090
Strukturë me shtretër	Bashkëpunimi i rregullt me QSUT dhe Spitalin e Traumës prej më shumë së 6 vitesh mundëson këto facilitete.	
Day Surgery		
Salla operimi		
Laborator mjekësor diagnostikues		

Mjediset për stafin Fakulteti i Shkencave Dentare	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	3	70
Zyra për sekretarinë mësimore	1	60
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	2	75
Zyra për personelin akademik	4	110
Zyrë për financën	1	30
Zyrë për Njësinë e SBC	1	20
Salla për mbledhje	1	70
Mjedis për stafin e shërbimit	1	40
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	3	20
		495
m² per person	15m²/person	

Dokumentacioni përkatës (planimetritë, të dhëna për teknologjinë e pajisjeve kërkimore) në Aneksin e RVB Te dhenat per kete pike jane me hollesi ne Anekset perkatese dhe ne kontratat afatgjata qe institucioni disponon dhe qe i ka nenshkruar ne menyre ligjore. Per studentet qe vijojne studimet ne ciklet 1 dhe 2 UAL ka siguruar nje siperfaqe prej 8 m²/student. Per specializantet qe jane me numur te kufizuar (48) kjo siperfaqe eshte dukshem me e madhe.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
STANDARDI III - INSTITUCIONI DISPONON TË GJITHA KAPACITETET INFRASTRUKTURORE,	

TEKNOLOGJIKE DHE ORGANIZATIVE TË NEVOJSHME TË PARASHIKUARA PËR REALIZIMIN E PROGRAMEVE SPECIALIZUESE AFATGJATA NË FUSHËN E MJEKËSISË	
Standardi III. 1- Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimit të të gjitha cikleve të studimit dhe në veçanti të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore.</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise duhet të jenë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme infrastrukturore dhe teknologjike. Ai disponon struktura administrative dhe klinike, të mjaftueshme për aktivitetet e parashikuara në programin e studimit specializues sipas standardeve specifike bashkëngjitur këtij dokumenti (Shtojca 2).</p> <p>Kriteri 4 Institucioni disponon struktura të akredituara për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme klinike dhe didaktike. Akreditimi i këtyre infrastrukturave kryhet nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore. Objekt i akreditimit janë strukturat përbërëse pjesë të rrjetit formues të njësisë që ofron programet e studimit specializues afatgjata në fushën e mjekësisë. Për struktura nënkuptohen strukturat fizike (departamentet, njësitë operative, shërbimet, qendrat, laboratorët, poliambulatorët, etj) pjesë e rrjetit formues ku zhvillohen aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për formimin e specializantëve. Veçanërisht objekt i akreditimit janë strukturat qëndrore të njësisë që ofron programet e studimeve specializuese afatgjata, si ato të fakultetit apo universitetit. Këto struktura si dhe menaxhimi organizativ, administrativ, didaktik dhe teknik shëndetësor dhe aktivitetet e lidhura me to, koordinimi dhe/ose drejtimi i tyre për çdo njësi që ofron programe studimi specializimi, duhet të jenë të përshtatshme dhe strukturat të pajisura mjaftueshëm për organizimin dhe realizimin e aktivitetit formues profesional specializues në fushën e mjekësisë. Edhe në rastet kur mund të ekzistojnë më shumë se një strukturë e akredituar si struktura qëndrore/bazë, vetëm një prej tyre mund të konsiderohet si strukturë bazë efektive e njësisë që ofron programet specializuese afatgjata. Objekt i akreditimit janë edhe strukturat dytësore të konvencionuara me strukturën qëndrore/bazë të cilat shërbejnë për të arritur ose kompletuar aktivitetin asistencial të kërkuar për formimin e specializantit, të cilat mund të jenë struktura universitare ose jo universitare, të të njëjtës strukturë spitalore ose jo. Në rastet kur programi i studimit parashikon frekuentimin e strukturave, shërbimeve, aktiviteteve, laboratorëve ose gjithçka tjetër që nuk bën pjesë në strukturën qëndrore/bazë ose në strukturat dytësorë të lidhura me të, institucioni që ofron programin e studimit lidh një kontratë ose konvencion me këto struktura komplementare. Në këto raste duhet të ketë marrëveshje të veçanta mes IAL-së dhe strukturës në fjalë dhe të respektohen standardet e parashikuara për strukturat qëndrore/bazë e dytësore.</p> <p>Kriteri 5 Akreditimi i strukturave të rrjetit formues bëhet pas verifikimit të plotësisë nga ana e IAL-së të standardeve të përshkruara në këtë dokument dhe në</p>	<p>Institucioni arsimor “Aldent” ndodhet ne nje seli te perhershme ne Rr. E Dibres nr. 235 ne Tirane. Aty ndodhen mjediset administrative dhe nje pjese e atyre ku zhvillohet mesim. Ne kete adrese dhe ne keto mjedise zhvillohet edhe programi i specializimit afatgjate ne Stomatologji ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti.</p> <p>Keto mjedise jane ne dispozicion te UAL me kontrata me afate te gjata kohore. Kontratat ndodhen ne anekse dhe jane nenshkruar konform me ligjin.</p> <p>UAL ka shume klinika te vecanta, 28 unite dentare dhe qe shfrytezohen nga specializantet gjate procesit te pergatitjes akademike e mjekesore te tyre.</p> <p>Ne dispozicion te specializanteve jane dhe disa laboratore me te gjitha paisjet e duhura per realizimin e plote te programit ne te dy profilet, Kirurgji Orale dhe Ortodonti.</p> <p>Te dhena per hapesirat ne dispozicion u paraqiten ne tab. Nr. 6, ku jepen llojet e laboratoreve, sasia, siperfaqja e tyre etj.</p> <p>Organizimi eshte bere i tille qe duke i pasur te gjitha keto mjedise, duke qene ata funksionalisht prane njeri tjetrit, te realizohet implementimi i plote i programit te specializimit nga ana teorike, praktike e laboratorike me cikël te mbyllur brenda Universitetit. Kjo mundeson specializantin te preke dhe te ekzekutoje cdo gje ne menyre direkte duke rrenjosur tek ai dije te qarta e te qendrueshme .</p> <p>Per raste te vecanta, per disa module qe kerkojne kushte shume speciale, Universiteti “Aldent” ka kontrata te nenshkruara e afatgjata me institucione shume te kualifikuara qe prej 6 vjetesh si me QSUT “Nene Tereza”, Spitalin Universitar te Traumes etj. qe japin ndihme mjeksore mjaft te kualifikuar dhe jane institucione mjeksore e shkencore te nivelit terciar</p> <p>Si specialist me duhet te sqaroj se kjo eshte e nevojshme vetem per raste vertet te vecanta, pasi per programet e specializimit qe Universiteti ofron, Kirurgji Dentare dhe Ortodonti, ato jane specialitete qe ne gjithë botën ushtrohen ne kushte ambulatorie te cilat institucioni i ploteson</p>

<p>aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe i jep të drejtën IAL-së që ofron programet specializuese të përdorë këto struktura për të organizuar e realizuar aktivitetin formues specializues për secilin specialitet. Strukturat e akredituara për një specialitet të caktuar mund të shtrijnë aktivitetin formues, me kërkesë të IAL-së, edhe në specialitete të tjera me kusht që të plotësojnë të gjitha standardet dhe kriteret e parashikuara për atë specialitet.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni mund të organizojë programe të përbashkëta të studimeve specializuese afatgjata me një a më shumë institucione të tjera në vend, të njohura/akredituara nga MASH/APAAL në bashkëpunim me MSH/Qëndrën Kombëtare të Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore, ose të huaja të akredituara për zhvillimin e programeve specializuese analoge në vendin përkatës, në bazë marrëveshesh midis tyre.</p>	<p>teresisht.</p>
<p>Standardi III. 2 - Strukturat e përfshira duhet të disponojnë standardet e përgjithshme dhe specifike të parashikuara</p>	
<p>Kriteri 1 Strukturat qëndrore dhe dytësore disponojnë standarde të përgjithshme në përputhje me kapacitetin infrastrukturor, teknologjik, organizativ dhe asistencial sipas kriterëve të mëposhtme dhe sipas kriterëve specifike të parashikuara në shtojcën 2:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kapaciteti infrastrukturor: hapësira të mjaftueshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti teknologjik: pajisje të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të parashikuara; Kapaciteti organizativ: kompetenca të nevojshme profesionale; Kapaciteti asistencial: sasi dhe tipologji të caktuar të ndërhyrjeve klinike. <p>Kriteri 2 Të gjitha strukturat (psh. auditorët, biblioteka, sekretaritë, etj.) plotësojnë standardet e përgjithshme.</p> <p>Kriteri 3 Struktura bazë është e pajisur me ambientet/pajisjet e nevojshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> për administratën dhe strukturat ndihmëse (sekretari didaktike, bibliotekë tradicionale dhe telematike, sallë mbledhesh, dhomë për specializantët) kompjuter në dispozicion të sekretarisë dhe administratës program të kompjuterizuar për menaxhimin e të dhënave të sekretarisë didaktike faqe interneti të tijin linja telefonike dhe pajisje për fotokopje salla për leksionet dhe seminarët laboratorë kërkimorë dhe didaktikë kompjuter në dispozicion të studentëve të pajisur me lidhje interneti dhe akses në bazat e të dhënave profesionale on line (së paku 1 kompjuter / 5 studentë) adresë poste elektronike personale për specializantët të ofruar nga struktura universitare ambulatorë dhe struktura asistencialë (me pajisjet e nevojshme teknologjike sipas specialitetit) ambjente spitalore me shtretër (në rastet kur janë parashikuar në standardet specifike të specialitetit në shtojcën 2) <p>Ambjentet më sipër sigurojnë standardet e sigurisë dhe ato higjienike dhe nuk kanë barriera arkitektonike që pengojnë aksesin në veprimtaritë e ndryshme të parashikuara nga programi i studimit.</p>	<p>-Institucioni Aldent plotëson standartet e përgjithshme dhe ato specifike që kërkojnë për kryerjen e ketyre specializimeve afatgjata në Kirurgji Orale dhe Ortodonti.</p> <p>Ai ka kapacitete të mjaftueshme të personelit shkencor, mesimor e administrativ, kapacitetet teknologjike dhe infrastrukturën e nevojshme për të perballuar kontigjentin e specializantëve që ndjekin këtë program, me cilësi të duhur dhe me kërkesa të plota.</p> <p>Kapacitetet infrastrukturorë janë plotësuar mirë, ata janë në kufijte maksimale të asaj që kërkojnë nga MAS dhe janë aktualisht në nivelin 8m²/student.</p> <p>Universiteti “Aldent” është i pajisur me aparaturë moderne si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - unite dentare në gjendje shumë të mira pune , në shumicë të reja, - ka aparate grafie dixhitale, - motora për implante, - piezokirurgji, - aparate me lazer, - furra porcelani cilësore, - aparate derdhje metalesh, të polimerizimit të rezinës etj. <p>ku specializantët jo vetëm mesojnë anën kirurgjikale të operacioneve, por dhe perfundimin e mjekimit dhe protezimin e të semurit apo përgatitjen e aparateve ortodontike pavarësisht nga shkalla e vështirësisë së tyre.</p> <p>Universiteti “Aldent” ka siguruar stafin e nevojshëm, të mjaftueshëm dhe me kriteret e duhura për zhvillimin e SPA.</p> <p>Klinikat e Aldent realizojnë të gjitha tipologjitë e</p>

<p>Kriteri 4 Çdo program specifik i specializimit plotëson standardet specifike sipas tipologjisë së specializimit (psh. laboratorë specifikë, shërbime, shtrime spitalore, etj.) sipas shtojcës 2. Standardet specifike ndahen në:</p> <ol style="list-style-type: none"> bazë: standarde që duhet domosdoshmërisht të përmbushen si nga struktura bazë dhe nga strukturat dytësore/satelite. dytësore: standarde që, për të plotësuar kriteret e akreditimit të strukturës, duhet të plotësohen si nga struktura qëndrore edhe nga ajo dytësore ose nga strukturat të tjera të IAL-së sipas një përqindjeje të caktuar të parashikuar për akreditimin. Nëse nuk plotësohen as nga struktura bazë e as nga ajo dytësore duhet të plotësohen nga strukturat komplementare me të cilat ka një marrëveshje bashkëpunimi. shërbime të përgjithshme: janë shërbimet operative që duhet të ketë struktura në të cilën bën pjesë struktura qëndrore ose ajo dytësore që do të akreditohej. <p>Kriteri 5 IAL-të duhet të komunikojnë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha ndryshimet e kriterëve dhe standardeve që kanë mundësuar akreditimin jo më vonë se 30 ditë nga ndryshimi. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës ekzaminonjë kriteret dhe standardet e ndryshuara dhe japin miratimin e tyre mbi këto ndryshime.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni që ofron programet specializuese ka kapacitete të mjaftueshme në personel shëndetësor, ndihmës dhe administrativ kompleksiv në strukturat qendrore dhe dytësore për të mbuluar nevojat e specialiteteve të ofruara, në bazë të kapaciteteve.</p> <p>Kriteri 7 Institucioni që ofron programet specializuese është i mirëorganizuar dhe disponon dokumentacion që tregon mënyrën e organizimit dhe strukturën drejtuese si dhe personelin administrativ dhe akademik me titujt përkatës si dhe rolet e parashikuara për secilin.</p>	<p>operacioneve dhe aparateve ortodontike që kërkon programi dhe që janë të detyrueshme për tu kryer gjatë specializimit. Për ato procedura që ka kërkesa nga paciente dhe rastet klinike nuk mungojnë, specializantët që ndjekin SPA kanë kryer procedura e kanë mjekuar paciente me teper se ato që kërkon programi.</p> <p>Institucioni ka biblioteke me një numur të konsiderueshem tituj librash, ka biblioteke online dhe sekretari dixhitale. Struktura universitare Aldent ka ambjentet e nevojshme për administratën e saj, sekretarite, salla biblioteke, dhe salla mbledhjesh bile dhe për të treta, salla e mjedise për specializantë etj.</p> <p>Sekretaria mban e ruan rregullisht dokumentacionin shkresor, por dhe është e kompjuterizuar dhe e pajisur me shumë kompjutera.</p> <p>Institucioni Aldent ka faqen e tij të internetit www.ual.edu.al.</p> <p>UAL ka linja telefonike, kompjutera të lidhur me internet në dispozicion të specializantëve, paisje fotokopjuese dhe të gjitha këto shërbime në favor të studentëve kryhen falas.</p> <p>Ka marrëveshje të shkruara me QSUT “Nene Tereza” dhe Spitalin Universitar të Traumës nëse lind nevoja për to, megjithatë programet e SPA që ka ofruar në Kirurgji Orale dhe Ortodonti kryhen në kushte ambulatorë. Ka kapacitete të mjaftueshme në personel mjekësor dhe ndihmes për të mbuluar nevojat që ka në specialitetet e ofruara dhe ngarkesa e stafit akademik është brenda parametrave që perkrijnë udhezimet e dhena nga MAS.</p> <p>UAL ka një organigramë të përcaktuar dhe të aprovuar nga instancat përkatëse dhe përmbush kriteret për numrin, përberjen dhe cilësinë e stafit akademik dhe administrativ e ndihmes për implementimin e suksesshem të programit të SPA.</p> <p>Institucioni disponon gjithë dokumentacionin e nevojshëm që tregon mënyrën e organizimit dhe të funksionimit normal të tij.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Institucioni Aldent ka infrastrukturen e nevojshme të mjaftueshme e të mirepajisur me të gjitha aparaturnë, pajisjet dhe materialet e teknologjive të duhura për realizimin me sukses të programit të studimit specializim afatgjatë në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti.</p> <p>Ka në dispozicion një bibliotekë të pasur me botime të viteve të fundit në specialitetet ku kryhen specializimet, ka gjithashtu mundësinë e shfrytëzimit të literaturës mjekësore nga biblioteka e</p>	

Organizates Boterore te Shendetesise “Hinari” ku institucioni eshte i abonuar dhe cdo specializant me nje fjalekalim individual ka akses ne shfrytezimin e saj.

Sallat e leksioneve dhe seminareve dhe labororet e IT jane te paisur me teknologjine e kohes.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Universiteti “Aldent” eshte nje institucion privat i Arsimit te larte ne Shqiperi . Specifika e tij eshte se ai financohet nga burimet e tij te brendshme te financimit. Politika e tij e zhvillimit dhe e financimit bazohet ne ecurine graduale, menxhimin e kujdesshem te burimeve te brendshme dhe vendosjen e proriteteve

Burimi financiar i vetem Universitetit “Aldent” jane tarifat e studenteve, per te cilet nuk ka asnje tarife shtese pervec asaj te studimit dhe qe eshte caktuar e palet jane dakortuar qe ne fillim te studimeve.

Tarifat e studimit ne Stomatologji dhe Farmaci jane me te ultat ne tregun shqiptar, pavaresisht se kushtet e ofruara dhe niveli i njohurive te dhena jane nga me te mirat gje qe deri sot tregu yne e ka perligjur.

Tarifat e studimit ne SPA jane ne nivelin e tarifave te studenteve edhe pse kostoja e studimit te tyre eshte dukshem me e larte nga ajo e studenteve.

Qellimi i drejtuesve kur kane hapur programin e studimeve ne SPA ka qene qe te ofrojne edhe studime te nivelit te trete dhe ti japin tregut nje kontigjent specialistesh qe atij i mungon dhe qe nuk ka qene e mundur te ofrohej ne institucione a menyra te tjera brenda vendit.

Ne tab. e meposhtme do te paraqiten te dhena se si kane ecur te ardhurat, investimet dhe shpenzimet ne 5 vitet e fundit e kjo tregon qarte per nje ecuri financiare pozitive te UAL.

Tabela N. 7

Të ardhurat nga:	2010	2011	2012	2013	2014
Fonde publike:					
Pushteti qendror	-	-	-	-	-
Pushteti vendor	-	-	-	-	-
Gjithsej	-	-	-	-	-
Fonde jopublike:					
Grantet për kërkim dhe kontratat	-	-	-	-	-
Konsulencat, shërbimet	-	-	-	-	-
Tarifat (regjistrim/shkollim/etj)	42,076,541	64,888,968	105,524,299	36,953,626	200,979,985
Sponsorizimet	-	-	-	-	-
Tarifat për trainim (kualifikimi i vazhdueshëm)	-	-	-	-	-
Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	-	-	-	-	-
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	-	-	-	-	-

Gjithsej	-	-	-	-	-
SHUMA	42,076,541	64,888,968	105,524,299	36,953,626	200,979,985

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II. 3- Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të gjendjes financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjitha detyrimet financiare, pagat dhe mbështetjet financiare të programit.</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja dhe kontratave të shërbimeve në lidhje me programin e studimit.</p>	<p>Krahas detyrave si institucion i arsimit të lartë edhe pse privat për nga menyrë e financimit Universiteti “Aldent” është i ndergjegjishëm për impaktin social që ka aktiviteti i tij në përgatitjen e specialisteve të lartë të fushës së mjekësisë e tani të specialisteve në SPA.</p> <p>Krahas këtyre detyrimeve ky Universitet ka edhe detyrat e tij specifike si biznes, që paguan rregullisht taksat dhe tatimet ndaj shtetit dhe obligohet me ligj që të hartojë një bilanc ekonomik vjetor. Ky bilanc i është nënshtruar auditimit të brendshëm nga eksperte të licensuar. Ai është monitoruar nga strukturat shtetërore e tatimore në mënyrë periodike dhe rezultojnë të jete një aktivitet i rregullt dhe që nuk ka asnjë problem lidhur me detyrimet ndaj shtetit, me studentet e specializantët apo me të tretët.</p> <p>Universiteti “Aldent” funksionon si entitet ekonomik unik dhe jo në baze programesh studimi.</p>
STANDARDI VIII - INSTITUCIONI DISPONON DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE	
Standardi VIII. 1- Institucioni harton një raport financiar të kostos së programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të kostove të përfshira në realizimin e programit të studimit, si kostot operacionale, kostot fikse të ambienteve dhe të pajisjeve, kostot e personelit, etj.</p> <p>Kriteri 2 Raporti financiar përmban të ardhurat e programit për vitet e kaluara akademike.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së programit të studimit dhe dëshmon se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 4 Programi i studimeve specializuese mbështetet nga një buxhet i mjaftueshëm për të arritur objektivat e programit për çdo student.</p>	<p>Institucioni arsimor Aldent ka hartuar çdo vit bilanc financiar ku janë paraqitur të gjitha të dhënat e domosdoshme si të ardhurat, shpenzimet për paga, sigurancë, tatime, shpenzimet për lende të pare dhe materiale konsumi stoatologjike dhe jo vetëm, për IT, për libra e revista, për kërkimin shkencor, për qerata dhe gjithçka tjeter që lidhet me infrastrukturen e institucionit. U theksua me lart se nuk ka bilance të vecanta sipas programeve të studimeve, ndonjë prej të cilëve mund të mos figurojë ndonjë vit rentabel, por funksionon si një entitet i vetëm ekonomik.</p> <p>Universiteti “Aldent” rezultojnë të jete një institucion që manifeston qëndrueshmëri ekonomike ndër vite dhe kjo ka bërë që në mënyrë progresive të shtojë investimet nga viti në vit dhe të hapë programe të reja studimi.</p> <p>Kështu ai ka shtuar sipërfaqet në dispozicion të studenteve duke përbushur një detyrë që i ka lënë kohe me pare MAS dhe duke arritur sot në</p>

	<p>parametra normale prej 8m² per student.</p> <p>Investimet jane shtuar edhe ne pasurimin e paisjeve teknologjike, blerjen e baze materiale nga firma prestigjioze e shoqeruar me certifikate cilesie dhe origjine te mallit. Investime te spikatura jane bere edhe ne drejtim te shtimit te stafit akademik , sidomos te atyre me tituj dhe grada shkencore dhe ne fushen e kualifikimit te vazhduar te tyre.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Universiteti “Aldent” ka nje situatë te qendrueshme ekonomike me nje rritje progresive nder vite. Ai financohet na burimet e brendshme ku ate qe ka fituar e investon per rritjen e metejshme te institucionit dhe te programeve te studimit qe ofron.</p> <p>Ka rritur ne menyre graduale infrastrukturen, siperfaqet, labororet, bazen materiale e aparaturat bashkekohore dhe stafin e kualifikuar.</p> <p>Ka raportet financiare korrekte me shtetin dhe me te tretet.</p> <p>Treguesit e tij ekonomike jane rritur nder vite vazhdimisht.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Universiteti “Aldent” ne perputhje me kerkesat e Ligjit Per Arsimin e Larte ne Republiken e Shqiperise Neni 59 dhe akteve nenligjore qe rrjedhin prej tij, ka ngritur nje stukture te posacme qe lidhet me permiresimin e cilesise se punes mesimore dhe pergatitjen e specialisteve te afte e me kerkesa bashkekohore klinike e studimore, Njesia e Sigurimit te Brendshem te Cilesise. Kjo njesi ka autonomi operative dhe akses te plote ne te gjitha te dhenat e institucionit cka eshte specifikuar edhe ne rregulloren e tij.

Universiteti “Aldent” i ka kushtuar vemendje te vecante rritjes se cilesise duke percaktuar strategji afatmesme e afatgjate per rritjen e saj.

Fillimisht eshte hartuar rregullorja perkatese dhe eshte bere ngritja e struktures se Njesise se Sigurimit te Brendshem te Cilesise dhe plani perkates i punes. Jane hartuar dhe me pas aprovuar nga Senati formularet e pyetsoreve te cilet jane implementuar e permiresuar nga vit ne vit qe nga viti akademik 2010-2011 kur jane perdorur per here te pare. Ne kete proces jane marre parasysh Udhezuesi per ngritjen dhe funksionimin e NjBSCne IAL si dhe Manuali per sistemin e Sigurimit te BC ne institucionet e Arsimin te larte.

Vleresimi dhe monitorimi jane bazuar ne disa kriteret te rendesishme sic jane: Arritja nga pedagogu e objektiveve te lendes, pelqyeshmeria e specializanteve lidhur me te, angazhimi i pedagogut per permiresimin e vazhdueshem te cilesise se leksioneve, seminareve e te praktikave, angazhimi i pedagogut ne kerkimin shkencor brenda e jashte vendit , cilesia e botimeve qe jane kryer apo qe jane ne proces etj.

Ne keto vite institucioni ka haruar dhe perdorur pyetsore qe jane plotesuar nga studentet dhe qe bejne te mundur vleresimin e cilesise se mesimdhënies dhe cilesine e punes se pedagogut.

Pyetsoret jane plotesuar elektronikisht nga studentet kurse rezultatet jane gjeneruar automatikisht per lendet e pedagoge te vecante dhe jane hartuar raporte me problemet

qe kane dale. Tipi i pyetsorit ka ndryshuar e eshte persosur vazhdimisht. Te gjitha ndryshimet jane miratuar nga Rektori. Ne fund te cdo viti mesimor NJBSC duke shfrytezuar gjithe informacionin vjetor qe ka mbledhur nga te gjithe strukturat akademike te Institucionit, ka hartuar nje raport vjetor vetevleresimi. U kontrollua raporti i viti shkollor 2014-2015.

Perpjekjet per permiresimin e cilesise dhe sigurimin e saj ne Universitetin "Aldent" kane perfshire edhe monitorimin periodik (vjetor) te kurikules se programit te studimit. Kjo ka bere qe te permiresohet e pasurohet ajo vazhdimisht duke synuar progresin e vazhdueshem shkencor e pedagogjik.

Eshte kryer monitorimi i programit te SPA nga NJBSC per ecurine e procesit mesimor me formulare te hartuar enkas per specializantet, te cilet jane plotesuar elektronikisht prej tyre dhe per problemet qe kane dale eshte informuar Rektori dhe strukturat menaxhese, eshte diskutuar ne senat e jane marre masat perkatese. Anketime jane realizuar ne fund te vitit akademik ne fund te 2 viteve te studimit ne SPA.

Tabela N. 8

Viti Akademik	Numri i programeve të anketuara	Numri i studentëve të anketuar	Numri i pyetjeve të përfshira në formatin e pyetësorit	Problematikat kryesore të hasura	Masat e marra për përmirësimin e problematikave të hasura
2013-2014	2	56	10	Disa pedagoge, sistemi elektronik i sekretarisë	Është instaluar edhe përmirësuar sistemi dhe shërbimet e tij.
2014-2015	2	48	10	Disa pedagoge, lëndë të vështira, mësim interaktiv, palester	Jane kontaktuar pedagoget, eshte stimuluar forma interaktive e mesimdhënies, përmirësuar format e vlerësimit të studentëve.

Njesia e SBC ka raportuar problematikat edhe ne Fakultetin perkates lidhur me rezultatet e pyetsoreve, pedagoget jane informuar per cdo vrejte ne adrese te tyre.

Eshte kerkuar edhe sensibilizimi i specializanteve mbi rendesine e te mesuarit rregullisht.

Per te monitoruar permiresimin e cilesise ka patur politika konkrete qe bazohen si ne auditimin e strukturave perkateses te institucionit ashtu edhe ne pyetesoret e plotesuar prej studenteve dhe zgjidhja eshte bere sistematikisht per tyre gjitha problemet qe kane dale nga hallkat perkatese. Vendimet per hapat e metjshem pas konstatimit te te metave pas sjelljes ne dijeni te Rektorit , diskutohen ne Senat rast pas rasti dhe ndiqet zgjidhja a permiresimi i tyre. Anetaret e grupeve vjetore te punes se NJBSC jane pedagoge te brendshem dhe perfaqesues te specialiteteve ku ofrohet studimi ne SPA. Keshtu komunikimi i ndersjellte i problematikes qe del eshte i mundur reciprokisht e po ashtu monitorimi i masave per zgjidhjen e tyre.

Institucioni Aldent krahas ketyre formave te kontrollit te cilesise i eshte nenshtruar edhe disa auditimeve dhe vleresimeve nga jashte si:

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi dhe e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin në kohë të pedagogëve, tutorëve dhe strukturave të përfshira në rrjetin formues.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni informon mbi rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet e pritshme.</p>	<p>Universiteti “Aldent” ka krijuar mekanizmat e nevojshme dhe ka përdorur instrumenta matëse për vlerësimin periodik të procesit mesimor dhe rritjen e cilësisë së përvetësimit të programeve që ofron. Specializantët 2 herë në vit kanë plotësuar pyetsore të parapërgatitura me indikatorë vlerësues të matshëm mbi metodat e mesimdhënies e nivelin e përvetësimit të dijeve nga ana e tyre, mënyrën e vlerësimit të dijeve dhe përmirësimet e mundshme në të ardhmen me qëllim rritjen e cilësisë së përgatitjes së tyre.</p> <p>Specializantëve u komunikohet dhe argumentohet rezultati i provimit a konkursit të tyre duke respektuar të drejtat e tyre mbi informimin dhe vlerësimin e dijeve dhe duke ruajtur anonimin. UAL përdor një sistem elektronik ku ruan të dhënat e vlerësimit të lendeve dhe ku çdo student ka akses përmes një fjalekalimi personal që zoteron.</p> <p>Pyetsoret që përdoren për këto qëllim ndryshohen e përmirësohen vazhdimisht. Përmes tyre specializantët arrijnë të marrin pjesë aktive dhe të japin ndihmesën e tyre në drejtim të përmirësimit të programeve të studimit në SPA.</p>
STANDARDI IX- INSTITUCIONI DISPONON NJË STRUKTURË DHE MEKANIZMAT E POSAÇME TË PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË DHE PERFORMANCËS SË SAJ	
Standardi IX. 1- Institucioni disponon një strukturë dhe mekanizmat e posaçme të përmirësimit të cilësisë dhe performancës së saj.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka dhe përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurë të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ka mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpamërisht të programeve të studimit, të cilat vlerësohen për pajtueshmërinë e programeve të reja të studimit me strategjinë e institucionit apo fakultetit, metodën e hartimit të programeve dhe zhvillimit të kompetencave të përshkruara në aktet ligjore apo standardet shtetërore të cilësisë.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhohet për zhvillimin e një kulture që njeh rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në punën e tyre.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë formale dhe në dispozicion të publikut.</p> <p>Kriteri 6 Studentët dhe aktorë të tjerë nga sektori punëdhënës janë të përfshirë në procesin dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë.</p>	<p>Universiteti “Aldent” i ka plotësuar detyrimet ligjore në lidhje me standartet institucionale që duhen për implementimin e suksesshem të specializimit afagjate në Stomatologji.</p> <p>Bazuar në Ligjin “Për Arsimin e Lartë në R.Sh” nr.9741, date 21.05.2007 Neni 52, Rregulloren e përgjithshme të Universitetit “Aldent” e Statutit të tij, neni 13, “Për organizimin e punës për kontrollin e brendshëm”, është bërë punë e programuar për të siguruar instrumentat e duhura të sigurimit të cilësisë.</p> <p>Është bërë ngritja e grupeve vjetore të punës për SBC dhe janë respektuar procedurat për sigurimin e cilësisë dhe të standardeve të programit të studimit në SPA.</p> <p>Rëndësia e implementimit të standardeve të cilësisë u spjegohet vazhdimisht specializantëve dhe synohet që ata të jenë pjesë aktive në realizimin dhe respektimin e tyre.</p> <p>Përmirësimi i cilësisë është parë jo vetëm në drejtim të procesit mesimor, por dhe të standardeve klinike e mjekësore si dhe të shërbimeve mbështetëse që</p>

shërbejnë për realizimin e këtij procesi.

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimet e bëra në Universitetin "Aldent" rezultojnë se ky institucion i përmbush në tërësi standartet e përcaktuara për Sigurimin e Cilësisë, infrastrukturën dhe mekanizmat e nevojshme për këto qëllime, ndjek në dinamikë problemin e plotësimit dhe përmirësimit të cilësisë së studimeve në SPA.

PROGRAMI I STUDIMEVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Programi i specializimit afatgjatë në Stomatologji në profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti është licensuar me VKM nr. 299, datë 22.07.2013 dhe është aktivizuar në vitin shkollor 2013-2014.

Ky program ofrohet në 3 vite akademike, është pa shkeputje nga puna dhe gjatë tij plotësohen 180 kredite. Hapja e këtij programi është bërë duke patur parasysh nevojat e mëdha që ka tregu i punës për këto specialitete dhe po ashtu dëshirën e mjekëve të rinj për të qenë specialistë në profile të tilla që kanë munguar më parë. Programi në SPA është hartuar në përputhje me strategjinë e Institucionit dhe po ashtu duke marrë parasysh dhe eksperiencën e Universiteteve përëndimore dhe është i harmonizuar me to, plotëson kërkesat e Direktives 2005/36/Ec të Këshillit dhe të Parlamentit Europian. Programet janë të harmonizuara, ka raporte të drejta midis pjesës teorike dhe asaj praktike, lendeve specifike e atyre baze e lendeve karakterizuese sipas udhëzimeve që ka dhënë MASH në kohën kur është bërë licensimi i tyre. Të dhëna mjaft të detajuara lidhur me përmbajtjen e programeve në të dy profilet sillen në pasqyrat e mëposhtme:

- a. Ky program bën pjesë në ciklin e trete të studimit.
- b. Emertimi i diplomes : Diplome Specializimi Afatgjatë në Stomatologji
Profili: - Specialist në Ortodonti , - Specialist në Kirurgji Orale
- c. Kohezgjatja e programit të studimit: 3 vite akademike – 6 semestra
- d. ECTS totale: 180 kredite ECTS
- e. Forma e studimit: Ky program studimi është me kohë të plote

NDARJA E LËNDËVË SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARISË:

SPECIALIZIM AFATGJATË NE STOMATLOGJI PROFILI: KIURGJI ORALE		kredite / ECTS	Totali
	Praktikë klinike I,II,III	30	108
	Kirurgji Dentoalveolare 1	14	
	Kirurgji Dentoalveolare 2	8	
	Kirurgji OMF	15	
	Implantologji 1	6	
	Onkologji	3	

Lëndë specifike 60 %	Paradontologji	7	
	Kirurgji e Pergjithshme	5	
	<i>Kirurgji Plastike</i>		
	Implantologji 2	4	
	ORL		
	Radiologji orale	5	
	<i>Diagnostikim imazherik dhe radioterapi</i>		
	Kirurgji Orale	6	
	Mjekësi orale	5	
	<i>Patologji odonto-stomatologjike</i>		
Lëndë bazë, ndërdisiplinore, deontologjike, etj 10%	Tezë diplome	20	26
	Mjekësi ligjore	2	
	Farmakologji	4	
Lëndë karakterizuese 30%	Anatomi Normale	3	46
	Anatomi Topografike	3	
	Anatomi Patologjike	6	
	Mikrobiologji orale	4	
	Biostatitike	2	
	Radiologji	4	
	<i>Shkenca teknike mjekësore të aplikuara</i>		
	Gjuhe Angleze Profesionale	2	
	Informatike Mjekësore	2	
	Semundje te Brendshme	6	
	Pediatri	4	
	<i>Neuro psikiatri infantile</i>		
	Anest.Reanimacion	4	
	Semundje Infektive	2	
Metoda Kerkimi / Bioetike dhe Psikologji	4		

SPECIALIZIM AFATGJATE NE STOMATOLOGJI, PROFILI : OROTODONTI		kredite / ECTS	Totali
Lëndë specifike 60 %	Praktikë klinike I,II,III	30	108
	Ortodonti Paraklinike	14	
	Ortodonti e Levizshme	10	
	Ortodonti Fikse	15	
	Implantologji 1	6	
	Paradontologji	7	
	Dentistri Pediatrike	6	
	<i>Neuro psikiatri infantile</i>		
	Implantologji 2	4	
	ORL		
	Radiologji orale	5	
	<i>Diagnostikim imazherik dhe radioterapi</i>		
	Kirurgji Orale	6	
	Mjekësi orale	5	

	<i>Patologji odonto stomatologjike</i>		
Lëndë bazë, nderdisiplinore, deontologjike, etj 10%	Tezë diplome	20	26
	Mjekësi ligjore	2	
	Farmakologji	4	
Lëndë karakterizuese 30%	Anatomi Normale	3	46
	Anatomi Topografike	3	
	Anatomi Patologjike	6	
	Mikrobiologji orale	4	
	Biostatitike	2	
	Radiologji	4	
	<i>Shkenca teknike mjekësore të aplikuara</i>		
	Gjuhe Angleze Profesionale	2	
	Informatike Mjekësore	2	
	Semundje te Brendshme	6	
	Pediatri	4	
	<i>Semundje infektive</i>		
	Histologji-embriogji	4	
	Gjenetike	2	
Metoda Kerkimi / Bioetike dhe Psikologji	4		

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 6-12 orë në auditor dhe 19-13 orë punë e pavarur
- Seminaret 6-8 orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur
- Laboraret 18-25 orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur
- Praktikat lëndore 1-2 orë në auditor 24-23 orë punë e pavarur
- Praktikën Profesionale 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur
- Provimi përfundimtar 10 orë në auditor dhe 1.5 orë punë e pavarur

Mendoj se ka nje ndertim te harmonizuar te programit te Spa Stomatologji ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti. Jane vendosur ne raport te drejte disiplinat e lendeve specifike me ato baze nderdisiplinore dhe ato karakterizuese. Po ashtu raporti i oreve ne auditor dhe seminareve me ato te praktikave klinike jane te shperndara ne menyre proporcionale dhe veprimtarive klinike u eshte dhene sasia e duhur, praktikisht 53% e gjithë oreve mesimore jane planifikuar si praktika klinike. Edhe kompozimi i orarit brenda nje dite mesimi, ka vendosur lendet teorike ne fillim dhe pastaj e gjithë pjesa tjeter shkon ne favor te diskutimit te rasteve dhe te punes se pavarur te specializanteve te mbikqyrur vazhdimisht nga pedagoget dhe tutoret e tyre.

Lidhur me shperndarjen e krediteve ne lende te ndryshme, mendoj se ka vend per te diskutuar. Ne disa lende mjeksore te formimit te pergjithshem mjeksor qe pa dyshim jane te rëndesishme , jane caktuar po aq kredite sa ne disa lende te specialitetit dhe qe jane te karakterit specifik. Psh lendet Anatomi patologjike dhe Semundje te brendeshme kane nga 6 kredite, po aq sa ka kirurgjia orale qe eshte lenda me kryesore e ketij profili (Kirurgji orale). Nga ky kendveshtrim mendoj se ka rëndesi qe shperndarja e krediteve te ripunohet e permiresohet me tej.

Plani mësimor (sipas modelit të tabelës 9)

PROFILI: KIRURGJI ORALE

			Leksione			Seminare			Laborator			Projekt			Praktike		
	<i>Semestri</i>	<i>Kred. Moduli</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Projekte Ore</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Praktike Ore</i>	<i>Punë e pavarur</i>
Anatomi Normale	1	3	1.5	15	23			0	1	20	5	0.5	1	12			0
Anatomi Topografike	1	3	1.5	15	23			0	1	20	5	0.5	1	12			0
Anatomi Patologjike	2	6	3	30.0	45	2	16.0	34	1	20.0	5			0			0
Mikrobiologji orale	2	4	2	20.0	30	1	8.0	17	1	20.0	5			0			0
Farmakologji	1	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0			0
Mjekesi Ligjore	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Biostatitike	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Radiologji																	
<i>Shkenca teknike mjekësore të aplikuara</i>	1	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0			0
Gjuhe Angleze Profesionale	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Informatike Mjekesore	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Prakt.Klinike	1,2	10			0			0			0			0	10	200.0	50
<i>Anest.Reanimacion</i>	1	4	2	20	30	1	8	17			0			0	1	20	5
<i>Kir. Dento-alveolare</i>	1,2	14	6	60	90	4	32.0	68			0			0	4	80.0	20
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60.0	26.0	260.0	390.0	12.0	96.0	204.0	6.0	120.0	30.0	1.0	2.0	23.0	15.0	300.0	75.0

PROFILI: KIRURGJI ORALE											
	<i>Semestri</i>	<i>Kred. Moduli</i>	Leksione			Seminare			Praktika		
			<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>
Semundje te Brendshme	3	6	3	30	45	2	16	34	1	20	5
Pediatri	3	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5
<i>Neuro psikiatri infantile</i>											
Mjekesi Orale	3	5	2.5	25	38	1.5	12	26	1	20	5
<i>Patologji odonto stomatologjike</i>											
Kirurgji Orale	3	6	2	20.0	30	1.5	12.0	26	2.5	50.0	13
Radiologji orale	3	5	2.5	25.0	38	1.5	12.0	26	1	20.0	5
<i>Diagnostikim imazherik dhe radioterapi</i>											
Implantologji	4	6	2	20	30	1.5	12	26	2.5	50	13
<i>ORL</i>											
Praktike Klinike	3,4	10			0			0	10	200	50
Kirurgji Dentoalveolare 2	4	8	3	30.0		2	16		3	60	
Kirurgji e Pergjithshme	4	5	3	30	45	2	16	34			
<i>Kirurgji Plastike</i>											
Onkologji	4	3	2	20.0	30	1	8	17			0
Semuindje Infektive	4	2	1.5	15.0		0.5	4				
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60	23.5	235	285	14.5	116	204	22	440	95

PROFILI: KIRURGJI ORALE														
			Leksione			Seminare			Praktika			Tezë diplome		
	Semestri	Kred. Moduli	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur
<i>Paradontologji</i>	5	7	3	30	45	2	16	34	2	40	10			0
<i>Metoda Kerkimi / Bioetike dhe Psikologji</i>	5	4	2.5	25	37.5	1.5	12	25.5			0			0
<i>Implantologji</i>	5	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0
<i>Praktike Klinike</i>	6	10			0			0	10	200	50			
<i>Kirurgji OMF</i>	5	15	3	30	45	2	16	34	10	200	50			0
<i>Teze Diplome</i>	6	20						0			0	20	40	460
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60	11	105	158	7	52	111	23	460	115	20	40	460

PROFILI: ORTODONTI

	Semestri	Kred. Moduli ortodonti	Leksione			Seminare			Laborator			Projekt			Praktike Ore		
			ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Projekte Ore	Punë e pavarur	ECTS	Praktike Ore	Punë e pavarur
Anatomi Normale	1	3	1.5	15	23			0	1	20	5	0.5	1	12			0
Anatomi Topografike	1	3	1.5	15	23			0	1	20	5	0.5	1	12			0
Anatomi Patologjike	2	6	3	30.0	45	2	16.0	34	1	20.0	5			0			0
Mikrobiologji orale	2	4	2	20.0	30	1	8.0	17	1	20.0	5			0			0
Farmakologji	1	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0			0
Mjekesi Ligjore	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Biostatitike	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Radiologji	1	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0			0
<i>Shkenca teknike mjekësore të aplikuara</i>																	
Gjuhe Angleze Profesionale	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Informatike Mjekesore	2	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0			0			0
Prakt.Klinike	1,2	10			0			0			0			0	10	200.0	50
Histologji-embrionologji	1	4	2	20	30	1	8	17			0			0	1	20	5
Ortodonti Paraklinike	1,2	14	6	60	90	4	32.0	68			0			0	4	80.0	20
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60.0	26.0	260.0	390.0	12.0	96.0	204.0	6.0	120.0	30.0	1.0	2.0	23.0	15.0	300.0	75.0

PROFILI: ORTODONTI											
	Semestri	Kred. Moduli ortodonti	Leksione			Seminare			Praktika		
			ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur	ECTS	Në auditor	Punë e pavarur
Semundje te Brendshme	3	6	3	30	45	2	16	34	1	20	5
Pediatri	3	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5
<i>Semundje infektive</i>											
Mjekesi Orale	3	5	2.5	25	38	1.5	12	26	1	20	5
<i>Patologji odonto stomatologjike</i>											
Kirurgji Orale	3	6	2	20.0	30	1.5	12.0	26	2.5	50.0	13
Radiologji orale	3	5	2.5	25.0	38	1.5	12.0	26	1	20.0	5
<i>Diagnostikim imazherik dhe radioterapi</i>											
Implantologji	4	6	2	20	30	1.5	12	26	2.5	50	13
<i>ORL</i>											
Praktike Klinike	3,4	10			0			0	10	200	50
Ortodonti e Levizshme	4	10	3	30.0	45	2	16	34	5	100	25
Dentistri Pediatrike	4	6	2	20	30	1.5	12	26	2.5	50	13
<i>Neuro psikiatri infantile</i>											
Gjenetike	4	2	1.5	15.0	23	0.5	4	9			0
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60	20.5	205.0	308	13	104	221	26.5	530.0	133

PROFILI: ORTODONTI														
	<i>Semestri</i>	<i>Kred. Moduli ortodonti</i>	Leksione			Seminare			Praktika			Tezë diplome		
			<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>	<i>ECTS</i>	<i>Në auditor</i>	<i>Punë e pavarur</i>
<i>Paradontologji</i>	5	7	3	30	45	2	16	34	2	40	10			0
<i>Metoda Kerkimi / Bioetike dhe Psikologji</i>	5	4	2.5	25	37.5	1.5	12	25.5			0			0
<i>Implantologji</i>	5	4	2	20	30	1	8	17	1	20	5			0
<i>Praktike Klinike</i>	6	10			0			0	10	200	50			0
<i>Ortodonti Fikse</i>	5	15	3	30	45	2	16	34	10	200	50			0
<i>Teze Diplome</i>	6	20						0			0	20	40	460
SHUMA VJETORE: KREDITE/ORE		60	11	105	158	7	52	111	23	460	115	20	40	460

Tabela N. 10 Pedagoge ne SPA sipas lendeve

Lënda /Moduli		Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Statusi PAE apo PAK
1	Anatomi Normale	Zana Cikuli	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
2	Anatomi Topografike	Zana Cikuli	Prof.Asc	Lab.Dentar	PAE
3	Anatomi Patologjike	Mehdi Alimehmeti	Prof.	Stomatologji	PAK
4	Mikrobiologji orale	Pranvera Cabeli	Prof.	Farmacit	PAK
5	Farmakologji	Klodiola Dharmo	Dr.Sh.	Farmacit	PAE
6	Mjekesi Ligjore	Sokrat Meksi	Prof.	Stomatologji	PAE
7	Biostatitike	Xhelil Koleci	Prof.Asc	QFT	PAE
8	Radiologji	Ermal Tako	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
10	Gjuhe Profesionale Angleze	Jorida Shahinas	Ph.D.	QFSHK	PAE
11	Informatike Mjekesore	Dafina Xhako	Dr.Sh.	QFSHK	PAE
13	Anest.Reanimacion	Arben Ndreu	Dr.Sh.	Lab.Dentar	PAE
14	Kir. Dento-alveolare	Merita Bardhoshi	Prof.Asc	Stomatologji	PAE
15	Histologji-embrionologji	Xheladin Ceka	Prof.	Stomatologji	PAE
16	Ortodonti Paraklinike	Edlira Zere	PhD	QFSHK	PAE
17	Semundje te Brendshme	Irida Pano	Dr.Sh.	Stomatologji	PAK
18	Pediatri	Nedima Ceka	Dr.Sh.	Stomatologji	PAK
19	Mjekesi Orale	Adem Alushi	Prof.	Stomatologji	PAK
20	Kirurgji Orale	Merita Bardhoshi	Prof.Asc	Stomatologji	PAE
21	Radiologji orale	Agron Meto	Prof.Asc	Stomatologji	PAE
22	Implantologji	Ramazan Isufi	Prof.	Stomatologji	PAK
23	Praktike Klinike	Merita Bardhoshi	Prof.Asc	Stomatologji	PAE
		Diego Salvi	SPA	Stomatologji	PAK
		Renzo Sorato	SPA	Stomatologji	PAK
		Olja Tanellari	SPA	Stomatologji	PAE
		Edlira Zere	PhD	QFSHK	PAE
24	Kirurgji e Pergjithshme	Albana Cela	Dr.Sh.	Stomatologji	PAE
25	Onkologji	Manjola Lushi	SPA	Stomatologji	PAE
26	Semundje Infektive	Blerta Kika	SPA	Stomatologji	PAE
27	Ortodonti e Levizshme	Olja Tanellari	SPA	Stomatologji	PAE
28	Dentistri Pediatrike	Diana Brovina	Prof	QFSHK	PAE
29	Gjenetike	Mirela Tabaku	Dr.Sh.	Stomatologji	PAK

Mendoj se syllabuset jane ndertuar drejt, permbajne njohurite qe u duhen studenteve, ndarjen ne tema teorike dhe praktike, ngarkesat ne auditor dhe jashte tij, format e mesimdhenjes, ato te kontrollit te dijeve. Gjithmone kjo eshte nje fushe e gjere qe duhet pare e permiresuar vazhdimisht.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 6- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacionet e ofruara nga institucioni mbi programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë lehtësisht të konsultueshme për studentët si në formë të shkruar dhe elektronike.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën të njohur si në formë të shkruar dhe elektronike rregulloret e ndryshme të pranimit të studentëve dhe të organizimit të programeve të studimit.</p>	<p>Informacioni i duhur lidhur me programin e studimit në SPA është i organizuar dhe jepet nga Universitetin “Aldent” në mënyrë të plotë e me mjetet e duhura. Te gjithë kandidatet që duan të regjistrohen në këtë program, por jo vetëm ata, kanë marrë informacion të hollësishëm për përmbajtjen e programit dhe modalitetet e realizimit të tij. Te gjithë ata që kanë shprehur dëshirën të regjistrohen pranë këtij universiteti apo të kenë njohuri lidhur me përmbajtjen e programit që zhvillohet, UAL iu ka derguar në postën e tyre elektronike përmbajtjen e planit dhe programit mesimor, përmbajtjen e syllabuseve si dhe të dhëna për stafin pedagogjik që jep mesim.</p> <p>Gjithashtu dhe në sekretarinë e Fakultetit mund të terhiqen në mënyrë elektronike materialet që lidhen me programet.</p> <p>Konstatohet se kandidatëve që paraqiten për tu regjistruar iu bëhet e ditur edhe rregullorja e studimeve si mënyra e kushtet e pranimit në këtë program çdo gjë që ata kanë dashur të dinë rreth tij.</p> <p>Informacioni jepet edhe në mënyrë verbale nga sekretarite, stafi mesimor e ndihmes dhe drejtuesit e menxheret e institucionit.</p>
Standardi I. 7- Përmbajtja e programeve të studimeve është e plotë dhe e qartë në përmbushje të objektivave të këtyre programeve.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të të gjitha kërkesave për përfundimin me sukses të studimeve, përfshirë këtu dhe kreditet (ECTS).</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të lëndëve të përgjithshme, lëndëve të specialitetit, përvojave klinike/praktike.</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve përmbajnë një përshkrim të pikëve dhe notës minimale për përfundimin me sukses të lëndës/kursit.</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve përfshihen në një koncept të përbashkët, në një “plan diplomimi”².</p>	<p>Programi i studimeve në SPA i ka përfshirë të gjitha kërkesat që duhen për realizimin me sukses të tij. Janë të percaktuara qartë se numri i krediteve të nevojshme në të dy programet është 180 (ECTS). Programi e ka të sqaruar se përveç krediteve të përgjithshme edhe numrin e krediteve në çdo modul dhe lende të vecante, sasia e leksioneve, seminareve, praktikave, detyrimet e paraqitjes për secilin nga modulet etj.</p> <p>Në materialet që iu janë vënë në dispozicion specializanteve ndahen sipas tipologjise përkatëse lendet dhe kjo është konform udhëzimeve të MASH për ndarjen në lende të formimit baze, lende karakterizuese të profilit, kreditet e tezës së diplomës etj.</p> <p>Në syllabuset e çdo moduli janë të percaktuara pikët që duhet të marrë një note e caktuar si dhe pikët minimale që i duhen studentit për të qenë kalues.</p> <p>Planet dhe programet e studimit në SPA e kanë të percaktuar qartë se çfarë detyrimesh ka kandidati që</p>

² “Plani i diplomimit” të studentit shpjegon kurrikulën, kurset që duhet të ndiqen për përfundimin e studimeve, mënyrën e frekuentimit të tyre në një afat të caktuar.

	deshiron te diplomohet ne nje profil te caktuar.
Standardi I. 8- Institucioni bën vlerësimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Vlerësimi i programeve të studimit bëhet duke përcaktuar pikat e forta dhe dobësitë për arritjen e objektivit, si dhe sugjerimet për përmirësim në të ardhmen.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni bën vetëvlerësimin institucional nëpërmjet instrumentave dhe metodologjive matëse dhe vlerësuese, duke përfshirë gjithë procesin në një sistem të informatizuar.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p> <p>Kriteri 4 Personeli akademik angazhohet në vlerësimin efektiv të programeve të studimit.</p>	<p>Aktivizimi i këtij programi studimi ka filluar ne vitin shkollor 2013-2014, (ne semestrin e dyte) ai eshte tani ne mes te periudhe se tij. Stafet dhe drejtuesit e programit po ndjekin me vemendje ecurine e tij, marrin mendime nga specializantet, pedagoget, mjeket qe japin mesim e personeli ndihmes lidhur me ate se cfare duhet te ndryshoje e te persoset ne te ardhmen per ta bere ate me te asimilueshem e cilesine e pergatitjes se tyre me te mire.</p> <p>Institucioni ka bere vetevleresimin e punes se tij permes NJSBC, e cila e ka realizuar ate permes pyetsoreve qe ka hartuar dhe qe specializantet kane plotesuar. Permes ketyre pyetsoreve eshte siguruar informacini i duhur dhe te dhena per drejtuesit e institucionit e stafin e tij ne drejtim te vleresimit te programit e permiresimit te tij. Edhe puna qe ka bere Grupi i Vleresimit te Brendshem dhe raporti i hartuar prej tij jane ne funksion te këtij procesi.</p> <p>Diskutimet e hollesishme qe u zhvilluan nga eksperte dhe perfaqesuesit e APAAL me specializantet i sherbyen jo vetem njohjes se gjendjes e verifikimit te te dhenave , por edhe nxjerrjes se problemeve e permiresimit te cilesise ne realizimin e programit.</p> <p>Personeli akademik qe ndjek ne vazhdimesi realizimin e këtij programi studimi ka dhene periodikisht mendimet e tij per problemet qe duhet te permiresohen ne kuader te institucionit. Per ato probleme qe kerkojne miratimin e MAS jane bere propozimet perkatese per ti kaluar neper instancat perkatese dhe te behen te vlefshme per gjenerata e tjera qe do te pergatiten sipas këtij programi studimi. Propozime me permbajtje te tille do te kete edhe nga ky raport i vleresimit te jashtem qe ne po paraqesim.</p>
Standardi I. 10- Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli bëhet në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë (RSH), me ligjin për profesionet e rregulluara në RSH si dhe me direktivat europiane mbi profesionet e rregulluara.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e programeve të studimeve specializuese afatgjata, studenti duhet të grumbullojë jo më pak se 120 kredite dhe kohëzgjatja normale e këtyre programeve të studimeve është jo më pak se 2 vite akademike, në përputhje me ligjin e profesioneve të rregulluara.</p> <p>Kriteri 2 Kohëzgjatja minimale e programeve të studimit të specializimeve afatgjata nuk është më e vogël se ajo e përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtyre standardeve.</p>	<p>Afati i zgjatjes se studimeve ne SPA dhe numri i krediteve ne kete program jane konforme kerkesave ligjore per arsimin e larte ne RSH. Ato jane hartuar ne pershtatje me bazen ligjore qe disponojme e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jane ne perputhje me Ligjin e Arsimit te Larte nr.9741, date 21.05.2007i ndryshuar i cili kerkon qe programet specializuese afatgjata te zgjasin jo me pak se 2 vjet dhe kane 120 kredite ECTS. Programi aktual i specializimit afatgjate ne Universitetin "Aldent" zgjat 3 vjet dhe dhe ka 180 kredite ECTS. - Ka disa lende karakterizuese qe kane nje numer te

	<p>konsiderueshem kreditesh dhe mendoj se duhet te rishihen duke ulur numrin e krediteve ne dobi te praktikave brenda hapesirave qe lejon ligji.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jane ne perputhje me Ligjin per Profesionet e Rregulluara. - Sipas Direktives 2005/36/EC te Keshillit dhe parlamentit European. - Jane ne pershtatje me programe te ngjashme te Universiteteve italiane, vecanerisht me ata qe UAL ka marredhenie, profesore te te cileve japin mesim ne kete program. <p>Te gjitha eksperiencat europiane qe jane shfrytezuar gjate hartimit te programit te SPA ne Universitetin "Aldent" rekomandojne qe ky program ne Kirurgji Orale te zgjase 3 vjet, ndersa kirurgjia OMF qe ka nje fushe veprimi me te gjere te jete 4 vjet sic parashikohet ne shtojcen nr1.</p>
<p>Standardi I. 11 - Hartimi dhe realizimi i programit të studimeve specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë bëhet sipas kriterëve të parashikuara.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve specializuese afatgjata përfshijnë të paktën 80% të ECTS-ve totale për aktivitete klinike profesionalizuese, sipas specializimit përkatës, dhe 20% për studime të organizuara teorike të shpërndara në vite sipas një programi të paracaktuar në fillim të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Në studimet specializuese janë parashikuar raportet e ECTS-ve për formimin e përgjithshëm dhe për atë specifik sipas skemës së mëposhtme në raport me ECTS-të totale minimale të parashikuara për programin specializues të paraqitur në shtojcën 1: 2% për lëndë të formimit bazë për specializantin, 2% për lëndë ndërdisiplinore ose integruese 1% për aktivitete të tjera (lëndë informatike, gjuhë të huaja), 5% për provimin final/temën eksperimentale të diplomës, 30% për lëndë karakterizuese të fushës ku bën pjesë programi specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje) dhe 60% për lëndë specifike të programit specializues (nga të cilat 15% e tyre duhet të jenë lëndë me zgjedhje).</p> <p>Kriteri 3 Plani i detajuar mësimor është miratuar sipas akteve ligjore/nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 4 Në përfundim të çdo viti organizohet provimi vlerësues teorik dhe praktik i cili vlerësohet me notë. Vlerësimi vjetor kryhet nga një komision i përbërë nga 5 (pesë) specialistë me përvojë të fushës përkatëse ose të përafërt me të sipas moduleve të zhvilluara. Studentët që vlerësohen negativisht 5 herë marrin një dëshmi për modulet e zhvilluara, së bashku me kreditet e grumbulluara dhe i ndërpresin studimet e specializimeve afatgjata. Studenti mund të riaplikojë për të konkuruar në një program tjetër specializues jo më shumë se 1 herë. Studentit mund t'i njihen ECTS-të e grumbulluara për studimet e organizuara teorike nga ana e Këshillit të Profesorëve nëse gjykohet se përputhen me fushën e</p>	<p>Programi i specializimit afatgjate ne Stomatologji ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti ka te realizuar nje ndarje te tille: Lende specifike 60%, lende te formimit baze , nderdisiplinor, deontologjise 10%, lende karakterizuese 30% dhe te realizuara me nenndarje thujase sic kerkohet ne standart.</p> <p>Specializanti ka dhene ne perfundim te cdo semestri dhe viti akademik provimet qe jane catur ne programin mesimor dhe eshte vleresuar me note sipas pikeve qe ka grumbulluar gjate vitit dhe atyre qe ka marre ne provimin perfundimtar. Ne fund te vitit te pare specializantet i jane nenshtruar provimit praktik kualifikues.</p> <p>Plani mesimor ka kaluar ne te gjitha procedurat e duhura ligjore para aprovimit. Plani eshte propozuar nga departamenti i Stomatologjise , eshte aprovuar nga Senati i Universitetit, eshte derguar ne MASH, keta e kane derguar dosjen ne APAAL qe ka dhene mendimin e tij dhe pas aprovimit nga ana e Keshillit te Akreditimit eshte kthyer ne MASH nga ku Ministri ka nxjerre Urdherin perkates.</p> <p>Megjithese gjenerata e pare e specializanteve eshte ne pergatitje jane te percaktuara rregullat se si do te kryhet provimi perfundimtar i specializimit. Do te jepet provim praktike me konsultime zgjidhje rastesh klinike dhe vetem pasi te jete kryer me sukses ky testim do te behet provimi me goje.Komisioni i provimit do te perbehet nga 5 anetare qe do te jene specialiste te fushes ku kryhet specializimi ose te nje fushe te afert me te.</p> <p>Provimi praktik do te konsistoje ne zgjidhje te rasteve klinike qe do te paraqese Komisioni dhe specializanti</p>

<p>programit të ri ku ai ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 5 Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar/final në përfundim të programit specializues i cili konsiston në testimin praktik dhe atë me gojë të studentit me kohëzgjatje prej të paktën 30 minutash si dhe paraqitjen e temës eksperimentale të diplomës. Për këtë ngrihet një komision i përbërë nga 5 specialistë të fushës, ose të një fushe të afërt, me eksperiencë të paktën 10 (dhjetë) vjeçare në fushën përkatëse, nga të cilët 2 të emëruar nga Ministri i Shëndetësisë, 1 nga Urdhri Profesional përkatës dhe 2 të emëruar nga fakulteti që ofron programin specializues. Kryetar i komisionit është një nga përfaqësuesit e emëruar nga Ministri i Shëndetësisë. Disa nga njohuritë bazë për të cilat aplikanti testohet në provimin përfundimtar, janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> Zhvillimi i sensit kritik lidhur me situatat e ndryshme klinike; Lidhjet mes fushave të ndryshme të mjekësisë; Aftësi të zhvilluara për zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë punës në klinikë; Kompetencë për të menaxhuar kompleksitetin e situatave klinike dhe për të dhënë zgjidhje në rastë emergjente. 	<p>duhet të jete i afte qe te percaktoje diagnozen, planin e trajtimit dhe te parashikoje rezultatet e priteshme.</p> <p>Nje kontigjent i caktuar qe ka patur rezultate te mira gjate 3 viteve te studimit do te kete mundesine te zgjedhe dhe te mbroje nje teme studimore eksperimentale ne përfundim te studimeve.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Programi i studimit ne SPA eshte i hartuar konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe eksperiencës Europiane per kete problem. Ai ka kohen e mjaftueshme, numrin e nevojshem te krediteve, moduleve dhe te lendeve qe u duhen specialisteve te kesaj fushe. Eshte i ndertuar ne menyre harmonike ku disiplinat zene vendin e tyre sipas rendesise qe kane ne kete program studimi, po ashtu eshte ndare ne menyre te drejte raporti i oreve teorike me atyre te praktikës klinike.</p> <p>Lidhur me shperndarjen e krediteve ne lende te ndryshme, mendoj se ka vend per te diskutuar. Ne disa lende mjeksore te formimit te pergjithshem mjeksor qe pa dyshim jane te rendesishme, jane caktuar po aq kredite sa ne disa lende te specialitetit dhe qe jane te karakterit specifik. Psh lendet Anatomici patologjike dhe Semundje te brendeshme kane nga 6 kredite, po aq sa ka kirurgjia orale qe eshte lenda me kryesore e ketij profili (Kirurgji orale). Nga ky kendveshtrim mendoj se ka rendesi qe shperndarja e krediteve te ripunohet e permiresohet me tej.</p> <p>Specializantet jane informuar rregullisht per permbajtjen e programit, syllabuset e lendeve, menyren e testimit dhe gjithcka lidhet me kryerjen me sukses te programit te SPA.</p>	

8. Procesi Mesimor

Per realizimin me sukses te programit te SPA, ka rendesi te vecante procesi mesimor. Ky proces zhvillohet permes leksioneve, seminareve, praktikave, laboratoreve, projekteve dhe temave studimore.

- *Leksionet:* Zhvillimi i oreve teorike eshte nje nga format me te rendesishme te përvetesimit te lendeve. Pa nje baze te shendoshe teorike nuk mund te përvetesohet mire specialiteti. Bazuar ne rregulloren e Universitetit “Aldent”, ndjekja e leksioneve nga specializantet eshte e detyruar ne masen mbi 75% te oreve te mesimit. Megjithate pedagoget ketu inkurajojne ndjekjen e leksioneve ne te gjitha oret e tyre dhe bejne perpjekje qe keto ore te jepen sa me mire, te jene ineteresante dhe sa me produktive ne drejtim te përvetesimit te lendes.

- *Seminare/Ushtrime:* Ketu insistohet qe te behet shqyrtimi i njohurive ne bashkebesedim e me pjesmarrjen aktive te studenteve. Duke e vleresuar kete forme mesimdheneje ne rregulloren e studimeve eshte percaktuar qe pjesmarrje e specializanteve ne to te jete jo me pak se 75% te oreve mesimore qe zhvillohen ne formen e seminareve.
- *Labororet:* Kryerja e tyre ze nje vend te vecante ne procesin mesimor sepse lidhet direkt me gjithformimin e specialisteve te ardhshem. Sipas kerkesave te rregullores se Fakultetit punet e laboratorit duhet te zhvillohen me seriozitet e perpikmeri, pa anashkaluar asnje seance te tille. Rezultatet qe merren nga punet laboratorike duhet te perpunohen dhe te paraqiten ne formen e nje raporti e te mbrohen nga ana e specializantit. Pa realizuar e mbrojtur punet e laboratorit rregullorja e ndalon specializantin qe te hyje ne provim. Ngarkesa e laboreve eshte e detyrueshme qe te shlyhet ne masen 100%.
- *Zhvillimi i praktikës dhe metodat e zhvillimit:* Ne kete specializim afatgjate nje vend shume te vecante zene praktikat klinike, te cilat zhvillohen ne te 3 vitet akademike dhe kane nje perqindje te konsiderueshme te programit te specializimit. Ketu praktikat mund te zhvillohen ne labororet ose klinikat e Fakultetit, por dhe ne institucione te ndryshme shteterore ose private me te cilat Universiteti "Aldent" ka kontrata te rregullta.
- *Detyra/Projekte Kursi:* Jane projektuar te kete detyra kursi per ti lene hapsire edhe punes individuale te specializanteve. Kandidatet marrin temen e detyres se kursit, kryejne kerkimet rreth saj dhe me pas perpilojne detyren sipas nje strukture te konsultuar me pare me pedagogun. Detyrat e kursit paraqiten dhe mbrohen nga specializanti, ai nuk lejohet te futet ne provim pa bere me pare paraqitjen dhe mbrojtjen e tyre.
- *Literatura:* Ne te gjitha programet qe ofron Universiteti "Aldent", procesi mesimor bazohet ne literature shkencore bashkekohore, te asaj qe perdoret ne fakultetet e tjera shteterore apo private, ne vendin tone apo ne universitetet e huaja. Literatura zgjidhet me kujdes dhe miratohet ne Departamentin perkates dhe ne Dekanat duke u bazuar ne programin qe eshte ofruar.

Jane perdorur si literature baze :

- Tekste te shkruara nga pedagogu apo grupe autoresh ne gjuhen shqipe.
- Tekste ne gjuhe te huaj
- Leksione te pergatitura nga pedagogu i lendes.
- Materiale te pergatitura ne funksion te tematikes nga ana e lektorit.
- Artikuj shkencore te botuar rreth temes qe trajtohet.

Libraria virtuale ne te cilen studentet kane akses dhe mund ta perdorin sipas deshires. Theksoj se Universiteti "Aldent" u ka siguruar specializanteve dhe studenteve internet pa pagesese. Libraria virtuale shfrytezohet lehtesisht e pa pagese pasi ky institucion eshte i abonuar ne Biblioteken e OBSH me libra mjekesore dhe po ashtu materialet ne leter dhe shtypshkrimet ofrohen per to pa pagese.

Planet mesimore te programeve te ketij specializimi afatgjate perfshijne edhe forma te tjera studimi per specializantet si: leksione interaktive, leksione te hapura, zhvillimin e konsultimeve ne auditor .

Dekanati ka ngritur dhe struktura perkatese te stafit pedagogjik qe ndjek nga afer

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit për lëndët vjetore që janë teorike dhe praktike	Pjesa (në %) ndaj totalit për lëndët që zhvillohen dhe vlerësohen me praktika
---	---	---

ecurine e specializanteve - Tutoratin. Ky monitoron dhe perkujdeset per gjithë mbarvajtjen e procesit mesimor si ne auditor ashtu edhe ne institucionet shendetesore ku kryhen praktikat e specializanteve.

Perditesimi dhe permiresimi i programit te studimit, planet dhe syllabuset e lendeve ne SPA, kane qene nje proces dinamik dhe i vazhdueshem qe eshte kryer ne Universitetin "Aldent". Jane ndjekur me perparesi udhezimet e MASH (si Udhezimi 15-te i MASH) si dhe kerkesat dhe standartet e kriteret qe po kerkohen aktualisht ne pocesin e ketij akreditimi.

Ngarkesa e punes se specializantit per 1ECTS njesohet me 25 ore mesimi, e ndare ne ore mesimi ne auditor, dhe ore pune te pavarur. Vleresimi eshte bere ne vazhdimesi dhe konkretizohet me rezultate semestrale e vjetore.

Nota perfundimtare qe vlereson specializantin eshte kerkuar te bazohet ne ecurine vjetore te studentit ne cdo komponent te procesit mesimor ; leksione, seminare, praktika dhe bashkebisedimin perfundimtar etj.

Deaprtamenti ne fund te vitit akademik ka hartuar raportin per realizimin e planit i cili i eshte derguar Deaknatit se bashku me propozimet perkatese.

Programi ka parashikuar qe te realizohen ne total 1926 (?) ore ne auditor dhe nga keto 1020 (?) orë ose 53% e kohes totale eshte planifikuar per punë praktike te specializantit ne klinike. (shih tabelen me poshte - duhet saktësuar.)

Tabela N.11 Programi i Studimit ne SPA

Programi i Studimit			Sipas llogarive nga plani
Specializim Afatgjate ne Stomatologji			
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor	
a.	Leksione	600	570
b.	Seminare	264	252
	Laboratore		120
c.	Kërkimi shkencor	40	
d.	Projekte	2	2
e.	Praktika	1020	1290
f.	Teze diplome		40
	Në total	1926	2272

Tabela N. 12

Aktiviteti shkencor i UAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	10
Për projekte shkencore në rang Fakulteti/ Departamenti/ programi SPA	20
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	6

Tabela N. 13

Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%	20%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%	-
Testimet gjatë vitit	20%	
Provimi përfundimtar	60%	80%
	100 %	100 %

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 9- Institucioni përdor instrumente matës, vlerësues, metodologji vlerësimi.	
<p>Kriteri 5 Institucioni për kryerjen e vlerësimit përdor instrumente/metoda vlerësimi të drejtpërdrejta ose të tërthorta.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Ndjekje të studentëve gjatë zhvillimit të praktikave dhe angazhimi i tyre në ndjekjen e rasteve klinike konkrete; Vlerësimi me nota/pikë në fund të çdo viti; Testime paraprake dhe dytësore: provime për module, praktikë; Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës; Vlerësimi përfundimtar. <p><u>Të tërthorta</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhet: të studentëve të rinj/të vjetër, të të diplomuarve; Sondazhe të vlerësimit të kurrikulës (pjesës teorike dhe asaj praktike, kapaciteteve logjistike infrastrukturore dhe të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, etj.); Intervista. <p>Kriteri 6 Institucioni disponon një sistem të kodifikuar për klasifikimin dhe arkivimin (baza të dhënash në format elektronik, arkivim i dokumentacionit) e të dhënave të të gjitha aktiviteteve të zhvilluara dhe të rezultateve të arritura.</p>	<p>Institucioni Aldent ka krijuar mekanizmat e nevojshëm matës e vlerësues për realizimin dhe përvetësimin e programit të SPA. Ai ka krijuar instrumenta matës dhe vlerësues për ecurinë periodike të këtij programi studimi. Keto informacione janë përfshirë në të gjitha vlerësimet e brendshme të cilesisë.</p> <p>Jane bërë gjithnjë transparente vlerësimet që janë kryer dhe rezultatet e tyre. Metodatat e vlerësimit kanë qenë të tërthorta dhe të drejtpërdrejta.</p> <p>Metoda të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe nepermjet pyetjeve që u janë paraqitur specializantëve dhe që janë plotësuar prej tyre. Këtu ata kanë patur mundësi që të shprehën për gjithë ecurinë e procesit mesimor në kushte anonimati. Sistemi i Tutoreve/ kujdestareve të grupeve që u ka krijuar atyre mundësi që të shprehën në vazhdimësi rreth problemeve që kanë patur dhe si e mendojnë ata mundësi të përmirësimit të tyre. Informacione janë marrë edhe nga institucionet relevante. Stafi akademik dhe ai administrativ të UAL ka organizuar shpesh edhe diskutime të hapura me specializantët dhe ju ka krijuar atyre mundësi që të marrin pjesë aktive në procesin e përmirësimit të procesit mesimor dhe arritjes së rezultateve sa më të mira. Kontrolli dhe vlerësimi i dijeve të specializantëve është bërë sipas formave të përcaktuara ligjore të cilat janë të fiksuara edhe në Statutin e Universitetit të Rrregullorin e Specializimit. <p>Metoda të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> Specializantët janë ndjekur në mënyrë të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme nga pedagogët dhe tutorët e tyre gjatë gjithë procesit të mesimit, zhvillimit të praktikave dhe zgjidhjes së rasteve klinike dhe janë vlerësuar për cilësinë e kryerjes së tyre.

	<p>b. Vleresime jane bere edhe ne fund te kapitullit apo te modulit perkates dhe jane mbajtur shenimet perkatese. Keto testimet paraprake kane sherbyer edhe gjate vleresimit perfundimtar te lendes.</p> <p>c. Testimet, seminaret, detyrat e kursit, projektet, prezantimet ne power-point etj. kane qene pjese e vleresimit te vazhdueshem te specializanteve.</p> <p>d. Vleresimi perfundimtar eshte bere ne fund te semestrit apo te vitit, kur lenda perkatese ka perfunduar. Keto vleresime kane qene te paraprire nga gjithë puna vjetore e kontrollit te ushtruar ne cdo teme e ore mesimi. Kontrolli perfundimtar ka qene nje proces, eshte zhvilluar me raste praktike e kontroll teorik, me goje ose me shkrim, ose me menytrat qe njeh ligji per kete problem.</p> <p>I gjithë dokumentacioni perkates ruhet ne Sekretarine e Fakultetit.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

Ne Universiteti “Aldent” jane perdorur metoda bashkekohore te mesimdhenjes si: leksione, seminare, laboratore, praktika ne fantoma, praktika klinike me paciente reale dhe jane zgjidhur situata reale klinike.

Rendesi i kushtohet nderthurjes se metodave te mesimdhenjes gjate seancave praktike te mesimit, ku nje kohe te konsiderueshme merr diskutimi i rasteve, mendimi i specializanteve te tjere, analiza e dokumentacionit klinik e radiologjik, konkluzioni i sakte dhe perfundimi llogjik e venje e diagnozes qe arrihet me pjesmarrjen e te gjithë grupit te specializanteve, me pjesmarrjen dhe ndihmen e pedagogut perkates. Pas kesaj behet percaktimi i metodes se mjekimit. Te gjithë kane mundesine te marin pjese e diskutojne per rastet e kolegeve dhe kjo i afteson te gjithë ata. Rezultatet e mjekimit ndiqen e shqyrtohen jo vetem nga ai qe ka bere mjekimin , por nga te gjithë te tjeret. Kjo eshte e rendesishme pasi nje rast i mjekuar i sherben te gjithë grupit.

Rastet me tipike pershkruhen e ruhen per tu publikuar apo referuar ne aktivitet te ndryshme, apo ne temen e diplomes qe do te paraqitet ne fund te studimeve.

Prania e shume laboratoreve ne dispozicion te specializanteve si dhe e disa klinikave qe funksionojne ketu, po ashtu politika ekonomike fleksibel qe ka ndjekur stafi dhe drejtuesit e Universitetit, ku pacientet paguajne fare pak ose aspak per mjekimin e tyre, ka krijuar klimen e pershtateshme dhe sasine e duhur te pacienteve per ushtrimin me sukses te specializanteve.

Universiteti “Aldent” organizon nje proces mesimor te monitoruar mire, nje kontroll sistematik, transparent e ligjor te dijeve te specializanteve dhe ka te ruajtur dokumentacionin e duhur lidhur me te.

9. Studentët e SPA

Aktualisht ne programin SPA prane Universitetit “Aldent” frekuentojne 48 specializante ne profilet Kirurgji Orale dhe Ortodonti, ndersa ne fillim te ciklit te studimeve ne vitin akademik 2013-2014 kane qene regjistruar 58 kandidatë.

Kandidatet jane perzgjedhur sipas nje sistemi pikezimi me 150 ne total dhe ku perfshihen: Nota mesatare e studimeve universitare ka 100 pike, trajnime, referime,

prezantime vleresohen deri ne 20 pike, eksperiencia profesionale deri 10 pike, dhe intervista 20 pike.

Intervista eshte kryer me goje dhe eshte vleresuar nga nje komision i Fakultetit te Shkencave Dentare i ngitur per kete qellim. Eshte konsideruar fitues per ne specializim kandidati qe ka plotesuar kriteret e pranimit duke grumbulluar mbi 95 pike. Keta jane regjistruar dhe vazhdojne specializimin.

Universiteti "Aldent" eshte perpjekur te beje nje politike perzgjedhjeje rigoroze dhe ka arritur te rekrutoje kontigjente cilesore ne kete program te SPA. Eshte synuar ne regjistrimin e kandidateve me note mesatare sa me te larte, nota mesatare e atyre qe vijojne aktualisht eshte mbi 8.

Duke qene se ky program studimi eshte ne proces, akoma nuk ka te diplomuar dhe as te dhena per punesimin e tyre.

Nuk ka patur largime te specializanteve nga programi i specializimit ne drejtim te institucioneve te tjera, apo ardhje te specializanteve nga institucione homologe apo nga jashte. Largimi i 10 kandidateve nga specializimi eshte bere pasi ata kane nderprere studimet meqe nuk kane qene te gatshem te frekuentonin rregullisht kete program dhe te respektonin rregulloren e institucionit.

Kohezgjatja e programit te studimit per specializim afatgjate ne Stomatologji eshte konform kerkesave te ligjit "Per Arsimin e Larte ne RSH" nr.9741, date 21.05.2007 i ndryshuar , konform edhe me direktiven Europiane per profesionet e rregulluara si dhe me programe te ngjashme me ato te universiteteve perendimore sidomos me ato italiane, pasi dhe bashkepunimi dhe asistenca teknike eshte me keto universitete prej nga vijne dhe profesoret e huaj te cilet japni mesim dhe kontribuojne ne realizimin e ketij programi.

Programet e SPA ne Universitetin "Aldent" zgjasin 3 vite, cka eshte nje kohe e mjaftueshme per pervesimin e programit dhe aftesimin praktik te specialisteve dhe ushtrimin e pavarur te profesionit qe ata fitojne ketu.

Gjate verifikimit ne Universitetin "Aldent" u konstatua se vazhdojne studimet ne kete program specializimi 27 ne profilin e Kirurgjiise Orale dhe 21 ne ate te Ortodontise, gjithesej 48 spercializante. Nga keta 15 kandidate jane nga trojet , si Kosove, Maqedoni etj.

Ky institucion ka bere nje pune sistematike per informimin e specializanteve si ne menyre direkte , asht edhe me te dhenat qe hidhen periodikisht ne faqen e Web-it lidhur me institucionin dhe programet e studimit.

Jane shfrytezuar edhe shume menyra te tjera informimi te tilla si:

- Shperndarja e flete palosjeve ne kongrese, konferenca, workshope te organizuara brenda apo jashte vendit.
- Reklama qe jepen periodikisht ne televizione me nje permbajtje teresisht informuese.
- Dergimin e emaileve imformuese qe kryhen me ndihmen e Shoqates Dentare te Stomatologeve.
- Po ashtu informacion jepet ne menyre te panderprere edhe permes faqes zyrtare te Universitetit, facebook-ut etj.

- Edhe gjate kontakteve direkte me te interesuarit jepet informacion i detajuar nga i gjithë stafi i Universitetit.
- Te gjithë personave te interesuar , pas vizites ne institucion dhe sqarimeve qe iu jepen per cdo gje qe ata kane interes, iu jepet edhe nje CD bashkeshoqeruese qe permban te gjithë informacionin e detajuar per te cilin ata kane nevojë dhe ku ndodhen edhe permbajtja e gjithë planit dhe programit mesimor, syllabuset , rregullorja e institucionit etj.
- Universiteti “Aldent” ka botuar nje katalog cilesor dhe me informacionin e nevojshem te cilin mund ta terheqe falas cdo kush qe ka nevojë te informohet per kete institucion.

Te dhena per studentet specializante qe ndjekin programin e studimeve ne SPA jepen me poshte:

Tabela N.13

Të dhena për studentët	Nr.	Përqindje (%)
Numri total i studentëve specializantë të regjistruar dhe numri tyre për çdo vit;	58	Vetëm një vit ka pasur të regjistruar
Numri i specializantëve të regjistruar që vijnë nga jashtë njësisë që ka hapur programin e studimeve të SPA;	-	
Numri i diplomave të lëshuara për marrjen e diplomës së specializimit për çdo vit;	-	
Kohëzgjatja mesatare e studimeve të SPA dhe cila ka qenë tendenca e këtij treguesi;	3	
Numri dhe përqindja që zë, në nivel programi studimesh, i atyre që kanë ndërprerë studimet e SPA.	10	17.2%
Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar, që vijnë nga Kosova dhe trojet shqiptare, si edhe nga diaspora shqiptare;	15	25.8%
Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga rajoni i Ballkanit;	-	
Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vendet e BE-së;	-	
Numri, i shprehur në përqindje, i specializantëve të regjistruar që vijnë nga vende të tjera të botës;	-	

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I. 13- Pranimi i studentëve në një program studimi specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë	
Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimit specializues afatgjatë në fushën e mjekësisë ka përfunduar programin e integruar të studimeve universitare të integruara të ciklit të dytë me kohëzgjatje 5 vjeçare (300 ECTS) për degët Farmaci dhe Stomatologji dhe 6 vjeçare (360 ECTS) për degën Mjekësi e përgjithshme, pranë një universiteti të akredituar për programin në fjalë dhe ka fituar diplomën universitare “Master i Shkencave”. Për studentët e diplomuar në të njëjtat degë jashtë shtetit të cilëve u njihet diploma për	Specializantet qe jane regjistruar per te vazhduar programin e SPA ne Universitetin “Aldent” kane përfunduar me pare studimet e larta ne stomatologji, me kohe te plote e kohe zgjatje mbi 5vjete (jo me pak se 30 kredite ECTS). Specializantet jane perzgjedhur per te plotesuar disa kriteret qe jane te percaktuara ne rregulloren e specializimit, ku me i rendesishmi eshte nota mesatare e studimeve te larta e cila ne kete kontigjent eshte mbi

<p>ushtrimin e profesionit përkatës në këto vende, nuk ka kriter për notën mesatare për t'u pranuar në programet e specializimeve afatgjata në mjekësi. Lista e vendeve më sipër përcaktohet me udhëzim të përbashkët të MASH dhe MSH.</p> <p>Kriteri 2 Kandidati që aplikon për të vazhduar programin e studimeve të ciklit të tretë, për specializim afatgjatë në fushën e mjekësisë, i nënshtrohet një konkursi pranimit për të testuar njohuritë në fushën përkatëse të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Vlerësimi i studentit për pranimin në një program studimi bëhet me pikë duke vlerësuar notën mesatare (notën përfundimtare sipas tipologjisë së diplomës që ai disponon) për jo më shumë se 20% të pikëve totale, testimin e përgjithshëm me shkrim për 30-40% të pikëve totale, testimin me shkrim specifik sipas programit të specializimit për të cilin konkuron për 40-50% të pikëve totale, intervistën me gojë për jo më shumë se 10-20% të pikëve totale duke përfshirë këtu, eventualisht, dhe letrat e rekomandimit nga profesorë të fushës të cilët deklarojnë se kanë patur bashkëpunim shkencor me kandidatin. Kohëzgjatja e provimit me gojë nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 minuta.</p> <p>Kriteri 4 Studenti duhet të ketë përfunduar me sukses provimin e shtetit në profesionin përkatës ose të ketë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në RSH ose jashtë saj (e njohur në RSH). Në rastet kur nuk e ka përfunduar ende provimin e shtetit pranohet me kusht që ta përfundojë atë me sukses brenda vitit të parë të specializimit, në të kundërt përjashtohet nga specializimi dhe shlyen financiarisht pagesat eventuale që ka përfituar gjatë specializimit.</p> <p>Kriteri 5 Këshilli i Profesorëve përcakton kriteret për t'u pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata të pasqyruara në rregulloren e programit të studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë dhe të aprovuara nga Senati Akademik. Rregullorja e specializimit duhet të ketë marrë pëlqimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Kriteri 6 Aplikanti merr paraprakisht informacion të detajuar për programin e studimit specializues, para se të pranohet në të.</p>	<p>8. Plotësimi i ketyre kriterëve është verifikuar përmes konkurimit me dosje dhe intervistës së bërë me gojë. Dosja e konkurentit përmban dokumentacion lidhur me arsimin që kandidati ka kryer, licensimin profesional, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore si në kongrese a konferenca të specialitetit, workshope, mundësia e kualifikimeve të mëparshme etj. Në intervistën me gojë është folur për eksperiencën klinike që ata kanë, lidhjen e saj me fushën e specializimit që kërkojnë, arsyen dhe motivimin për profilin e zgjedhur etj.</p> <p>Në fund është hartuar një tabelë ku të gjitha të dhënat janë hedhur aty sipas një sistemi të mëparshëm vlerësimi dhe prej aty është nxjerrë rezultati për çdo kandidat që ka shprehur dëshirë për të studjuar në SPA.</p> <p>Të gjithë kandidatet e regjistruar në SPA kanë dhënë provimet e shtetit dhe kanë qene diplomuar me pare. Gjithashtu ata janë të pajisur me licence profesionale dhe të regjistruar të Urdheri Mjekut(tani Urdheri i Stomatologut).</p> <p>Kushtet e regjistrimit në SPA janë teresisht të njohura nga kandidatet, ato janë të percaktuara qarte në rregulloren e specializimit, të cilën e ka hartuar Departamenti i Stomatologjisë dhe ka marrë miratimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Dentare dhe me pas është aprovuar edhe nga Senati i Universitetit, pasi e tillë ka qene procedura e miratimit të rregullores në periudhën kur ajo është hartuar para datës 28.02.2013. Rregjistrimi kontigjentit të parë të kandidateve që vijnë programin në SPA në Universitetin “Aldent” është bërë në vitin akademik 2013-2014 dhe pas kësaj nuk janë bërë me regjistrime të reja dhe as ndryshime në rregulloren e specializimeve.</p> <p>Aplikantët që priten të regjistrohen në fund të përfundimit të kontigjentit të parë të specializanteve, do të informohen me menyrat e përshkruara më sipër për gjithçka që lidhet me përmbajtjen e programit, syllabuset, pedagoget, menyrën e regjistrimit dhe të gjithë udhëzimet e reja që dalin nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe kerkimin shkencor të vitit 2015 dhe aktet nenligjore që do të dalin në zbatim të tij.</p>
STANDARDI V - STUDENTËT	
<p>Standardi V. 1- Studenti që ka përfunduar një program të integruar të studimeve në fushat e mjekësisë, farmacisë, stomatologjisë, plotëson standardet akademike të kriterëve të pranimit të institucionit respektiv dhe gëzon të drejtën për t'u regjistruar në programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë.</p>	

<p>Kriteri 1 Aplikanti që kërkon të pranohet në programin e studimeve specializues ka parashtruar kërkesën për një fushë të veçantë specializimi dhe i nënshtrohet provimit të pranimit në programin e studimit specializues për të cilin ka aplikuar.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një model teorik të informatizuar për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme (operativ, konjitiv e relacionues).</p> <p>Kriteri 3 Institucioni shpall paraprakisht programin e parashtruar për provimin e pranimit dhe instrumentat që përdor për përcaktimin e njohurive, kapacitetit, aftësive të aplikantëve në këndvështrime të ndryshme.</p> <p>Kriteri 4 Institucioni vlerëson në mënyrë të vazhdueshme politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Aplikantet që kanë patur dëshirë të regjistrohen për të vazhduar programin e SPA në Universitetin “Aldent”, kanë plotësuar me pare një formular aplikimi i detyrueshem për të gjithë. Ata gjithashtu kanë paraqitur pranë sekretarise së Fakultetit dosjen me dokumentacionin e kerkuar e cila përmban diplomën e studimeve universitare, listen e notave të shkolles së larte, fotokopjen e licences profesionale, trajnimet e meparshme , certifikata e aktiviteteve që ka ndjekur, listen e referimeve, botimeve etj.</p> <p>Specializantët e pranuar e regjistruar në vitin akademik 2013-2014 janë pranuar duke respektuar të gjitha kriteret që përmbante rregullorja e aprovuar në kohën e licensimit të programit. Në vitet e mëvonshme akademike janë aplikuar standarte të reja që rrisin cilësinë në Universitetin “Aldent”, por ndërkohe nuk janë bërë pranimet të reja në SPA.</p> <p>E gjithë vëmendja e stafit dhe drejtuesve të UAL është e përqendruar aktualisht në realizimin me sukses të programit të SPA në kontigjentin e pare që po vijon studimet këtu.</p> <p>Pas daljes së akteve nenligjore në zbatim të ligjit të ri për arsimin e lartë, pritet që rregullorja e specializimit afatgjatë t’i nënshtrohet rregullimeve e përmirësimeve konform kërkesave të ligjit që duhet të zbatohen në vitet e mëvonshme akademike.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin dhe të dhënat e studentëve që ndjekin programet e studimit specializuese afatgjata.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një pasqyrë të përvitshme për numrin e të diplomuarve, në programet specializuese afatgjata, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni zotëron të dhëna individuale për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi (notat e mëparshme p.sh. vlerësimin e studentëve në programin e mëparshëm të studimit, etj.).</p>	<p>Universiteti “Aldent” disponon statistika të plota lidhur me numrin dhe kriteret e specializantëve që vazhdojnë studimet në SPA.</p> <p>Një tabelë lidhur me të dhënat që lidhen me kandidatët që vazhdojnë studimet është paraqitur më lart.</p> <p>Të dhëna disponohen edhe për ata që kanë ndërprerë studimet dhe që nga verifikimi del se ka ndodhur për arsye të tyre private dhe për faktin se nuk kanë mundur të respektojnë rregulloren e studimeve në SPA.</p> <p>Drejtuesit e universitetit dhe të këtij programi studimi e konsiderojnë të motivuar largimin e tyre dhe insistojnë në respektimin e saj dhe sigurimin e cilësisë së studimeve në një program të tillë serioz.</p> <p>Universiteti “Aldent” disponon të dhëna lidhur me ecurinë e mëparshme të specializantëve në sistemin e mëparshëm të studimeve si diploma, lista e notave e fakultetit ku kanë studjuar më parë etj.</p> <p>Ky institucion disponon të dhëna të plota të kandidatëve gjatë specializimit, si rezultate në çdo provim të dhënë, numrin e krediteve të plotësuar, detyrimet që ata kanë pa shlyer në procesin mesimor</p>

	etj.
Standardi V. 3- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studenti informohet në mënyrë të detajuar për programin e studimit, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti informohet për rezultatet e vlerësimit. Ato publikohen në ambientet e fakultetit.</p>	<p>Specializantet ne Universitetin “Aldent” jane informuar ne menyre te detajuar per permbajtjen e programit te studimit, per lendet dhe modulet qe kane per te zhvilluar, oret totale te mesimit dhe ato ne auditor dhe ato ne praktiket klinike , strukturen e oreve mesimore, detyrimet praktike te detyrueshme etj.</p> <p>Kandidatet jane informuar edhe per radhen e zhvillimit te lendeve, vitin a semestrin perkates, detyrimet qe kane per pjesmarrje, piket qe duhet te realizoje per te qene kalues, literaturen kryesore dhe ndihmese dhe menyren e sigurimit te saj.</p> <p>Specializantet jane te informuar per pedagogun qe do te zhvilloje lenden, eksperiencen e tij shkencore e klinike, titullin dhe graden shkencore qe ai ka .</p> <p>Specializantet jane te informuar edhe per rezultatet gjate studimeve dhe vleresimin qe kane marre. Ato paraqiten edhe online dhe cdo kandidat mund ti shohe ne cdo kohe pasi te futet ne faqen e tij te personalizuar te web-it te Universitetit “Aldent”.</p>
Standardi V. 5 - Studenti ka të gjitha kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit.	
<p>Kriteri 1 Studenti i pranuar në programin e studimeve specializuese afatgjata ka kushtet e nevojshme për të realizuar programin e studimit me karakter akademik e klinik.</p> <p>Kriteri 2 Programi i studimeve specializuese afatgjata siguron harmonizim të synimeve të studentit në fushën klinike dhe kërkimore-shkencore dhe, në përfundim të tij, edhe të mundësisë për karrierë profesionale ose punësim.</p> <p>Kriteri 3 Studenti që ndjek programet specializuese afatgjata të studimit ka në dispozicion një bibliotekë shkencore të pasur me botime në letër dhe në formë elektronike si dhe infrastrukturë të plotë të IT-së.</p> <p>Kriteri 4 Studenti ka mbështetje teknike të mjaftueshme për zhvillimin e aktivitetit klinik dhe kërkimor të lidhur me të.</p> <p>Kriteri 5 Hulumtimet që kanë të përfshira kërkime laboratorike mbështeten me bazë laboratorike të mjaftueshme.</p>	<p>Specializantet qe vijojne studimet ne programin e SPA te Universitetit “Aldent” kane ne dispozicion nje infrastrukture te nivelit bashkekohor e te mjaftueshme per te realizuar programin e studimit si nga ana akademike ashtu dhe ne aspektin klinik e mjekesor te tij.</p> <p>Ne dispozicion te kandidateve per specialiste jane 6 klinika me 28 unite dentare moderne, disa laboratore te specializuar si ai i protetikes fikse, ortodontise, protezave te levizeshme, te anatomise , informatikes etj.</p> <p>Te gjitha klinikat kane aparate grafie dixhitale, aparaturat per paketim e sterilizim bashkekohor te instrumentave dhe paisjeve qe perdorin specializantet.</p> <p>Programi i studimit eshte hartuar sipas kerkesave didaktike, ne fillim jepen leksionet dhe me pas kalohet gradualisht ne procedurat praktike te specialitetit.</p> <p>Aftesimi i kandidateve ka filluar ne menyre graduale dhe eshte realizuar fillimisht ne fantoma, ne modele gipsi etj. Edhe ketu eshte filluar ne fillim me raste te thjeshta dhe vijuar me ato me te veshtira.</p> <p>Specializantet jane ingranuar tanime ne punen e tyre,</p>

<p>Kriteri 6 Studenti është i siguruar gjatë gjithë periudhës së specializimit dhe për të gjitha aktivitetet e parashikuara në programin specializues. Për këtë disponohet dokumentacion i mjaftueshëm nga institucioni. Një kopje e policës së sigurimit i dorëzohet studentit në momentin e lidhjes së saj.</p>	<p>bejne diagnozen dhe percaktojne planin e mjekimit dhe kryejne manipulime direkt ne gojen e pacientit sigurisht te monitoruar vazhdimisht nga pedagogu i lendes dhe ai tutor.</p> <p>Ne dispozicion te specializanteve eshte nje biblioteke me libra te shkruar , me botime te viteve te fundit (2010-2015), kryesisht ne gjuhet angleze dhe italiane si me te perdorshme nga kontigjentet qe jane ne specializim.</p> <p>Ne biblioteke gjenden edhe te gjitha botimet ne gjuhen shqipe qe lidhen me specialitete Kirurgji Orale dhe Ortodonti, por jo vetem ata. Literatura jone mjekesore ndodhet e pasqyruar gjeresisht ne kete biblioteke.</p> <p>Specializanteve dhe studenteve ketu iu eshte ofruar nje mundesi e madhe studimi te literatures bashkekohore, pasi universiteti eshte i abonuar ne biblioteken online Hinari qe eshte biblioteka e OBSH dhe disponon te gjithë librat mjekesore te viteve te fundit.</p> <p>Specializantet ne Universitetin “Aldent” kane mbeshtetjen e mjaftueshme teknike me pajisje e aparate , materiale e pedagoge te kualifikuar dhe laborante eksperte te praktikës.</p> <p>Universiteti “Aldent” disponon aparatura moderne dentare si ne Kirurgji Orale dhe ne Ortodonti dhe punon me materiale cilesore. Kjo ka bere qe numri i pacienteve te rritet ne te dy specialitetet, sidomos ne Ortodonti.</p> <p>Numrin e pacienteve e ka stimuluar edhe politika ekonomike qe ndjek institucioni, ku pacientet ose mjekohen falas ose paguajne vetem lenden e pare dhe puna si nga ana klinkike dhe laboratorike kryhet nga specializantet e studentet dhe ofrohet falas.</p> <p>Ne ato zera pune per te cilat ka kerkesa nga pacientet, specializantet kane kryer nje volum punimesh me te madh se jane kerkesat e programit, keshtu psh aparate ortodontike fikse, vendosje implantesh etj.</p> <p>Duhet theksuar se edhe interesi i atyre qe specializohen eshte mjaft i madh dhe pergjegjesia per specialitetin qe do te kryejne gjithashtu e plote.</p> <p>Ka edhe procese pune qe jane me te rralla e specializantet nuk mund te bejne nje numer te konsiderushem rastesh edhe pse kushtet jane teresisht te plotesuara. Kjo vjen nga qe disa patologji hasen rralle ne nje popullsi te vogel sic eshte ajo e jona dhe vendosja e disa shifrave te orientuara nga programe te vendeve te tjera nuk eshte e drejte perkushtet e vendit tone. Ato duhen shqyrtuar e aktualizuar per kushtet tona per breza te ardhshem qe do te merren me implementimin e programeve ne SPA. Sidoqofte pedagoget dhe stafi akademik kane treguar kujdes per</p>
--	--

	<p>te gjetur e demonstruar raste te rralla e te veshtira e sidomos per ti trajtuar ata me protokolle te sakta cka ju sherben shume specializanteve, por dhe pacienteve.</p> <p>Disa studente kane kryer edhe punime shkencore, i kane referuar ato ne kongrese a koferenca shkencore dhe kane bere botime edhe ne revista brenda e jashte vendit. Ketu studjon nje specializante qe ka fituar cmim nderkombetar per studimin qe ka kryer ne Universitetin "Aldent".</p> <p>Ne kete institucion specializantet kane kushtet e nevojshme per studim, por dhe per pune studimore shkencore, kane laborete e baze materiale dhe asistohen nga pedagogje specialiste ne profesion, por edhe ne punen kerkimore.</p>
<p>Standardi V. 6- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e studentëve që kanë përfunduar programet e studimit specializuese afatgjata.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar dhe vendet e punësimit.</p>	<p>Programi i specializimit afatgjate ne Universitetin "Aldent" eshte aplikuar per here te pare, eshte ne proces dhe institucioni nuk ka te dhena lidhur me punesimin e specializanteve. Keto te dhena mendohet te sigurohen e te ruhen pas perfundimit te gjenerates se pare te specialisteve e punesimit te tyre. Kontigjenti i pare i ketyre specialisteve do te jete ne dispozicion te sherbimit tone shendetesor ne mesin e vitit 2017.</p>
<p>Standardi V. 7- Institucioni ndjek procedura të qarta për vlerësimin e njohurive të studentëve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura të qarta dhe transparente për vlerësimin në vazhdimësi të dijeve të studentit, të përcaktuara dhe të bëra të ditura që në fillim të programit të studimeve në rregulloren e specializimit.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin e njohurive të marra nga studentët gjatë programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3 Konkluzionet e vlerësimit në vazhdimësi, janë të qarta dhe transparente, përfshirë pezullimin, zgjatjen ose përjashtimin nga studimet specializuese.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi vjetor i studentëve bëhet sipas moduleve që ka ndjekur specializanti gjatë atij viti akademik.</p>	<p>Ky institucion ka ndjekur procedura te qarta e transparente per vleresimin e specializanteve. Menyra dhe llojet e vleresimit iu jane bere te njohura specializanteve qe ne fillim te specializimit. Kandidatet i kane te sqaruara ne syllabuset e cdo moduli edhe menyren e vleresimit, perqindjen e llojeve te ndryshme te vleresimit, piket qe nevojiten per te marre nje note te caktuar, jane po ashtu te sqaruara.</p> <p>Universiteti "Aldent" disponon nje sistem te informatizuar per shpalljen e rezultateve te cdo testimi apo provimi te realizuar nga kandidatet.</p> <p>Ata jane te informuar qe ne fillim se cili eshte numri i krediteve qe duhet te fitojne per te kaluar nga njeri vit te tjetri. Pa realizuar kete numur kreditesh nuk eshte e mundur kalimi ne vitin pasardhes.</p> <p>Vleresimi semestral dhe vjetor i specializanteve eshte bere vetem sipas moduleve a lendeve te zhvilluara ne ate semester apo ate vite qe jane ne perputhje me planin mesimor te shpallur e njohur qe ne fillim.</p>
<p>Standardi V. 8 - Vlerësimi përfundimtar i studentëve</p>	
<p>Kriteri 1 Studenti jep prova që ka fituar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Njohuri të thelluara në fushën përkatëse; Njohuri të thelluara në disa fusha të afërta me të; Aftësi profesionale dhe shkencore në 	<p>Ne kete universitet ende nuk eshte bere diplomimi i specializanteve te pare te SPA, pasi ata jane aktualisht ne mes te studimeve.</p> <p>Standarti V.8 qe percaktohet ketu njihet ne institucion</p>

<p>përdorimin e teknologjisë bashkëkohore për të zgjidhur problemet klinike që lidhen me fushën e tij të specializimit dhe integrimin e njohurive të fituara për zgjidhjen e situatave komplekse;</p> <p>d. Risi, për të zgjeruar dhe për të rifreskuar njohuritë ekzistuese;</p> <p>e. Autonomi, integritet shkencor, profesional dhe përkushtim për zhvillimin e ideve të reja;</p> <p>f. Aftësi bashkëpunimi në grup për zgjidhjen e situatave të ndryshme klinike;</p> <p>g. Sjellje etike dhe profesionale.</p> <p>Kriteri 2 Studenti jep prova që me anë të punës së tij klinike ka fituar aftësinë dhe kompetencat profesionale dhe shkencore të nevojshme për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur.</p> <p>Kriteri 3 Studentit i jepet e drejta për të hyrë në provimin përfundimtar pas shqyrtimit të dosjes së tij nga këshilli i programit specializues i cili e vlerëson atë pozitivisht ose negativisht. Dosja e kandidatit përmban vlerësimet mbi praktikën dhe modulet e kryera si dhe vlerësimet periodike nga ana e tutorit. Në rast vlerësimi negativ nga këshilli i programit specializues, studentit i komunikohet vendimi si dhe pjesët që duhet të përsërisë në mënyrë që të mund të hyjë në provimin përfundimtar.</p> <p>Kriteri 4 Vlerësimi përfundimtar i specializantëve bazohet në rezultatet e vlerësimeve periodike vjetore, në provimin përfundimtar dhe temën eksperimentale të diplomës si dhe gjykimin e pedagoqeve dhe të udhëheqësit.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni disponon një sistem të informatizuar për kontrollin dhe vlerësimin final të njohurive të marra nga studentët.</p>	<p>dhe do të zbatohet në provimin përfundimtar. Në vazhdimësi këtu të gjithë provimet që janë dhënë, sidomos ato të lendeve profesionale janë zhvilluar sipas një procedure të tillë dhe testimi është bërë i gjithanshem.</p> <p>Specializanti ka dhënë prova që është i aftë të përcaktojë diagnoze të sakta duke u bazuar në të gjitha mundësitë që i jep teknologjia dhe po ashtu të mund të përcaktojë një plan të qartë mjekimi, plan i cili është diskutuar në grupe dhe konsultuar nga pedagogu. Në fund është rënë në konsensus të përbashkët për aparatën ortodontikë që është përdorur apo nderhyrjen kirurgjike që është kryer.</p> <p>Është vënë re se gradualisht specializantët kanë fituar shprehite e nevojshme për rrugën dhe planin e mjekimit e po ashtu për rezultatet e pritshme. Pedagoget këtu i kanë kushtuar rëndësi të mesuarit kritik për t'i bërë specializantët të aftë për tu orientuar në zgjidhjen e rasteve të vështira, për tu konsultuar me literature apo me specialiste të tjera kur kjo është e nevojshme.</p> <p>Kandidatët për specialiste që studjojnë këtu kanë kontakte përmes email-it me pedagoget dhe tutorët e tyre dhe mundësi për të konsultuar rastet e tyre edhe nga jashtë universitetit apo gjatë punës në klinikat e tyre private.</p> <p>Ka përpertime të dukshme të kandidateve edhe në këto nivele të studimeve që ata janë, sigurisht deri në përfundim të programit ata do të kenë realizuar një formim tërësor të plotë për punë të pavarur si specialist të fushës që kanë zgjedhur.</p> <p>Me praktiken e ndjekur deri këtu duket se ata do të futen në provimin përfundimtar kur ti kenë shlyer të gjithë detyrimet që parashikon programi i studimeve, kreditet dhe detyrimet praktike të përcaktuara. Universiteti "Aldent" zoteron një sistem të informatizuar të menaxhimit të procesit të specializimit dhe vlerësimit të studentëve dhe kjo mendoj është garanci se standarti do të plotësohet.</p>
---	---

STANDARDI VI- INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE INFORMACIONE NGA BURIME TË TJERA

Standardi VI. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Biblioteka vë në dispozicion të programit të studimit një listë titujsh aktualë të literaturës së detyruar, e cila ndodhet realisht në bibliotekë.

Kriteri 2 Biblioteka zotëron një listë të botimeve periodike dhe programeve kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit.

Kriteri 3 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan

Në dispozicion të specializantëve janë realisht të gjithë literatura mjekësore që disponojmë në gjuhën shqipe. Biblioteka e UAL ka në inventarin e saj literature të detyruar mjekësore të viteve 2010-2015 në gjuhët angleze e italiane. Kjo bibliotekë ka orare të pershtatshme për tu shfrytëzuar nga specializantët e studentët.

UAL prej vitesh është i abonuar në bibliotekën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe ju ofron

<p>të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të.</p> <p>Kriteri 4 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>studenteve e specializanteve të saj akses pa pagesë në shfrytëzimin e inventarit të kësaj biblioteke online.</p> <p>Ky institucion ka planifikuar çdo vit një buxhet të posaçëm për shtimin e literaturës në gjuhë të huaja dhe shqip si dhe për abonimin në bibliotekën online Hinari.</p>
<p>Standardi VI. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë, mjedise të përshtatshme mësimore dhe struktura klinike.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka laboratorë, klasa, zyrë, studio, auditore dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit.</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit, si dhe në përmirësim të vazhdueshëm.</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion të studentëve strukturat klinike pjesë e rrjetit formues për zhvillimin optimal të programit specializues.</p>	<p>Universiteti “Aldent” ka infrastrukturë të përshtatshme për të realizuar programin e studimit në SPA dhe për të gjithë programet për të cilat është licensuar. Ai disponon mjedise të mjaftueshme dhe një sipërfaqe prej 8m²/student duke llogaritur të gjitha ciklet e studimit që kryhen këtu. Kjo i ka krijuar komoditetin e duhur për mesim dhe punë. UAL ka 28 laboratore dhe 6 klinika që janë në dispozicion të specializanteve dhe studenteve, shumica e të cilëve studojnë në degen e stomatologjisë ose specializohen në profile të vecanta të saj.</p> <p>Të gjitha sallat e leksioneve e seminareve janë të pajisura me videoprojektor dhe kompjuter. Dy nga sallat e leksioneve janë të lidhura me sallën e praktikës me video-audio çka bën të mundur transmetimin direkt të nderhyrjeve të ndryshme që bëjnë pedagogët me disa studente dhe që mund të ndiqen edhe nga shumë të tjerë që nuk janë të pranishëm aty. Strukturat e institucionit janë në dispozicion të specializanteve dhe studenteve për gjatë gjithë kohës që është planifikuar mesim apo praktike.</p> <p>Mjediset e mjaftueshme akademike klinike nuk e bëjnë të nevojshme mesimin me turne në këtë institucion.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>UAL ka pranuar në SPA kandidatë me kritere specifike që janë të percaktuara në rregulloren perkatese. Mesatarja e përgjithshme e specializanteve që ndjekin aktualisht programin e studimeve në SPA është 8. Specializantët janë informuar që në fillim të programit me planin mesimor, përmbajtjen e tij, syllabuset e lendeve, stafin mesimor e ndihmës dhe menyrat e kontrollit të dijeve deri në realizimin e plotë të programit.</p> <p>Në dispozicion të specializanteve ka mjaftueshëm salla leksioni e seminaresh me pajisje audiovizuale, po ashtu 6 kabinete me 28 unite dentare, laboratore të nevojshme për realizimin normal të këtij programi. Në shërbim të specializanteve ka një bibliotekë të pajisur me librat mjekësorë të nevojshëm në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaja. Ka gjithashtu dhe akses në bibliotekën online të Organizatës Botërore të Shëndetësisë të emërtuar “ Hinari “, sistem interneti 24 orë dhe facilitetet e duhura.</p>	

POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR TË INSTITUCIONIT

10. Kërkimi shkencor dhe përfshirja në kërkime të studentëve të SPA.

Universiteti “Aldent” është institucion arsimor që krahas aktivitetit pedagogjik, ka të programuar edhe aktivitetin shkencor. Kërkimi shkencor është përcaktuar si prioritar edhe në programin e studimeve të SPA.

Në nivel universiteti janë realizuar një numër i konsiderueshëm referimesh e botime shkencore në revista të vendit, por edhe të huaja, madje me faktor impakti. Me shumë se 20 prezantime në kongrese e konferenca ndërkombëtare.

Kërkimin shkencor e lehtëson fakti se janë të pranishëm disa laboratore (28 të tilla) të pajisur me aparatura bashkëkohore e të furnizuara me baze materiale cilësore ku mund të realizohen eksperimente dhe metoda të reja mjekimi.

Ky universitet ka aplikuar dhe ka marrë pjesë në disa projekte njëri prej të cilëve, “The role of dental health profession in recognition of child neglect”, do të fillojë të implementohet në vitin 2016.

Institucioni ka realizuar aktivitet shkencor me studentët e specializantët si psh.; Konferenca informuese e bashkëpunimit me Universitetin e Chieti-Pescara, Itali, që është mbajtur në janar 2015.

Gjatë periudhës së deritanishme të studimeve specializantët e të dy profileve, Kirurgji Orale dhe Ortodonti, kanë marrë pjesë në trajnime falas dy dite në Firenze, Itali, pranë firmës Leone ku ata janë njohur me metodat e reja të mjekimit në implantologji dhe ortodonti fikse që janë pjesë e programit të tyre të studimit. Ata janë trajnuar edhe duke punuar direkt në fantoma e të survejuar nga pedagoget tanë dhe ata italiane. UAL ka qenë bashkorganizator dhe pjesëmarrës në kongresin e katërt mbarekombëtar shqiptar në nëntor 2015 dhe në simpoziumin e dytë të Ortodontisë, ku ka patur pjesëmarrje aktive të stafit, specializantëve dhe studentëve. Ka patur vlerësim të punimeve shkencore të ketij Universiteti, ku një specializant e tij, Aida Meto, ka marrë cmim nga Harvard University.

Me poshtë po paraqesim një tabelë që jep të dhëna mbi aktivitetin shkencor në UAL.

Tabela N. 14 Aktiviteti Shkencor në Universitetin “Aldent”

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang Institucioni në të cilët janë përfshirë studentët specializantë		Numri	Të dhënat (Titujt) për Revistat shkencore, projektet, aktivitetet shkencore
1.	Botime ku studentët kanë artikujt shkencorë	12	Revista Stomatologjike Shqiptare, Revista Apollonia, Konferenca Stomatologjike, Konferenca të huaja etj
2.	Projektet kërkimore të fituara nga udhëheqësit dhe /ose studentët e SPA	2	Projekt me Universitetin e Marmarasë dhe brenda UAL
3.	Projekte të zbatuara	1	
4.	Aktivitetet shkencore të organizuara nga IAL	20	
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore brenda IAL	35	
6.	Studentët e përfshirë në kërkimin shkencor, etj	8	Referime, poster, botime në Konferencat e Stomatologjisë, Ortodontisë, Kirurgjisë, etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 4 - Objektiva të programit të studimit të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë janë angazhimi i vazhdueshëm në punën klinike e kërkimore dhe nxitja e punës në ekip e studentëve.	
<p>Kriteri 1 Studenti angazhohet në punën klinike e kërkimore për aftësimin dhe përfundimin me sukses të programit të studimit.</p> <p>Kriteri 2 Studenti merr pjesë në aktivitete të ndryshme klinike të lidhura ngushtë me fushën specifike në të cilën ndjek studimet e specializimeve, të cilat e ndihmojnë të aftësohet për:</p> <ol style="list-style-type: none"> Përvetësimin e metodologjive dhe njohurive klinike e kërkimore për veprimtari krijuese të pavarura si: artikuj shkencorë, prezantime, etj.; Punën e pavarur në laborator/klinikë; Përdorimin e burimeve të informacionit (p.sh. bibliotekat dhe internetin, databazat me karakter shkencor/klinik) dhe administrimin e informacionit; Përdorimin e teknologjive bashkëkohore për prezantime publike; Përvetësimin e metodave të avancuara të analizës dhe përpunimit të të dhënave; Njohjen dhe përvetësimin e terminologjisë së specializuar lidhur me fushën klinike të specializantit. <p>Kriteri 3 Studenti i programit specializues merr pjesë në aktivitetet e parashikuara të programit të studimit jashtë punës së tyre klinike. Specializanti është i lirë të marrë pjesë si dëgjues apo si referues në:</p> <ol style="list-style-type: none"> Ligjërata; Seminare; Debate ndërdisiplinore, të organizuara në kuadër të programit të studimit të specializimeve; Mundësi të tjera të të mësuarit si: ndjekja e prezantimeve të konferencave dhe seminareve të ndryshme me karakter klinik. <p>Udhëheqësit i këshillojnë studentët të marrin pjesë në aktivitete dhe konferenca shkencore që i ndihmojnë në punën e tyre dhe klinike.</p> <p>Kriteri 4 Studenti fiton aftësi ³ për komunikimin e duhur me nivel profesional</p> <p>Kriteri 5 Studenti ndjek rregullat e sjelljes etike dhe profesionale me pacientët dhe kolegët dhe fiton aftësi për komunikim korrekt me të tjerët.</p>	<p>Specializantet janë angazhuar në punën e tyre klinike, por dhe në ato kërkimore shkencore. Kjo përvetësimi i kërkimit është dhe një mundësi reale pasi këtu studjojnë kandidatë që kanë përfunduar studimet e larta 5 vjeçare në Stomatologji dhe që kanë arritur të vlerësohen me nota mesatare mbi 8.</p> <p>Në UAL zhvillohen sipas një programi të caktuar aktivitete të shumta klinike lidhur me edukimin në vazhdim të stafit, nga pedagogje të vendit dhe të huaj.</p> <p>Të gjitha këto ndiqen dhe ndihmojnë specializantet që të formohen e nxitin edhe në drejtim të punës kërkimore duke krijuar shprehite e nevojshme të punës me literaturë, gjetjen e pershkrimit e rasteve, shkërimin e një artikulli apo të një posteri me përmbajtje shkencore.</p> <p>Në programin e studimit në SPA, në vitin e parë studjohet edhe lenda e biostatistikës dhe Informatikës të cilat i ndihmojnë specializantet në mënyrën e mbledhjes së materialit dhe organizimin dhe realizimin e një studimi, përpunimin statistikor të tij.</p> <p>Aktivitetet shkencore UAL zhvillohen sipas programit të tij për këto probleme, por specializantet marrin pjesë edhe në aktivitete që zhvillohen jashtë tij nga institucione, firma të materialeve dentare apo individë me të cilët UAL ka marrëveshje bashkëpunimi. Në shumicën e rasteve të këtyre aktiviteteve kanë referuar profesorë e shkencëtarë të shquar të stomatologjisë, teknologjisë e të materialeve dentare. Problematika e këtyre referimeve është e gjere dhe e shumëanshme, ajo përfshin teori dhe metoda të reja diagnostikimi e mjekimi sidomos në fushat me interes të Stomatologjisë së sotme si implantologjia dhe ortodontia fikse që janë dhe pjesë e programit të SPA që ka ofruar Universiteti “Aldent”.</p> <p>Specializantet këtu marrin pjesë aktivisht, bëjnë pyetje dhe përfshihen në diskutime.</p> <p>Deri më tani specializantet e Kirurgjisë Orale dhe të Ortodontisë kanë marrë pjesë në një trajnim dy ditor falas në Firenzë Itali, pranë firmës prestigjioze Leone, ku janë njohur me materiale e metoda të reja mjekimi në implantologji dhe ortodonti fikse dhe janë ushtruar direkt duke punuar mbi fantoma të survejuar nga pedagogjet e specialistët e universitetit dhe të huaj.</p> <p>Gjatë vitit 2015 UAL ka organizuar edhe dy aktivitete shkencore me pjesëmarrjen e specializanteve dhe studenteve. Në janar 2015 është zhvilluar një konferencë</p>

³ Aftësitë e komunikimit të studentit përfshijnë: kompetencën për të përshkruar në mënyrë të qartë rastet klinike; përdorimin e argumenteve bindëse dhe artikullimin e qartë të ideve para pacientit dhe kolegeve; zotësinë për të debatuar dhe mbështetur të tjerët, të përfshirë, në klinikë, mbikqyrje ose demonstrime.

	<p>shkencore mbi stomatologjine ku jane mbajtur 9 referime me nivel te larte shkencor nga Profesore te Universitetit te Chieti-Pescara.</p> <p>Gjthashtu UAL ne konferencen e 4-te mbarekombetare te Stomatologjise, ka organizuar ardhjen e 5 referuesve nga Universiteti i Chieti-Pescara te cilet referuan dhe u bene pjese e kongresit.</p> <p>Pedagoget e UAL dhe udheheqesit klinike te praktikave ndikojne me shembullin e tyre ne formimin profesional, por edhe shkencor te atyre qe po specializohen ketu.</p> <p>Ne programin e studimit ne SPA eshte e perfshire dhe nje lende e emrtuar “ Metoda kerkimi” qe eshte lende me zgjedhje, por qe eshte preferuar nga specializantet dhe qe u jep atyre infomacinin e plote te nevojshem per menyren dhe kryerjen e kerkimit shkencor ne praktiken mjeksore.</p> <p>Megjithese aktivitetit shkencor ne UAL i eshte dhene rendesia e duhur, vihet re se shumica e specializanteve jane te prirur pas zgjidhjes se rasteve klinike, shlyerjes se detyrimeve qe ka programi i specializimit dhe rutines ne klinikat e tyre private. Nuk duket se jane te perfshire sa duhet individualisht ne punen studimore shkencore dhe ne studime te vecanta te ndjekura individualisht a ne grup prej tyre. Gjate intervistes me to e theksua se disa prej tyre kane filluar te projektojne tema kerkimore e me karakter mjekues qe duan ti pergatisin e ti mbrojne ne perfundim te studimeve me rastin e mbrojtjes se diplomes.</p> <p>Sidoqofte aktivizimi i specializanteve ne punen studimore shkencore mund te ishte me i mire.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Ne UAL specializanteve dhe studenteve iu jane krijuar kushte optimale studimi, per pjesmarrjen e tyre ne aktivitete e veprimtari shkencore brenda e jashte vendit si dhe per realizimin e studimeve me karakter shkencor dhe prezantimin apo botimin e tyre ne revistat tona apo dhe jashte vendit.</p> <p>Ne kete institucion ata qe kryejne programin e SPA i kane mundesite te marrin jo vetem njohurite e duhura dhe aftesimin profesional e klinik, por dhe ate ne fushen e kerkimit dhe studimit shkencor.</p>	

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar në funksion të programit të SPA

Universiteti “Aldent” ne gjithë veprimtarine e tij per pergatitjen e specialisteve te fushes se mjekesise dhe te mjekeve stomatologe te specializuar ne profile te vecanta sic jane ato te Kirurgjise Orale dhe Ortodontise qe ofron ky program i SPA, ka patur edhe nje objektivi prioritar qe eshte bashkepunimi i tij me institucione, firma apo individe te shquar brenda e jashte vendit. Perpara licensimit UAL ka lidhur mardhenje bashkepunimi me Qendren Spitalore dhe Shtepine e sherbimit “Centro Ospedale e Casa di Cura San Giovanni XXIII”,

Monastier di Treviso ne Itali, po ashtu dhe me Universitetin e Chieti-Pescara. Ky fakt është i dokumentuar nga strukturat e MASH dhe është i pasqyruar ne Urdherin e Licensimit te programit te specializimit afatgjate ne Stomatologji me profil Kirurgji Orale dhe Ortodonti. Ne vazhdimesi, per te realizuar kete prioritet UAL ka hartuar nje program bashkepunimi afatshkurter dhe afatmesem me universitete, institucione te arsimit e te mjekimit, kompani prodhuese e te teknologjise dhe materialeve dentare vendase dhe te huaja.

Ne planin afatshkurter UAL është përqendruar ne identifikimin e nevojave te institucionit, identifikimin e fushave te vecanta dhe mundesive te sigurimit te tij, ne identifikimin dhe gjetjen e partnereve dhe ne lidhjen dhe nenshkrimin e marveshjeve dhe hartimin e projekteve te perbashketa.

Universiteti “Aldent” ka lidhur e konkretizuar deri tani marveshje bashkepunimi me:

Bashkëpunimi me Universitete, Institucione dhe organizata vendase dhe të rajonit

UAL dokumenton marrëveshje bashkëpunimi me:

- Universitetin e Mjekësisë, Tiranë,
- Kolegjin “ILIRIA”
- Fakulteti i Shkencave Mjekësore
- Prishtinë, Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza",
- Spitalin e Traumës, Tiranë,
- Shoqatën Dentare Shqiptare,
- Shoqatën e Pedodontëve,
- Qendra Kombtare e Edukimit në Vazhdim,
- Shoqëria "Dental Leader Corsi",
- Shoqëria e Sigurimit ALBSIG SHA,
- Banka të ndryshme të nivelit të dytë etj.

Bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare

Universiteti Aldent është në proces hartimi të një programi afatmesëm dhe afatgjatë bashkëpunimi me shumë universitete europiane.

Nga bashkëpunimet ndërkombëtare te realizuara deri sot mund të përmendim:

- Marrëveshje e bashkëpunimit me Universita degli studi “G. D’Annunzio” Chieti, Pescara në Itali. Studentët e studimeve pasuniversitare të Universitetin e “Gabriele d’Annunzio”, të Chietit, në Itali do të kenë mundësinë e kryerjes së aktiviteteve kërkimore në institucionin UAL, për një periudhë nga 12 muaj deri në 18 muaj, nën mbikqyrjen e një profesori ose kërkuesi pranë Universitetit Aldent.
- Marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Spitalore dhe Shtëpinë e Shërbimit “Centro Ospedale e Casa di Cura “San Giovanni XXIII”, Monastier di Treviso në Itali. Kjo qëndër është një Institucion Sanitar Privat dhe i Akredituar rehabilitimi, kujdesi dhe hospitalizimi. Kjo qëndër është e orientuar drejt menaxhimit të patologjive nëpërmjet përdorimit të integruar të përqsajeve multidisiplinore nëpërmjet diagnostikimit

kompetent të stafit. Qendra e Odontostomatologjisë dhe Ortodontisë në këtë Qëndër Spitalore, merret me aktivitetet: odontostomatologji, ortodonti dhe kirurgji maksilofaciale dhe orale. Mjekët e specializuar të kësaj qendre janë pjesë e stafit trajnuese në Shkollën e Specializimit pas universitar në Universitetin Aldent. Në baze të kësaj marrëveshjeje, mjekët stomatologë kanë mundësi të bëjnë trajnime në specialitete të ndryshme në fushën e stomatologjisë.

- Prej vitit 2010 Universiteti Aldent ka një marrëveshje bashkëpunimi me seksionin e Edukimit të kompanisë së mirënjohur 3M ESPE, për prodhimin e materialeve dentare. Specialistët e këtij grupi janë të përkushtuar në drejtim të didaktikës dhe kërkimit shkencor. Ky grup është i lidhur me një komunitet botëror të shkencëtarëve dhe profesionistëve të industrisë dentare. 3M Group ofron akses në përmbajtje shkencore me kualitet të lartë, trajnime, seminare dhe studime on-line. Ndër të tjera, disa prej këtyre aktivitetesh janë kryer në Universitetin “Aldent”, të tilla si: workshope, trajnime, për studentët dhe stafin në fushën e Dentistisë, Endodontisë dhe Protetikës Fikse.
- Duke u mbështetur mbi të gjitha strategjitë afatshkurtër dhe afatgjata të bashkëpunimit, Universitetin Aldent e kanë vizituar dhe kanë dhënë kontributin e tyre në zhvillim e leksioneve dhe trajnimeve të ndryshme edhe shumë profesorë e specialistë lider të fushave të ndryshme të mjekësisë nga Europa, Amerika dhe Azia. Janë organizuar aktivitete të përbashkëta, shkëmbime stafi dhe studentësh.
- Gjithashtu rezulton që Universiteti “Aldent” është në prag të finalizimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Universitetin e Ferrarës në Itali me qëllim të promovohen aktivitetet në drejtimet e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për institucionet respektive.

Me poshte jepet nje tablele me dhena lidhur me aktivitet e perbashketa te bashkepunimit te UAL me institucione te tjera nderkombetare.

Tabela N.15 Aktivitete shkencore ne kuader te bashkepunimit nderkombetar

Aktivitete shkencore në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar		
1	Numri i studentëve pjesëmarrës si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	2
2	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	35
3	Numri i lektorëve të huaj që janë angazhuar në mësimdhënie/udhëheqje	5
4	Numri i orëve mësimore të zhvilluara nga lektorë të huaj	100
5	Numri i pjesëmarrësve në trajnime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	22
6	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	-
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

Ne tabelen e meposhtme jepen te dhena dhe emertimet e institucioneve vendase dhe te huaja dhe llojin e bashkepunimit qe Universiteti “Aldent” ka realizuar me institucione te tjera vendase ose te huaja:

Tabela N.16

Universitetet, Institucione dhe Firma bashkëpunuese vendase dhe të huaja	Lloji i bashkëpunimit
Universita degli studi "G. D'Annunzio" Chieti, Pescara në Itali	Marrëveshje bashkëpunimi në kuadrin e shkëmbimit të stafit akademik dhe studentëve në implementimin e projekteve kërkimore të përbashkëta.
Technion-Israel Institute of Technology	Bashkëpunim në kuadrin të kërkimit shkencor.
Universiteti Mjekesor i Tiranës	Marrëveshje bashkëpunimi për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.
Firma ndërkombëtare 3M-USA	Bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor, organizimin e trajnimeve, seminareve dhe vworkshope.
Qendra Spitalore "San Giovanni XXIII", Monastier, Treviso në Itali	Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kërkimit shkencor dhe trajnimin e stafit akademik dhe studentëve.
Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave të studentëve.
Spitali Universitar i Traumës Tiranë	Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave të studentëve.
Marteniteti "Koço Glozheni"	Marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikave të studentëve.
Shoqata Dentare Shqiptare	Bashkëpunimi në organizimin e koferencave, seminareve, trajnimeve.
Shoqata e Ortodontëve Shqiptare	Bashkëpunimi në organizimin e koferencave, seminareve, trajnimeve.
Shoqata e Pedodontëve Shqiptare	Bashkëpunimi në organizimin e koferencave, seminareve, trajnimeve.
Shoqëria "DENTAL LEADER-CORSI" SH.P.K	Kontratë shërbimi në drejtimin dhe organizimin e seminareve didaktike teorike, vworkshope dhe ndërmjetësimi me profesorë të huaj të specializuar në fushën e kirurgjisë orale dhe implantologjisë.
Bashkia e Tiranës	Kontratë dhurimi
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	Lloji i bashkëpunimit
Klinika Dentare	Kontratë praktike mësimore e studentit (dega Stomatologji) ndërmjet Institucionit Arsimor të Lartë Universiteti ALDENT me Klinikat Dentare. (tipi i kontratës)
Shoqëria e Sigurimit ALBSING SHA	Kontratë sigurimi nga Aksidentete Personale për çdo student.
Banka e nivelit të dytë	Banka Societe Generale Albania

- Gjate inspektimit ne UAL u kontrollua dokumentacioni perkates dhe u gjeten te nenshkruara marreveshtjet e bashkepunimit sipas tabelës me sipër, afatet dhe llojet e bashkepunimit.
- Ne keto marreveshje eshte parashikuar edhe kryerja prane laboratoreve te UAL e studimeve shkencore te studjuesve nga Universiteti i Chietit, tregues i qarte pozitiv. Do te kishte qene e arsyeshme qe ne njejten simetri te ishte parashikuar edhe mundesine e kryerjes se studimeve nga specialiste shqiptare ne Universitetet e huaja me te cilet kane marreveshje bashkepunimi.
- Ne kuader te bashkepunimit me institucione shkencore e mjekesore te UAL, ate e kane vizituar e kane dhene ndihmesen e tyre shume profesore e specialiste nga Europa, Amerika e Azia.

- Ne kuader te permiresimit te punes lidhur me mobilitetin, ndoshta do te ishte e arsyeshme edhe parashikimi i dergimit te studenteve e specializanteve per afate te kufizuara ne keto institucione, per te kryer kerkime qofte edhe per pjese te vecanta te studimeve qe ata duan te realizojne. Marreveshjet jane, mbase ka mundesi per ndonje permiresim te tyre. Sidoqofte bashkepunimi me institucione te tjera te vendit apo te huaja duhet konsideruar i realizuar dhe programi i studimeve ne SPA i suksesshem.

Konkluzionet e vlerësimit:

Universiteti “Aldent” ka marreveshje bashkepunimi me disa institucione te rendesishme arsimore, mjekesore e shkencore dhe nje aktivitet te perbashket te konsiderueshem. Ka marrdhenje me institucione nderkombetare si Universita degli studi “G. D’Annunzio” Chieti, Pescara në Itali, Qendra Spitalore “San Giovanni XXIII”, Monastier, Treviso në Itali, Israel Institute of Technology etj

Ai parashikon qe te lidhe marveshtje te reja bashkepunimi ne te ardhmen me institucione te tjera prestigjioze dhe projekte jane te gatshme e ne fazen e finalizimit.

Ne nje vezhgim teresor e te vemendshem te standarteve e te kritereve qe ka plotesuar Universiteti “Aldent”, e konsideroj te mundshem dhe te suksesshem realizimin e programit te studimeve ne SPA.

ANALIZA SWOT

Analiza përmbledhëse e RVJ sipas metodës **SWOT** (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat):

a. Pika të forta:

1. Është institucion arsimor e shkencor i ngritur dhe i menaxhuar nga specialistë të fushës së mjekësisë dhe i profilizuar vetëm në këtë fushë.
2. Ka krijuar një traditë dhe është rritur në mënyrë graduale në të gjithë ciklet e studimit deri në programin aktual të specializimit.
3. Është prirë nga ideja pozitive e krijimit të një institucioni me impakt të rëndësishëm social dhe jo e një biznesi të mirëfilltë duke investuar të ardhurat e fituara për rritjen dhe fuqizimin e institucionit për zgjerimin e tij e plotësimin e standarteve.
4. Ka lidhje të qëndrueshme bashkëpunimi dhe lektorë të ftuar nga Spitali “*Casa di Cura Giovanni XXIII*”, Monastier di Treviso dhe *Universiteti i Chieti-Pescara*.
5. Realizon mjekimin e pacientëve falas, kryen sponsorizime me karakter humanitar dhe mbështetës për kërkimin shkencor dhe edukimin në vazhdim.
6. Disponon një numër të madh dhe të mirëpajisur laboratorësh dhe *unite dentare (28)* që mundësojnë aftësim praktik të studentëve.
7. Aplikohen metoda novatore mjekimi si për shembull përdorimi i *lazerit* në kirurgjinë orale dhe aparatet biofunktionale në ortodonti.

b. Pika të dobëta:

1. Aktivizimi i specializantëve në kërkimin shkencor.
2. Mbingarkesa në kredite e disa lëndëve me drejtim mjekësor.
3. Mungesa e aparaturës së sedacionit koshient.

c. Mundësitë:

1. Rritja e bashkëpunimeve me spitale private dhe Universitete të tjera private.
2. Rritja e numrit të specializantëve që do të bëjnë trajnime në afate të ndryshme kohore në institucione të specializuara perëndimore.
3. Për të nxitur pjesëmarrjen e specializantëve në punën kërkimore të paktën mbi 50% e studentëve të mbrojnë diplomën me temë kërkimore.
4. Të krijohet mundësia për blerjen e aparaturës për sedacion koshient brënda vitit 2016.
5. Të shihet mundësia që në disa lëndë të drejtimit mjekësor të ulet numri i krediteve dhe këto ti shtohen praktikës, apo zvogëlimi i krediteve të ndonjë lënde të formimit

të përgjithshëm mjekësor, duke ja shtuar ato lëndës së formimit specializues, brenda kufijve që njeh ligji për ndryshime nga vetë institucioni.

d. Pengesat:

1. Ka probleme lidhur me edukatën shëndetësore ende në nivel të ulët të pacientëve.
2. Mungesa e mëparshme e specializimeve në profilet ku ofrohen studimet në specializimet afatgjata pranë UAL.
3. Normativat e punimeve të planifikuara për tu realizuar nga ana e specializantëve në Shtojcës nr.2 “Standarte dhe kritere specifike në mjekësi” nuk janë të bazuara në kushtet reale të vendit tonë dhe sugjerojnë që një grup ekspertësh të bëjë studimin e tyre dhe të japë rekomandimet e duhura.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

Prof. As. Nazmi Koçi

Aneksi I

Pjesë nga Shtojca nr. 2, “Standarde shtetërore për SPA”

52 SPECIALIZIMI NË:

**KIRURGJI ORALE (KIRURGJI
ODONTOSTOMATOLOGJIKE)**

Standarde për infrastrukturën	Kërkesa bazë për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
A) STANDARDE BAZË Duhet të disponohen nga të gjitha strukturat që bëjnë pjesë në rrjetin formues	Strukturë me shtretër	Po	Po	Ekzaminim i dokumentacionit
	Day Surgery	Po	Po	Eventualisht verifikim në vend
	Salla operimi	Po	Po	
	Ambulatorë	Po	Po	
B) STANDARDE DYTËSORE* *struktura bazë duhet të plotësojë të paktën 1 nga standardet dytësore ndërsa strukturat e tjera duhet të plotësojnë të paktën 1 nga standardet dytësore	Ortodonci	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Ekzaminim i dokumentacionit
	Odontostomatologji	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Eventualisht verifikim në vend
	Kirurgji orale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
C) SHËRBIME TË PËRGJITHSHME DHE DIAGNOSTIKUESE QË DUHET TË OFROJNË STRUKTURAT SHËNDETËSORE QË SHËRBEJNË SI STRUKTURA BAZË OSE DYTËSORE TË RRJETIT FORMUES Duhet të ofrohen nga të gjitha strukturat që bëjnë pjesë në rrjetin formues	Radiologji dhe diagnozë me imazhe	Po	Po	Ekzaminim i dokumentacionit
	Laborator mjekësor diagnostikues	Po	Po	Eventualisht verifikim në vend
	Ndihmë e shpejtë e nivelit të parë e të dytë	Po	Po	
Kritere infrastrukturore	Tipologjia	Mënyra e verifikimit		
Struktura të specializuara universitare ose të konvencionuara që duhet të jenë pjesë e rrjetit formues	STOMATOLOGJI DHE SPECIALITETE STOMATOLOGJIKE	Ekzaminim i dokumentacionit		
	KIRURGJI MAXILO FACIALE	Eventualisht verifikim në vend		
	RADIOLOGJI			
Standarde organizative	Nivele minimale të pranueshme për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
PERSONELI MJEKËSOR	Mjekë kirurgë/Stomatologë			Dokument që provon se numri i mjekëve është adekuat në krahasim me vëllimin asistencial të strukturës në fjalë

PERSONELI SHËNDETËSOR NDIHMËS	Personel teknik Infermierë			Dokument që provon se numri i personelit shëndetësor ndihmës është adekuat në krahasim me vëllimin asistencial të strukturës në fjalë
-------------------------------	-------------------------------	--	--	---

Standarde asistenciale	Kerkesa bazë për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
A) NDERHYRJE KIRURGJIKALE VJETORE	Ndërhyrje kirurgjike të nivelit të lartë	N. 150	N. 50	Ekzaminim i dokumentacionit
	Ndërhyrje kirurgjike të nivelit të mesëm	N. 250	N. 75	
	Ndërhyrje kirurgjike të nivelit të ulët	N. 300	N. 100	
B) SHTRIME SPITALORE VJETORE	Shtrime	N. 500	N. 200	
	Day Hospital	N. 300	N. 100	

Kritere asistenciale	Numri minimal i rasteve dhe shërbimeve të ekzaminuara/kryera nga specialisti gjatë gjithë kohëzgjatjes së specializimit për t'u shpërndarë sipas programit formues të specializimit	Vëllimi minimal i aktivitetit asistencial vjetor të rrjetit formues me një specialist për çdo vit (a)	Vëllimi minimal i aktivitetit asistencial vjetor të rrjetit formues i nevojshëm për hapjen e programit specializues (b)
Ekstrakte jo kirurgjike të thjeshta dhe komplekse	200*	667	1001
Ndërhyrje të kirurgjisë ekzodontike	200**	667	667
Ndërhyrje të patologjisë cistike të nofullave	20**	67	67
Biopsi	60**	200	200
Ndërhyrje kirurgjike endodontike	10**	34	34
Ndërhyrje kirurgjike ortodontike	15**	50	50
Ndërhyrje kirurgjike implantuese	20**	67	67
Ndërhyrje kirurgjike preprotezike	15**	50	50
Ndërhyrje kirurgjike parodontale	50**	167	167
Ndërhyrje për asportimin e neoplazive beninje dhe malinje	10**	34	34
Ndërhyrje të kirurgjisë orale	30**	100	100
Totali i ndërhyrjeve	630	2103	2437

* duke qenë e mundur pjesëmarrja e më shumë se një specialisti (maksimumi 2), aktiviteti asistencial për formimin e një specialisti mund të konsiderohet si për 2 specialistë

** duke qenë e mundur pjesëmarrja e më shumë se një specialisti (maksimumi 3), aktiviteti asistencial për formimin e një specialisti mund të konsiderohet si për 3 specialistë

Kritere të programit	Minimimi i sektorëve shkencorë disiplinorë të detyrueshëm	Mënyra e verifikimit
Lëndë bazë	SËMUNDJE ODONTOSTOMATOLOGJIKE KIRURGJI MAKSILO FACIALE DIAGNOZË ME IMAZHE DHE RADIOTERAPI	Ekzaminim i dokumentacionit Eventualisht verifikim në vend

Standarde për infrastrukturën	Kërkesa bazë për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
A) STANDARDE BAZË Duhet të disponohen nga të gjitha strukturat që bëjnë pjesë në rrjetin formues	Strukturë me shtretër	Po	Po	Ekzaminim i dokumentacionit
	Day Surgery	Po	Po	Eventualisht verifikim në vend
	Salla operimi	Po	Po	
	Ambulatorë	Po	Po	
B) STANDARDE DYTËSORE* *struktura bazë duhet të plotësojë të paktën 1 nga standardet dytësore ndërsa strukturat e tjera duhet të plotësojnë të paktën 1 nga standardet dytësore	Ortodonci	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Ekzaminim i dokumentacionit
	Odontostomatologji	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	Eventualisht verifikim në vend
	Kirurgji orale	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
C) SHËRBIME TË PËRGJITHSHME DHE DIAGNOSTIKUESE QË DUHET TË OFROJNË STRUKTURAT SHËNDETËSORE QË SHËRBEJNË SI STRUKTURA BAZË OSE DYTËSORE TË RRJETIT FORMUES Duhet të ofrohen nga të gjitha strukturat që bëjnë pjesë në rrjetin formues	Radiologji dhe diagnozë me imazhe	Po	Po	Ekzaminim i dokumentacionit
	Laborator mjekësor diagnostikues	Po	Po	Eventualisht verifikim në vend
	Ndihmë e shpejtë e nivelit të parë e të dytë	Po	Po	
Kritere infrastrukturore	Tipologjia	Mënyra e verifikimit		
Struktura të specializuara universitare ose të konvencionuara që duhet të jenë pjesë e rrjetit formues	STOMATOLOGJI DHE SPECIALITETE STOMATOLOGJIKE	Ekzaminim i dokumentacionit		
	KIRURGJI MAKSILO FACIALE	Eventualisht verifikim në vend		
	RADIOLOGJI			
Standarde organizative	Nivele minimale të pranueshme për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
PERSONELI MJEKËSOR	Mjekë kirurgë/stomatologë			Dokument që provon se numri i mjekëve është adekuat në krahasim me vëllimin asistencial të strukturës në fjalë

PERSONELI SHËNDETËSOR NDIHMËS	Personel teknik Infermierë			Dokument që provon se numri i personelit shëndetësor ndihmës është adekuat në krahasim me vëllimin asistencial të strukturës në fjalë
-------------------------------	-----------------------------------	--	--	---

Standarde asistencialë	Kerkesa bazë për akreditimin	Struktura qendrore	Struktura dytësore	Mënyra e verifikimit
A) NDËRHYRJE KIRURGJIKALE VJETORE	Ndërhyrje kirurgjikale të nivelit të lartë	N. 150	N. 50	Ekzaminim i dokumentacionit
	Ndërhyrje kirurgjikale të nivelit të mesëm	N. 250	N. 75	
	Ndërhyrje kirurgjikale të nivelit të ulët	N. 300	N. 100	
B) SHTRIME SPITALORE VJETORE	Shtrime	N. 500	N. 200	
	Day Hospital	N. 300	N. 100	

Kritere asistencialë	Numri minimal i rasteve dhe shërbimeve të ekzaminuara/kryera nga specialisti gjatë gjithë kohëzgjatjes së specializimit për t'u shpërndarë sipas programit formues të specializimit*	Vëllimi minimal i aktivitetit asistencial vjetor të rrjetit formues me një specialist për çdo vit* (a)	Vëllimi minimal i aktivitetit asistencial vjetor të rrjetit formues i nevojshëm për hapjen e programit specializues (b)
Diagnozë dhe terapi preventive, interceditive dhe korrektuese e malokluzioneve skeletrike dhe dentale të pacientëve në fazë rritje	60	200	200
Diagnozë dhe terapi e disnjacive dentare dhe dento skeletrike tek të rriturit	40	134	134
Diagnozë dhe terapi e keqformimeve kranio faciale dhe në finalizimin ortodontik të suportit të kirurgjisë ortonjatiqe	20	67	67
Diagnozë dhe terapi e patologjive intra dhe ekstra artikulare të artikulationit	40	134	134
Diagnozë dhe terapi e patologjive multi disiplinore nga ortognatodencia deri te disiplinat e ndryshme të ngjashme në të cilat inegrohët specializimi në fjalë	20	67	67
Diagnozë dhe terapi e patologjive nga alterim i qëndrimit postural, nga problematika neurologjike të lidhura me cefaletë, nga patologji psikiatrike në bazë të tyre	20	67	67

* duke qenë e mundur pjesëmarrja e më shumë se një specialisti (maksimumi 3), aktiviteti asistencial për formimin e një specialisti mund të konsiderohet si për 3 specialistë

119

Kritere të programit	Minimumi i sektorëve shkencorë disiplinorë të detyrueshëm	Mënyra e verifikimit
Lëndë bazë	SËMUNDJE ODONTOSTOMATOLOGJIKE	Ekzaminim i dokumentacionit Eventualisht verifikim në vend
	KIRURGJI MAKSILO FACIALE	
	DIAGNOZË ME IMAZHE DHE RADIOTERAPI	

Korigjim teksti:

Në të gjithë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm Fjala **Ortodonci** do të zëvendësohet me fjalën **Ortodonti**